



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# RAPORTI VJETOR

# 2008

RAPORTI VJETOR  
I BQK-së

Prishtinë  
Qershor  
2009



# PËRMBAJTJA

Letra hyrëse e Kryetarit të Bordit Drejtues të BQK-së -----	1
Letra hyrëse e Guvernatorit -----	3
Anëtarët e Bordit Drejtues, Komitetit të Auditimit dhe Komitetit Ekzekutiv -----	5
Struktura organizative e BQK-së më 31 dhjetor 2008-----	7
1. Përmbledhje ekzekutive -----	9
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik-----	11
2.1. Ekonomia botërore -----	11
2.2. Evropa Juglindore -----	14
3. Ekonomia e Kosovës -----	19
3.1. Sektori real -----	19
3.1.1. Produkti i brendshëm bruto -----	19
3.1.2. Çmimet -----	21
3.1.3. Tregu i punës -----	23
3.1.4. Privatizimi -----	24
3.2. Sektori fiskal -----	24
3.2.1. Të hyrat buxhetore -----	25
3.2.2. Shpenzimet buxhetore -----	27
3.3. Sektori financiar-----	29
3.3.1. Struktura dhe aktiviteti i sektorit bankar -----	31
3.3.2. Kompanitë e sigurimeve -----	40
3.3.3. Fondet pensionale-----	41
3.3.4. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar -----	42
3.4. Sektori i jashtëm-----	43

# PËRMBAJTJA

3.4.1. Llogaria rrjedhëse -----	45
3.4.2. Llogaria kapitale dhe financiare -----	50
4. Mbikëqyrja financiare -----	55
4.1. Veprimtaria rregullative e sektorit financiar -----	56
4.2. Liçencimi dhe struktura -----	59
4.3. Veprimtaria e mbikëqyrjes financiare -----	62
4.3.1. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes bankare gjatë vitit 2008 -----	65
4.3.2. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes së sigurimeve gjatë vitit 2008 -----	69
4.3.3. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes së pensioneve gjatë vitit 2008 -----	74
4.4. Veprimet ndëshkuese ndaj institucioneve financiare -----	77
4.5. Procesi i themelimit të Agjencionit për Sigurimin e Depozitave -----	77
4.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e mbikëqyrjes financiare -----	79
5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun -----	80
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme -----	80
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive -----	86
5.3. Menaxhimi i mjeteve -----	91
5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave -----	93
5.5. Regjistri i krediteve -----	96
5.6. Aktivitet kërkimore dhe statistikore -----	97
6. Zhvillimet e brendshme -----	99
6.1. Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm -----	99
6.2. Zhvillimi i burimeve njerëzore -----	104
6.3. Riorganizimi i BQK-së -----	106

# PËRMBAJTJA

6.4. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar -----	107
6.4.1. Marrëveshjet ndërkombëtare -----	108
6.4.2. Anëtarësimi në shoqatat dhe organizatat ndërkombëtare -----	109
7. Pasqyrat financiare të BQK-së -----	111
8. Shtojca statistikore -----	155



## LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e jashtme neto
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e tregtisë së lirë me shtetet e Evropës juglindore
EJL	Evropa juglindore
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
IHD	Investimet e huaja direkte
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KKE	Kategoritë kryesore ekonomike
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat tjera depozituese
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTPL	Sigurimi i auto-përgjegjësive
NLB	Nova Ljubljanska Banka

## LISTA E SHKURTESAVE

NREK	Norma reale efektive e këmbimit
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Shtëpiake
PBB	Produkti i brendshëm bruto
pp	Pikë përqindjeje
PPT	Përgjegjësitë ndaj palës së tretë
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RKK	Regjistri i Krediteve të Kosovës
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

LISTA  
E  
TABELAVE

1. Indikatorët kryesor makroekonomik -----	20
2. Rrjeti i sektorit bankar -----	33
3. Struktura e asetëve-----	33
4. Struktura e detyrimeve -----	36
5. Bilanci i suksesit -----	39
6. Bilanci i pagesave -----	44
7. Bilanci tregtar i Kosovës -----	45
8. Aktiviteti i licencimit të bankave -----	61
9. Aktiviteti i licencimit të kompanive të sigurimit -----	61
10. Aktiviteti i licencimit të fondeve pensionale -----	61
11. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare financiare -----	61
12. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit -----	62
13. Aktiviteti i regjistrimit të agjencioneve të transferit të parave -----	62
14. Aktiviteti i regjistrimit të zyrave të këmbimit të valutave -----	62
15. Mbikëqyrja bankare: ekzaminimet në vend të kryera gjatë vitit 2008-----	67
16. Bruto primet e shkruara-----	70
17. Raportet e humbjeve -----	71
18. Kthimi në asete dhe kapital -----	72
19. Kompanitë e sigurimeve: performimi i ekzaminimeve në vend gjatë periudhës 2007-2008----	72
20. Investimet e trustit -----	75
21. Fondet pensionale: performimi i ekzaminimeve në vend -----	76
22. Të dhënat përmbledhëse mbi transaksionet bankare -----	87



LISTA  
E  
FIGURAVE

1. Çmimet e konsumit-----	22
2. Bilanci buxhetor -----	25
3. Struktura e të hyrave buxhetore-----	26
4. Struktura e shpenzimeve buxhetore-----	28
5. Sektori financiar ndaj sektorëve të tjerë-----	31
6. Struktura e asetëve sipas pronësisë-----	32
7. Struktura e kredive të ndërmarrjeve -----	35
8. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	35
9. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	37
10. Normat e interesit -----	38
11. Kategoritë kryesore ekonomike-----	46
12. Tregtia me vendet e CEFTA-s dhe BE-së-----	47
13. Transferet rrjedhëse -----	49
14. Hyrjet dhe daljet e dërgesave të emigrantëve -----	50
15. Bilanci i investimeve në letra me vlerë -----	52
16. Bilanci i investimeve të tjera -----	53
17. Furnizimi me kartëmonedha euro-----	80
18. Furnizimi me monedha euro -----	81
19. Furnizimi me para të gatshme-----	81
20. Kartëmonedha euro të pranuar -----	82
21. Monedha euro të pranuar -----	82
22. Pranimi i parave të gatshme -----	83
23. Numri i katërmonedhave të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi-----	84

LISTA  
E  
FIGURAVE

24. Përpjestimi i kartëmonedhave të vjetërsuara nga gjithsej të pranuar	84
25. Përpjestimi i kartëmonedhave të reja (të papërdorura) të futura në qarkullim	85
26. Furnizimi me kartëmonedha të reja (të papërdorura)	86
27. Vëllimi vjetor i pagesave vendore të gjeneruara dhe atyre të pranuar përmes BQK-së	88
28. Vlera vjetore e pagesave vendore të gjeneruara dhe atyre të pranuar përmes BQK-së	88
29. Ecuria e depozitave të llogarimbajtësve kryesorë të BQK-së	89
30. Ecuria e depozitave të thesarit dhe institucioneve tjera qeveritare dhe të AKP-së	90
31. Ecuria e depozitave të bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit	90
32. Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së	93
33. Vëllimi dhe vlera mesatare ditore e transaksioneve të SEKN-së	94
34. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre	95
35. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre	95





I nderuari President i Republikës së Kosovës,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që t'juja prezantoj Raportin Vjetor të vitit 2008, një viti tejet të rëndësishëm për Kosovën, një viti që u shënua me germa të arta në historinë e Kosovës si Vit i Pavarësisë. Raporti vjetor, i cili përfshin të gjitha zhvillimet më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, e në veçanti në sektorin financiar, është rezultat i një pune të bërë me një përkushtim të madh e me ekspertizë të stafit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, gjë që bën që Raporti Vjetor të jetë prej viti në vit gjithnjë e më përmbajtësor e më cilësor.

Viti 2008 karakterizohet edhe me krizën financiare globale, që konsiderohet si një nga krizat më të mëdha botërore. Kjo krizë shkaktoi edhe një recesion në nivel botëror. Me këtë koncepti i derregullimit dhe liberalizimit të afarizmit të bankave dhe institucioneve të tjera financiare, që për një kohë mjaft të gjatë mbretëroi në botë, seriozisht është vënë në pikëpyetje. Pikërisht kjo krizë, që e tronditi pothuaj tërë botën, shtroi nevojën e rritjes së rolit mbikëqyrës të Bankave Qendrore, si dhe formimit të një institucioni në nivel ndërkombëtar për mbikëqyrjen e sistemeve financiare dhe parandalimin e paraqitjes së krizave të tilla në të ardhmen.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka zbatuar praktikën më të mira ndërkombëtare të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe për më tepër, të mbikëqyrjes shumë konservative të të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në Kosovë. Përkundër krizës së fundit financiare, sektori financiar i Kosovës mbeti stabil dhe i qëndrueshëm, duke shënuar rritje të depozitave dhe të kredive. Interesimi i hyrjes së bankave të reja në tregun e Kosovës është edhe një tregues tjetër i stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit financiar të vendit.

Bordi Drejtues i Bankës Qendrore, i përbërë në tërësi me anëtarë vendor, mori në tërësi përgjegjësitë që i takojnë me Ligjin e BQK-së, duke zbatuar me përpikëri dhe me sukses praktikën më të mira ndërkombëtare të qeverisjes.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit Drejtues



I nderuari President i Republikës së Kosovës,

Viti 2008 për Kosovën ishte një vit i sfidave dhe arritjeve të mëdha. Shpallja e pavarësisë solli perspektivë të re për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë. Aprovimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës transformoi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës në Bankë Qendrore të Republikës së Kosovës, duke plotësuar kështu kornizën institucionale për funksionim më efikas të sektorit financiar dhe të ekonomisë së vendit. Me këtë, u bë edhe bartja e të gjitha kompetencave në autoritetet vendore dhe arritjet në këtë drejtim ishin të shumta.

Përkundër një mjedisi të jashtëm jo të favorshëm – të karakterizuar me një krizë financiare të përmasave botërore e më pas të transmetuar në recesion ekonomik – sektori financiar dhe ekonomia e Kosovës vazhduan të jenë të shëndosha, duke reflektuar ritëm rritës edhe në vitin që e lamë pas. Për të siguruar stabilitetin e sektorit financiar, Banka Qendrore intensifikoi aktivitetin e saj mbikëqyrës, me fokus të veçantë në avancimin e metodave për vlerësimin e rrezikut të institucioneve financiare, ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar një qasje të koordinuar ndaj problemeve potenciale, si dhe ndjekjen e një politike aktive të komunikimit me publikun. Për më tepër, Banka Qendrore vazhdoi investimin e mjeteve të saj në pajtim me parimin e sigurisë, likuiditetit dhe të kthimit në mjete, duke realizuar kthim pozitiv nga këto investime.

Viti 2008, për sektorin bankar të Kosovës, ishte vit i prosperitetit. Gjatë këtij viti norma e rritjes së depozitave dhe kredive ishte e lartë, duke i kontribuar kështu rritjes ekonomike. Hyrja e bankave të reja ka nxitur konkurrencën në këtë treg, e cila është manifestuar me kushte më të favorshme për kredimarrësit dhe depozituesit dhe, në të njëjtën kohë, me rritje të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve bankare. E gjithë kjo është përcjellë me një nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori, gjë që e radhitë Kosovën ndër vendet me sektor bankar më të qëndrueshëm në rajon. Gjithashtu, ky vit ishte me suksese edhe për industrinë e sigurimeve, në të cilën janë paraqitur produkte të reja, përfshirë shërbimet e sigurimit të jetës, si dhe liberalizimi i kontrolluar i tarifave për policat e sigurimit. Njëkohësisht, vlen të nënvizohet se edhe institucionet mikrofinanciare kanë vazhduar të kreditojnë ekonomitë familjare, bizneset e vogla dhe agrobizneset. Përrjashtim nga kjo performancë e mirë e sistemit financiar bën Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, mjetet e të cilit kanë shënuar rënie të konsiderueshme në vlerë si rezultat i rënies së çmimeve të aksioneve në bursat ndërkombëtare.


Përparim i konsiderueshëm është bërë edhe në sistemin e pagesave duke kontribuar kështu në zvogëlimin e përdorimit të parasë së gatshme në ekonomi, si dhe në avancimin e mëtejme të infrastrukturës e cila ndihmon zhvillimin e sistemit financiar. Në këtë drejtim, janë bërë edhe përgatitjet për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sistemit të Pagesave në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, USAID, etj., ka qenë i gjithanshëm duke kontribuar kështu në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve të Bankës Qendrore. Gjatë vitit 2008, Banka Qendrore, po ashtu ka avancuar cilësinë e

përpilimit të statistikave monetare e financiare si dhe atyre të bilancit të pagesave konform standardeve ndërkombëtare. Analizat periodike dhe joperiodike mbi zhvillimet financiare dhe ekonomike në Kosovë kanë shënuar avancim të mëtejshëm dhe kanë mbështetur politikat e përgjithshme ekonomike të vendit.

Vend të veçantë në angazhimet e Bankës Qendrore gjatë vitit 2008 ka zënë edhe avancimi i kornizës ligjore të sistemit financiar në Kosovë, me çka synohet edhe avancimi i rolit të Bankës Qendrore në ekonominë e Kosovës. Banka Qendrore ka qenë po ashtu aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar duke nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet përkatëse të vendeve të ndryshme. Në këtë drejtim është dhënë kontribut i rëndësishëm edhe në përgatitjet për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Projeksionet për rritjen ekonomike të vendit për vitin 2009 flasin për një rritje të ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak, ndërsa segmentet më të ndjeshme për ekonominë e vendit tonë do të jenë kryesisht dërgesat e emigrantëve, investimet e huaja dhe ngadalësimi i kredisë nga sektori financiar. Ruajtja e stabilitetit në sektorin financiar, ndjekja e politikave të përshtatshme fiskale, si dhe vazhdimi i reformave strukturore në ekonomi mund të ndikojnë në zbutjen e efekteve nga përkeqësimet në segmentet e lartpërmendura. Rrjedhimisht, sfidat për të tejkaluar krizën, për të mbështetur një zhvillim afatgjatë ekonomik dhe për të trasuar rrugën e integritimeve evropiane do të jenë të mëdha. Prandaj, kërkohet një angazhim intensiv dhe i koordinuar i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, kam kënaqësinë të ju dorëzojë Raportin Vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008.



Hashim Rexhepi

Guvernator

**Anëtarët e Bordit Drejtues, Komitetit të Auditimit dhe Komitetit Ekzekutiv**

**Me 31 dhjetor 2008 Bordi Drejtues i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:**

**Bordi Drejtues i BQK-së:**


- Z. Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit Drejtues;
- Z. Michel Svetchine, Drejtor i përgjithshëm dhe anëtar i Bordit Drejtues deri me 26 mars 2008;
- Z. Hashim Rexhepi, Guvernator dhe anëtar i Bordit Drejtues që nga 27 mars 2008;
- Z. Lulzim Ismajli, Drejtor i Thesarit (anëtar i Bordit Drejtues);
- Znj. Chiara Bronchi, anëtare e Bordit Drejtues deri me 31 janar 2008;
- Z. Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit Drejtues që nga 13 qershor 2008.

**Komiteti ekzekutiv i BQK-së (me 31 dhjetor 2008):**

- Z. Hashim Rexhepi, Guvernator;
- Z. Gani Gërguri, Zëvendës Guvernator për Funkcionet Bankare Qendrore;
- Z. Nexhat Kryeziu, Zëvendës Guvernator për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar;
- Z. Agron Dida, Inspektor Gjeneral;
- Znj. Shkendije Himaj, Zyrtare e Lartë e Mbikëqyrjes;
- Z. Florim Maxharraj, Zyrtar i Lartë i Operacioneve.



Struktura organizative e BQK-së më 31 dhjetor 2008





## 1. Përmbledhje ekzekutive

Ekonomia botërore në vitin 2008 u karakterizua me krizë të rëndë financiare, efektet e së cilës u transmetuan edhe në sektorin real të ekonomisë, duke shkaktuar rënie në aktivitetin ekonomik. Recesioni që kaploi vendet e zhvilluara në masën më të madhe ka goditur prodhimin industrial duke rezultuar në një rritje të ndjeshme të normës së papunësisë. Për të zbutur pasojat e krizës ekonomike, vendet e zhvilluara ndërmorën masa të cilat kishin për qëllim stimulimin e kërkesës, kryesisht përmes uljes së normave bazë të interesit nga bankat qendrore si dhe politikave ekspansioniste fiskale. Po ashtu, nuk mungoi as qasja e koordinuar e vendeve të zhvilluara për të tejkaluar krizën të cilat propozuan masa të cilat kishin për qëllim rikthimin e besimit në tregjet financiare si dhe stimulimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Efektet e krizës ekonomike u reflektuan edhe në ekonomitë e vendeve të Evropës juglindore, ku posaqërisht kishte rënie të konsumit të brendshëm, eksporteve dhe investimeve. Ndërsa, efektet në sektorin financiar të këtyre vendeve ishin më të kufizuara se sa në vendet e zhvilluara.

Me gjithë shtrirjen e krizës, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2008 kishte një rritje reale të PBB-së prej 5.4 përqind. Rritja ekonomike në vitin 2008 u gjenerua nga rritja e konsumit privat dhe investimeve publike, të cilat në masë të madhe u financuan nga kreditë e sektorit bankar, dërgesat e emigrantëve, rritja e konsiderueshme e shpenzimeve publike si dhe asistencë e jashtme. Gjatë vitit 2008 u regjistrua rritje e konsiderueshme e shpenzimeve publike, veqanërisht atyre kapitale, të cilat ndikuan që Buxheti i Kosovës këtë vit të kalojë në deficit të ulët (0.2 përqind të PBB-së). Sektori financiar i Kosovës vazhdoi me performancë të kënaqshme. Gjatë vitit 2008 sektori bankar i cili vazhdon të zë vendin kryesor në sistemin financiar të Kosovës, kishte një normë vjetore të rritjes së depozitave prej 26.4 përqind dhe kredive me 32.7 përqind, duke financuar në masë të madhe konsumin dhe investimet e sektorit privat. Krahas zgjerimit të aktivitetit, sektori bankar i Kosovës po ashtu vazhdoi të ketë shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Në fund të vitit 2008, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.5 përqind ndërsa pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej portofolin ishte vetëm 3.3 përqind. Në përgjithësi, sektori financiar i Kosovës ka vazhduar të zgjerohet dhe të ruajë stabilitetin, me përjashtim të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, vlera e aksioneve të të cilit shënoi rënie të konsiderueshme si pasojë e krizës financiare.

Shkalla e lartë e varshmërisë së ekonomisë së Kosovës në importe vazhdon të rezultojë në shkallë të lartë të deficitit tregtar (43 përqind të PBB-së), gjë që po shkakton normë të lartë të deficitit në llogarinë

rrjedhëse (19.5 përqind të PBB-së). Me gjithë progresin, norma e lartë e papunësisë prej mbi 40 përqind vazhdon të jetë sfidë për ekonominë e vendit. Sfidat për ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2009 pritet të jenë më të mëdha, duke pasur parasysh vazhdimin e shtrirjes së krizës e cila në Kosovë pritet të reflektohet kryesisht përmes rënies së dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte, si dhe shtrëngimit eventual të kredidhënies nga bankat komerciale.

Si autoritet rregullativ dhe mbikëqyrës, një ndër objektivat kryesore të BQK-së mbetet zhvillimi dhe modernizimi i sektorit financiar duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare. Qasja e mbikëqyrjes së institucioneve financiare është zhvilluar me pikënisje nga 'qasja e bazuar në rregulla' në drejtim të 'qasjes së bazuar në rrezik', e formuluar sipas principeve themelore të Basel-it dhe shtyllës së dytë për bankat. Edhe te kompanitë e sigurimeve qasja e bazuar në rrezik është formuluar sipas një regjimi të aftësisë paguese bazuar në rrezikun për këto kompani. Gjatë vitit të kaluar u bënë zhvillime të dukshme në plotësimin e rregullativës ligjore bankare, të sigurimeve, pensioneve dhe asaj financiare jo-bankare, konform rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikëqyrjes të harmonizuar me direktivat e BE-së. Në kuadër të angazhimeve për të garantuar një sektor financiar sa më të sigurtë, gjatë vitit 2008, BQK ka vazhduar inspektimet nëpër të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë. Në bashkëpunim me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe shkollën e Frankfurtit, viti 2008 u karakterizua edhe me angazhimin e BQK-së në procesin e themelimit të Agjencionit për Sigurimin e Depozitave. Projekti për sigurimin e depozitave të institucioneve financiare është shqyrtuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe ligji është paraparë në planin legjislativ për miratim gjatë vitit 2009.

Krahas aktivitetit mbikëqyrës, BQK u siguroi institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjërë shërbimet e rëndomta që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të kreditimit ose ofrimit të likuiditetit të përkohshëm, pasi që BQK-ja nuk është bankë emetuese. Edhe gjatë vitit 2008, BQK-ja menaxhoi me kompetencë furnizimin e ekonomisë me kartëmonedha dhe monedha euro, duke ofruar njëkohësisht edhe shërbime të tjera bankare si menaxhimi i mjeteve të institucioneve qeveritare, publike, financiare, etj. Si një funksion shumë i rëndësishëm i BQK-së, sistemi i pagesave ndërbankare realizoi një ngritje të mëtejme. Gjatë vitit 2008, Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) kaloi në platformën teknologjike të uebit dhe u zhvillua skema e debitimit direkt, e cila do të funksionalizohet në vitin 2009. Krahasuar me vitin paraprak, numri i transaksioneve përmes SEKN në vitin 2008 u rrit për 107.2 përqind, ndërsa vlera e transaksioneve u rrit për 28.7 përqind. Gjatë vitit 2008,

BQK ka vazhduar të përmirësojë funksionalitetin e rexhistrit të kredive me çka është lehtësuar këmbimi i informacionit kreditor ndërmjet institucioneve kredidhënëse, duke kontribuar kështu në ruajtjen e stabilitetit të sektorit financiar. Progres i theksuar është regjistruar edhe në fushën e përpilimit të statistikave monetare e financiare si dhe atyre të bilancit të pagesave. Gjithashtu, BQK ka vazhduar të informojë publikun mbi zhvillimet ekonomike përmes analizave periodike dhe joperiodike të botuara në publikimet e BQK-së si dhe të mbështesë politikat e përgjithshme ekonomike në vend.

Auditimi i brendshëm i BQK-së ka vepruar në bazë të planit vjetor i cili në vitin 2008 ishte më specifik për shkak të krizës globale financiare. Rrjedhimisht, në baza javore janë audituar operacionet e investimeve të BQK-së në letra me vlerë dhe depozita të afatizuara, çka ka rezultuar me përpilimin e 53 raporteve speciale. Gjatë vitit 2008, progres është shënuar edhe në qeverisjen e burimeve njerëzore të BQK-së, ku është zhvilluar dhe implementuar një program progresiv i zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore duke filluar nga analiza e nevojave për trajnime të stafit, zhvillimi i politikave të trajnimit dhe punësimit, mbështetja e stafit për pjesëmarrje në trajnime të ndryshme, përmbushjen e kodit të etikës dhe mirësjelljes, si dhe vlerësimi i performancës.



## 2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

### 2.1. Ekonomia botërore<sup>1</sup>

Ekonomia botërore në vitin 2008 u karakterizua me krizë të rëndë financiare dhe rënie të aktivitetit ekonomik. Përmasat dhe shtrirja e shpejtë e krizës bëri që parashikimet për rritjen ekonomike të jenë më pesimiste, sidomos për tremujorin e fundit të vitit 2008 si dhe për vitin 2009. Kjo krizë evoluoi në tregjet financiare në SHBA. Më konkretisht, në tregun e kredive hipotekare të ashtuquajtura sub-prime (kreditë e lëshuara klientëve me gradim të ulët kreditor). Periudha e gjatë me norma të ulëta të interesit dhe derregullimi i tregjeve financiare rezultoi në një rritje të shpejtë të kredisë, përfshirë ato me kualitet më të ulët. Rrjedhimisht, shfaqja e presioneve inflacioniste shtynë Rezervën Federale të ngritë normën bazë të interesit. Kjo në radhë të parë ndikoi që kredimarrësit me gradim të ulët kreditor të kenë vështirësi në kthimin e kredive. Dështimi i një numri të madh të këtyre kredive shkaktoi rënie të çmimit të patundshmërive duke u reflektuar në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit kreditor të bankave dhe bankrotimin e disa prej tyre.

Si pasojë e shkallës së lartë të integritit të sistemeve financiare në botë, kriza financiare u shpërnda shumë shpejtë edhe në vendet tjera. Evoluimi i shpejtë i krizës financiare si dhe rënia e besimit në tregun ndërbankar rezultoi në rënie të likuiditetit dhe rritje të normave të interesit në këtë treg ku, për shembull, Libor dhe Euribor shënuan një rritje të vazhdueshme.<sup>2</sup> Për më tepër, financimi ndërbankar në afat më të gjatë pothuaj pushoi së ekzistuari. Si rezultat, një numër i konsiderueshëm i bankave u ndodh në vështirësi të mëdha financiare duke lëkundur besimin e përgjithshëm në tregje. Brenda një kohe të shkurtër, problemet në sektorin financiar u reflektuan edhe në sektorin real të ekonomisë. Kjo ndodhi kryesisht përmes shtrëngimit të kredisë për biznese dhe ekonomi familjare duke shkaktuar ngadalësimin e aktivitetit ekonomik dhe duke krijuar pasiguri të lartë në tregjet e kapitalit. Për shembull, indeksi mesatar i Dow Jones Industrial shënoi rënie substanciale gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009.

Zvogëlimi i kreditimit në sektorin real, lëkundja e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve u shoqërua me rënie të kërkesës së përgjithshme (rënies së konsumit të brendshëm, tregut të eksporteve

<sup>1</sup> Zhvillimet në ekonominë botërore dhe Evropën juglindore janë të bazuara në publikimet: IMF (2008), World Economic Outlook; IMF (2008), Regional Economic Outlook; EBRD (2008); Business Monitor International (2009); European Commission (2008); UNDP (2008); ECB (2009) dhe Eurostat (2009).

<sup>2</sup> Libor (London interbank offered rate) dhe Euribor (Euro interbank offered rate) janë normat e interesit në kredi ndërbankare që i ofrojnë bankat pjesëmarrëse njëra tjetrës për depozita afatshkurtëra në tregun monetar të Londrës dhe 57 bankave Evropiane, respektivisht.

dhe investimeve. Rënie ekonomike raportuan vendet e zhvilluara si SHBA-të, vendet e BE-së, Japonia, etj., si dhe vendet në zhvillim përfshirë Kinën, Indinë dhe Rusinë. Sipas vlerësimeve të fundit të Bankës Botërore, ekonomia botërore ka pasur një rritje ekonomike prej 1.9 përqind në vitin 2008, përderisa në vitin 2009 pritet të ketë një rënie prej 1.7 përqind. Në anën tjetër, Fondi Monetar Ndërkombëtar revidoi parashikimet duke raportuar rritje të ekonomisë botërore prej 3.4 përqind në vitin 2008 dhe një rritje prej 0.5 përqind për vitin 2009.

Recesioni që kaploi vendet e zhvilluara u karakterizua me rënie të prodhimit industrial prej 12 përqind, rënia më e madhe në 18 vitet e fundit, gjë që ndikoi në rritjen e ndjeshme të shkallës së papunësisë. Për shembull, në SHBA u shënuar rritja më e madhe e papunësisë në 25 vitet e fundit me 5.1 milion vende pune të humbura - kryesisht në sektorin e shërbimeve, industri përpunuese dhe në sektorin e ndërtimit. Kështu, në muajt e parë të vitit 2009 shkalla e papunësisë u rrit në 7.6 përqind krahasuar me 4.9 përqind sa ishte një vit më parë. Karakteristika të ngjashme të recesionit u shfaqën edhe në BE ku papunësia në fund të vitit 2008 arriti në tetë përqind krahasuar me 6.8 përqind sa ishte një vit më parë. Normat e papunësisë vazhduan të rriten ndjeshëm edhe në muajt e parë të vitit 2009 dhe ky trend pritet të vazhdojë deri në vitin 2010. Disa projeksione tregojnë se norma e papunësisë në fund të vitit 2010 pritet të arrijë në 9.5 përqind në SHBA dhe 10.2 përqind në BE, kur edhe pritet një rikuperim i ekonomisë në nivel botëror.

Për të zbutur pasojat e krizës ekonomike, një pjesë e madhe e vendeve të zhvilluara si SHBA-të dhe BE ndërmorrën politika ekspansioniste monetare e fiskale. Politikat monetare u karakterizuan me zbritje të theksuara të normave bazë të interesit nga bankat qendrore. Për shembull, të nxitura nga tkurrja ekonomike me të cilën u përballën Rezerva Federale, BQE dhe Banka e Anglisë, zbritën normat bazë të interesit disa herë gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009. Përderisa Rezerva Federale në dhjetor të vitit 2008 uli normën bazë të interesit në 0.25 përqind (krahasuar me 4.25 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2007), Banka e Anglisë dhe BQE ulën këtë normë në 2.0 dhe 2.5 përqind, përkatësisht (krahasuar me 5.5 dhe 4.0 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2007). Po ashtu, blerja e aseteve të këqija të bankave komerciale, injektimi i kapitalit, garantimi i detyrimeve të institucioneve financiare si dhe shtetëzimi i pjesshëm i disa institucioneve financiare ishin masat që u ndërmorrën nga qeveritë dhe bankat qendrore. Intervenimet e qeverive për stimulimin e kërkesës u karakterizuan edhe me masa ekspansioniste fiskale, kryesisht të karakterizuara me rritje të shpenzimeve qeveritare, zbritje të normave tatimore, etj., duke zbutur kështu

ndikimin e krizës në konsum dhe investime. Sidoqoftë, kjo do të reflektohet në rritje të deficiteve buxhetore me pasoja afatgjata makroekonomike.

Karakteristikë e kësaj krize është edhe tendenca për intervenim të koordinuar e qeverive, sidomos atyre të vendeve të zhvilluara anëtare të G20. Këto vende u dakorduan që problemet kyçe për tu adresuar mbesin rikthimi i besimit në tregje financiare si dhe nxitja e aktivitetit ekonomik në nivel global. Kjo do të arrihej përmes rritjes së transparencës dhe përgjegjësisë në sistemin financiar, përforcimin e rregulloreve të mbikëqyrjes financiare, promovimin e tregtisë globale dhe investimeve, fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe reformimin e institucioneve financiare ndërkombëtare. Po ashtu, këto vende arritën marrëveshje për ndarjen e një shume prej 1.1 bilion dollarëve amerikan, të destinuara për të përmirësuar financat ndërkombëtare, kredinë, tregtinë ndërkombëtare dhe stabilitetin e përgjithshëm ekonomik.

Zhvillim tjetër me rëndësi në ekonominë botërore gjatë vitit 2008 ishte shkalla e lartë e inflacionit që mbretëroi gjatë gjysmës së parë të vitit. Presionet inflacioniste u shkaktuan kryesisht nga ngritja e madhe e çmimeve të naftës, energjisë dhe produkteve ushqimore. Si pasojë, shkalla mesatare e inflacionit në nivel global arriti në 6.2 përqind në vitin 2008 krahasuar me 3.9 përqind sa ishte në vitin 2007. Kriza e ushqimit nuk u shkaktua vetëm nga ngritja e çmimeve të energjisë dhe transportit, por edhe nga prodhimi i vazhdueshëm i energjisë alternative nga vendet e zhvilluara me ç'rast shndërrimi i drithërave në lëndë djegëse ka ndikuar në zvogëlimin e sasisë së disponueshme të drithit në tregje. Sidoqoftë, pas korrikut të vitit 2008, çmimi i naftës pësoi rënie të shpejtë, kryesisht si pasojë e implikimeve të krizës globale ekonomike në rënien e kërkesës së përgjithshme duke shkaktuar rënie të madhe të kërkesës për naftë. Si rezultat, shkalla e inflacionit në nivel botëror shënoi rënie të shpejtë në muajt e fundit të vitit. Një trend i tillë rrezikoi shfaqjen e deflacionit, gjë që do të ndikonte në ngadalësimin e mëtejme të aktivitetit ekonomik. Parashikimet për zhvillimet inflacioniste në nivel global për vitin 2009 tregojnë për një trend rënës në gjysmën e parë të vitit si pasojë e recesionit. Sidoqoftë, presionet inflacioniste mund të rishfaqen si pasojë e politikave monetare dhe fiskale ekspansioniste të ndërmarra nga shumë vende. Një lëkundje e tillë e çmimeve do të shkakton pasiguri të mëtejme në tregje, duke ndikuar kështu negativisht nivelin e investimeve dhe aktivitetin ekonomik në përgjithësi.

Rënia që pësoi kërkesa botërore dhe recesioni i raportuar në shumicën e vendeve të zhvilluara në vitin 2008 ndikoi në zvogëlimin e tregtisë ndërkombëtare. Rënies së nivelit të përgjithshëm të tregtisë më së shumti i ka kontribuar sektori i shërbimeve dhe rënia e tregtimit të produkteve industriale, sektorë

këta që janë goditur në masë të ndjeshme nga kriza. Parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar sugjerojnë rënie prej 11 përqind të vëllimit të tregtisë ndërkombëtare në vitin 2009, ndërsa Banka Botërore parashikon një rënie prej 6.1 përqind.

Sa i përket kursit valutor, dollari amerikan kundrejt euros ka qenë mjaft jostabil gjatë vitit 2008. Përderisa në pjesën e parë të vitit dollari u vlerësua kundrejt euros, rënia e çmimit të naftës në gjysmën e dytë të vitit ndikoi në zhvlerësimin e dollarit. Zhvlerësimi i dollarit kundrejt euros në vitet e fundit ishte kryesisht rezultat i divergjencave ciklike ndërmjet ekonomisë amerikane dhe asaj evropiane, pasi që rritja stabile ekonomike që ka shënuar ekonomia evropiane në vitet e fundit i ka kontribuar stabilitetit të monedhës së euros. Në anën tjetër, ngadalësimi në rritjen ekonomike në SHBA ka ndikuar në dobësimin e dollarit. Sa i përket normës së këmbimit të euros me valuta tjera, në vitin 2008 euro u vlerësua edhe ndaj funtës britanike, ndërkaq u zhvlerësua kundrejt jen-it japonez. Në vitin 2008, norma mesatare vjetore e këmbimit të euros ishte 1.47 dollar amerikan (1.37 dollar në 2007), 152.45 jen japonez (161.25 jen në 2007) dhe 0.80 funta britanike (0.68 funta në 2007).

## 2.2. Evropa juglindore

Kriza ekonomike me të cilën po ballafaqohen vendet më të zhvilluara ka pasur implikime edhe në vendet e Evropës juglindore (EJL). Ritmi i rritjes ekonomike që patën këto vende për shumë vite u ngadalësua në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe do të vazhdojë të ngadalësohet edhe në vitin 2009. Shenjat e krizës u transmetuan kryesisht përmes rënies së konsumit, eksporteve dhe investimeve. Sipas vlerësimeve të fundit, rajoni i EJL-së ka pasur rritje ekonomike prej 5.7 përqind në vitin 2008, krahasuar me rritjen prej 6.7 përqind një vit më parë. Sektori që u ndikua në masë më të madhe është prodhimi industrial që pësoi rënie vjetore prej 21 përqind, ndërsa vendet që u ndikuan më së shumti nga kriza ishin Kroacia dhe Serbia, pasuar nga Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina. Parashikimet për vitin 2009 reflektojnë pesimizëm, pasi që tremujori i parë i vitit 2009 dëshmoi se efektet e krizës ekonomike janë më të theksuara se që pritej. Parashikimet për këto vende për vitin 2009 sugjerojnë një rënie ekonomike prej mesatarisht 2.1 përqind, me përjashtim të Shqipërisë që pritet të ketë një rritje prej 0.4 përqind. Ngadalësimi ekonomik në vitin 2009 pritet të shkaktohet kryesisht nga rënia e kreditimit ndaj sektorit real, rënia e mëtejme e eksporteve dhe rënia e investimeve të huaja direkte. Recesioni në vendet e zhvilluara pritet të ketë ndikim edhe në nivelin e dërgesave të emigrantëve në vendet e rajonit, të cilat janë burim shumë i rëndësishëm i financimit për disa nga këto vende.

Sikurse në vendet e BE-së, presionet inflacioniste u ndjenë edhe në EJL në gjysmën e parë të vitit 2008, duke u zbutur gjatë gjysmës së dytë të vitit si rezultat i politikave monetare të ndërmarra në këto vende, si dhe për shkak të rënies së kërkesës në nivel botëror dhe rënies së çmimeve të naftës. Ngritja e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore në gjysmën e parë të vitit pati ndikim më të madh në vendet e EJL-së se në vendet e zhvilluara. Kjo për arsye se produktet ushqimore dhe energjia përbëjnë komponentët kryesorë të shportës së konsumit në rajon. Në vitin 2008, norma mesatare të inflacionit në EJL arriti në 7.6 përqind, krahasuar me 3.3 përqind sa ishte një vit më parë dhe për vitin 2009, parashikimet tregojnë rënie të vazhdueshme të nivelit të çmimeve.

Ngritja e çmimeve në pjesën e parë të vitit 2008 si dhe rënia e eksporteve si pasojë e krizës ekonomike botërore ndikuan në rritjen e mëtejme të deficitit në llogarinë rrjedhëse në rajon. Sipas vlerësimeve, mesatarja e deficitit në llogarinë rrjedhëse në raport me PBB në vitin 2008 në EJL ishte rreth 16.6 përqind, krahasuar me 14.8 përqind sa ishte një vit më parë. Përpos rënies së eksporteve, edhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rënie në shumicën e vendeve të rajonit. Për më tepër, gjendja ekonomike në vendet e rajonit të cilat mbështeten fuqishëm në të ardhurat nga turizmi do të përkeqësohet edhe më tepër si pasojë e recesionit të raportuar në vendet e BE-së. Kursi i këmbimit i valutave të vendeve të rajonit kundrejt euros ishte mjaft jostabil gjatë vitit 2008. Normat mesatare vjetore të kursit të këmbimit të lekut shqiptar dhe kunës kroate u vlerësuan kundrejt euros, ndërsa ato të denarit maqedon dhe dinarit serb u zhvlerësuan në vitin 2008. Trendet e fundit tregojnë për një zhvlerësim të të gjitha këtyre valutave kundrejt euros, përkundër intervenimeve të vazhdueshme nga bankat qendrore në tregun bankar të valutave të huaja.

Sektori financiar në EJL u ndikua më pak nga kriza financiare krahasuar me vendet e zhvilluara. Sidoqoftë, besimi në sistemin bankar u lëkund lehtë duke u shprehur me tërheqje të depozitave në disa vende, kryesisht të Ballkanit Perëndimor, me ç'rast pati nevojë edhe për intervenim me likuiditet nga ana e bankave qendrore të atyre vendeve. Me gjithë lëkundjet e lehta, sistemi bankar i vendeve të EJL-së nuk është kapluar nga ndonjë shkallë e lartë e panikut dhe ka vazhduar të funksionojë. Ruajtjes së besimit në sistemin bankar në këto vende po ashtu i ka kontribuar garantimi shtetëror që i është bërë bankave të huaja që operojnë në vendet e EJL-së nga bankat amë në vendet e origjinës. Për më tepër, pothuaj të gjitha këto vende kanë ngritur pragun e sigurimit të depozitave, gjë që ka zvogëluar nivelin e pasigurisë tek depozitorët. Në tremujorin e parë të vitit 2009, nuk është vërejtur ndonjë zhvillim negativ në sektorin

bankar të këtyre vendeve, përveç zvogëlimit të dukshëm në normën e rritjes së kredisë, depozitave dhe rritjes së kredive të këqija.

### 3. Ekonomia e Kosovës

#### 3.1. Sektori real

E ndodhur përballë krizës financiare dhe recesionit që kaploi ekonominë globale, ekonomia e Kosovës ka arritur t'i rezistojë valës së parë të krizës. Rritja reale e PBB-së për vitin 2008 vlerësohet të ketë qenë 5.4 përqind, kryesisht e mbështetur nga konsumi privat dhe investimet publike. Gjatë vitit 2009 efektet e krizës globale mund të shfaqen në Kosovë dhe të reflektohen në një normë më të ulët të rritjes ekonomike. Parashikimet e FMN-së për vitin 2009 sugjerojnë një rritje reale të PBB-së prej 3.8 përqind, mirëpo ato mund të jenë subjekt i revidimit të mëtejshëm gjatë këtij viti. Gjendja në tregun e punës mbetet e vështirë, ku vazhdon të mbizotërojë një normë e lartë e papunësisë. Gjatë pjesës së parë të vitit 2008, ekonomia e Kosovës u përball me presione inflacioniste të cilat ndikuan negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe pozicionin e jashtëm. Sidoqoftë, presionet inflacioniste u zbutën gjatë gjysmës së dytë të vitit si rezultat i rënies së kërkesës në nivel global dhe rënies së çmimeve të naftës. Rënia e nivelit të përgjithshëm të çmimeve vazhdoi edhe gjatë fillimit të vitit 2009 dhe pritet të vazhdojë edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit.

##### 3.1.1. Produkti i Brendshëm Bruto

Vlerësimet e fundit të FMN-së tregojnë për një rritje ekonomike prej 5.4 përqind në vitin 2008, krahasuar me 3.9 përqind një vit më parë (Tabela 1). Rritja ekonomike në vitin 2008 u gjenerua nga rritja e konsumit dhe investimeve të cilat në masë të madhe u financuan nga kreditë e sektorit bankar, dërgesat e emigrantëve, rritja e konsiderueshme e shpenzimeve publike si dhe asistencat e jashtme.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2008 vazhdoi të dominohet në masë të madhe nga konsumi dhe investimet e sektorit privat që përbëjnë rreth 83.2 përqind dhe 72.0 përqind të konsumit dhe investimeve të përgjithshme, përkatësisht. Norma vjetore e rritjes së konsumit privat në vitin 2008 ishte 15.1 përqind krahasuar me 11.4 përqind sa ishte në vitin paraprak, përderisa investimet e sektorit privat u rritën me vetëm 3.6 përqind krahasuar me 21.7 përqind në vitin 2007. Kjo si pasojë e rënies së investimeve të huaja dhe stagnimit të procesit të privatizimit. Në anën tjetër, konsumi në sektorin publik shënoi rritje prej 11.4 përqind kurse investimet në këtë sektor u rritën me 141.4 përqind. Rrjedhimisht, kontribut më të rëndësishëm në rritje ekonomike në vitin 2008 kishte konsumi privat dhe investimet publike, pasuar nga investimet private dhe konsumi publik.

Tabela 1. Indikatorët kryesor makroekonomik, në miliona euro, nëse nuk ceket ndryshe.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
Rritja reale e PBB (%)	3.8	3.9	3.9	5.4
PBB nominal	3,067.8	3,192.0	3,425.0	3,804.0
Konsumi	3,443.2	3,558.4	3,877.1	4,438.8
Privat	2,729.5	2,881.7	3,209.4	3,694.8
Publik	713.7	676.7	667.8	744.0
Investimet	713.1	798.2	926.0	1,142.0
Private	528.3	652.2	793.5	821.9
Publike	184.8	146.0	132.6	320.0
Bilanci tregtar	-1,101.2	-1,195.1	-1,411.0	-1,732.3
PBB për banor (në euro)	1,482.1	1,519.8	1,611.0	1,759.0

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në mungesë të të dhënave për aktivitetin ekonomik në Kosovë sipas sektorëve, indikatorët si kreditë e sektorit bankar tregojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë vazhdon të mbështetet kryesisht në tregti. Kreditë në këtë sektor vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Edhe kreditë në sektorët tjerë të ekonomisë si bujqësia dhe industria po vazhdojnë të rriten (29 përqind dhe 4.9 përqind, përkatësisht). Megjithatë, norma e rritjes së kredimit ndaj këtyre sektorëve vazhdon të jetë më e ulët se norma mesatare e rritjes për ndërmarrjet në përgjithësi. Në anën tjetër, të dhënat e importit në bazë të Kategorive Kryesore Ekonomike (KKE) tregojnë për rritje të vazhdueshme të importit të mallrave të papërpunuara dhe mallrave kapitale, që është indikacion për rritjen e prodhimit vendor në Kosovë.


Sa i përket vitit 2009, parashikimet e FMN-së tregojnë për rritje reale të PBB-së prej 3.8 përqind, që paraqet një ngadalësim të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin 2008. Pritjet për një normë më të ulët të rritjes ekonomike gjatë vitit 2009 kryesisht mbështeten në efektet negative që kriza ekonomike botërore do të ketë në nivelin e dërgesave të emigrantëve, investimeve të huaja në Kosovë dhe kreditë e sektorit bankar. Këto burime të rëndësishme financimi për ekonominë e Kosovës kanë treguar shenja të ngadalësimit në fillim të vitit 2009. Për më tepër, kriza ekonomike mund të ketë ndikim negativ në të hyrat buxhetore për shkak të rënies së mundshme të importeve – si rezultat i rënies së kërkesës së përgjithshme – kur kemi parasysh se burimi kryesor i të hyrave buxhetore janë të hyrat tatimore që mblidhen në kufi. Kjo do të mund të reflektohej në shpenzime publike me implikime negative për

aktivitetin ekonomik në vend. Zvogëlimi i aktivitetit ekonomik po ashtu mund të ketë ndikim edhe në uljen e nivelit të kursimeve në vend, gjë që mund të reflektohet në nivel më të ulët të depozitave. Zvogëlimi i depozitave dhe ngadalësimi ekonomik në përgjithësi mund të ndikojë në ngadalësimin i kreditimit nga ana e sektorit bankar, gjë që do të ndikonte negativisht në konsum dhe investime. Prandaj, vazhdimi i kreditimit të shëndoshë është i rëndësishëm pasi që mund të zbutë efektet negative që mund të paraqiten nga kriza botërore. Po ashtu, ulja e normave tatimore në të ardhurat e individëve dhe të korporatave që nga janari i vitit 2009 paraqet një faktor inkurajues për ekonominë për shkak të rolit që mund të ketë në stimulimin e konsumit dhe investimeve në vend. Brenda kornizave të menaxhimit efikas të shpenzimeve publike, rritja e shpenzimeve qeveritare dhe veçanërisht atyre kapitale, do kishte rol të rëndësishëm në stimulimin e aktivitetit ekonomik. Gjithashtu, zvogëlimi i Aseteve të Jashtme Neto të Kosovës përmes investimit të një pjese të tyre në Kosovë do të siguronte nivel të konsiderueshëm të mjeteve likuide për ekonominë e vendit. Për shembull, pagesa e vlerës prej 20 përqind të fondit të privatizimit punëtorëve të ish-ndërmarrjeve publike të cilat janë privatizuar, do të ndikonte po ashtu në rritjen e konsumit dhe, rrjedhimisht, PBB-së.

### 3.1.2. Çmimet

Stabiliteti i çmimeve në Kosovë, i pranishëm që nga viti 2002, u ndikua ndjeshëm nga presionet e jashtme inflacioniste në fund të vitit 2007 dhe gjatë vitit 2008. Norma mesatare e inflacionit vjetor në vitin 2008 arriti në 9.3 përqind. Kjo ngritje ishte pasojë e ngritjes së çmimeve në nivel botëror. Kjo tregon ndjeshmërinë që ka niveli i çmimeve në Kosovë ndaj sektorit të jashtëm e që është pasojë e mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Presionet inflacioniste ishin kryesisht pasojë e ngritjes së çmimeve të produkteve ushqimore dhe pjesërisht energjisë në vitin 2008, pasi që norma mesatare vjetore e inflacionit pas përjashtimit të komponentës së produkteve ushqimore dhe energjisë ishte 2.9 përqind (Figura 1).

Figura 1. Çmimet e konsumit, mesatarja vjetore, në përqindje.



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës.

Gjatët vitit 2008, inflacioni i regjistruar në Kosovë ishte më i lartë krahasuar me vendet e BE-së (3.9 përqind) apo vendet e rajonit (7.6 përqind), kryesisht për shkak se pesha e produkteve ushqimore në shportën e konsumit në Kosovë është më e madhe se sa mesatarja e peshës së kësaj kategorie në vendet e BE-së dhe rajonit. Faktor tjetër që ndikoi në shkallën më të lartë të inflacionit në Kosovë ishin edhe kuotat në eksportet e grurit dhe produktet tjera ushqimore që vunë një pjesë e madhe e vendeve eksportuese të ushqimit si kundërpërgjigje ndaj krizës së ushqimit, përderisa pjesa më e madhe e produkteve ushqimore të importuara në Kosovë e kanë origjinën nga vendet që aplikuan këtë politikë. Rritja e çmimit të energjisë elektrike kontribuoi në masë më të vogël në rritjen e normës së inflacionit në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit, kryesisht për shkak të peshës më të vogël që ka kjo nënkategori në shportën e konsumit në Kosovë.

Norma më e lartë e inflacionit u shënuar në shtator të vitit 2008, kur inflacioni mesatar vjetor arriti në 11.5 përqind. Rënia e normës së inflacionit në muajt e fundit të vitit reflektoi rënien e shpejtë të çmimeve të naftës dhe si rezultat, edhe çmimeve të produkteve ushqimore, energjisë dhe transportit. Zhvillimet inflacioniste në muajt e parë të vitit 2009 tregojnë për tendencë rënëse. Ndryshimi i politikës fiskale në vend prej janarit të vitit 2009 do të mund të ndikojë në ngritjen e normës së inflacionit në pjesën e mbetur të vitit. Ndryshimi i politikës fiskale konsistoi në zbritjen e normës së tatimit në të ardhurat

personale dhe të korporatave, politikë kjo që do të ndikojë në rritjen e konsumit me ndikim në rritje të çmimeve. Në të njëjtën kohë, politika e ngritjes së normës së TVSH-së nga 15 në 16 përqind poashtu do të ketë efekt në rritjen e çmimeve, duke ndikuar kështu në zbutjen e deflacionit.

### 3.1.3. Tregu i punës

Gjendja në tregun e punës në Kosovë mbetet jo e kënaqshme dhe me një shkallë të lartë të papunësisë. Vlerësimet e ESK-së tregojnë se shkalla e papunësisë në vitin 2008 ishte rreth 40 përqind. Megjithatë, këto të dhëna duhet të analizohen me kujdes kur kemi parasysh që një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit ekonomik në Kosovë mbetet në sektorin joformal. Me numrin në rritje të punëkërkuësve, pjesa më e madhe e të papunësuarve në Kosovë kategorizohen si të papunësuar në periudhë afatgjatë (rreth 90 përqind), çka dëshmon për një dinamikë dhe kapacitet të kufizuar të ekonomisë së Kosovës për krijimin e vendeve të reja të punës.

Numri i përgjithshëm i punë kërkuësve të regjistruar në dhjetor të vitit 2008 ishte 335,942, që shënon një rritje prej 0.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë një vit më parë. Të papunësuarit e pakualifikuar përbëjnë numrin më të madh të regjistrimeve të reja. Sa i përket grup moshave, të rinjtë e moshës 15-24 vjeç kanë pjesëmarrjen më të madhe në numrin e të regjistruarve si të papunë. Sa i përket papunësisë sipas gjinisë, femrat përbëjnë rreth 47 përqind të numrit të përgjithshëm të punëkërkuësve. Kategorizimi i papunësisë sipas sektorëve të ekonomisë tregon se rreth 23.4 përqind e punëkërkuësve kanë qenë paraprakisht të punësuar në industri, përcjellur nga tregtia me 16.8 përqind dhe ndërtimtaria me 11 përqind.<sup>3</sup>

Sa i përket punëzënies, gjeneruesi kryesor i punësimit mbetet sektori privat i cili në vitin 2008 absorboi rreth 59 përqind të punësimeve të reja. Sektori i shërbimeve hapi rreth 64 përqind të vendeve të reja të punës të ofruara nga sektori privat, ndërsa sektori i prodhimit rreth 19 përqind. Sa i përket pagave në tregun e punës në Kosovë, sipas ESK-së, paga mesatare mujore në vitin 2008 ka qenë rreth 248 euro, që paraqet një rritje prej 2.5 përqind krahasuar me vitin paraprak. Pagat më të larta vazhdojnë të ofrohen nga sektori privat (258 euro) krahasuar me sektorin publik (237 euro), edhe përkundër rritjes së pagave prej 10 përqind për administratën publike dhe 35 përqind për sektorin e arsimit në fund të vitit 2008.

<sup>3</sup> Treguesi i papunësisë sipas aktivitetit ekonomik tregon aktivitetin ekonomik në të cilin punëkërkuësit aktual kanë qenë të angazhuar në punën e tyre të fundit.

Efekti i rritjes së pagës mesatare në vitin 2008 është zbehur si pasojë e inflacionit të lartë që ishte prezent në të njëjtën periudhë, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e pagës reale.

### 3.1.4. Privatizimi

Procesi i privatizimit në Kosovë që filloi në vitin 2003 paraqet një mundësi të mirë për rimëkëmbjen e industrisë së Kosovës. Gjatë vitit 2008 ky proces stagnoi dhe mund t'i atribuohet bartjes së kompetencave nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit në Agjencionin Kosovar të Privatizimit që ndodhi pas pavarësimit të vendit në shkurt të vitit 2008. Megjithatë, procesi i privatizimit rifilloi në fund të vitit 2008, kur edhe u shpallën disa valë të privatizimit dhe për vitin 2009 është paralajmëruar privatizimi i disa ndërmarrjeve të mëdha dhe me rëndësi strategjike.


Deri në dhjetor të vitit 2008, numri i kontratave të nënshkruara dhe në pritje arriti në 513, ndërsa shuma e mjeteve financiare të grumbulluara arriti vlerën 405.9 milion euro, që paraqet një rritje prej 2.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pjesëmarrja e të ardhurave nga privatizimi në PBB ka qenë 10.7 përqind në vitin 2008, krahasuar me 11.6 përqind në vitin 2007. Të dhënat nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit tregojnë se vlera totale e llogaritur e kontratave të shitjes të nënshkruara dhe në pritje arrin vlerën 398 milion euro në vitin 2008, prej të cilave 88.5 përqind janë të nënshkruara dhe 11.5 përqind janë në pritje. Nga vlera totale e kontratave të shitjes të nënshkruara dhe në pritje, shuma e shitjeve me anë të Spin-Off-it Special është rreth 96 milion euro. Shuma e investimeve në ndërmarrjet e privatizuara përmes Spin-Off-it Special deri në fund të vitit 2008 është vlerësuar të jetë rreth 125 milion euro, ndërkaq vlera totale e investimeve të dakorduara me kontratë rreth 196 milion euro. Fondi i grumbulluar nga procesi i privatizimit vazhdon të jetë i investuar në sektorin e jashtëm, gjë që ka shkaktuar tërheqje të konsiderueshme të mjeteve likuide nga ekonomia e Kosovës. Gjithashtu, financimi i një pjese të këtyre investimeve nga kreditë e sektorit bankar ka bërë që një pjesë e kursimeve në bankat komerciale të mos shfrytëzohen për financimin e ekonomisë vendore.

### 3.2. Sektori fiskal

Gjatë viteve të kaluara Buxheti i Kosovës është karakterizuar kryesisht me suficit. Pamundësia e qeverisë për të marrë borxh publik (të brendshëm dhe të jashtëm) për shkak të mungesës së ligjit mbi huamarrjen publike dhe mos definimit të statusit politik deri në shkurt të vitit 2008, ka kushtëzuar një sjellje më

konzervative të qeverisë në aspektin e politikave fiskale. Kështu, mjetet në dispozicion për të financuar ndonjë deficit buxhetor eventual përbëhen vetëm nga tepricat e akumuluar nga vitet e mëparshme. Sidoqoftë, anëtarësimi i Kosovës në FMN dhe anëtarësimi në institucionet tjera financiare ndërkombëtare do t'i hapë rrugë qeverisë së Kosovës të ketë qasje në burime të tjera të financimit për të adresuar nevojat eventuale buxhetore. Për dallim nga dy vitet e kaluara të cilat u karakterizuan me suficit buxhetor, në vitin 2008 Buxheti i Kosovës ishte pothuajse i balancuar me një deficit prej 8.1 milion euro (0.2 përqind e PBB-së), që ishte rezultat i normës më të lartë të rritjes së shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat (Figura 2).

Figura 2. Bilanci buxhetor, në miliona euro.




Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

### 3.2.1. Të hyrat buxhetore

Të hyrat e grumbulluara në buxhetin e Kosovës gjatë vitit 2008 ishin 942.5 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind. Megjithatë, norma e rritjes e shënuar në vitin 2008 ishte më e ulët krahasuar me vitin e kaluar (rritja 2007-2006 ishte 26.8 përqind). Kjo kryesisht për shkak se në vitin 2007, buxheti i Kosovës përfitoi shumë prej 75 milion euro nga liçencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë. Si rezultat i normës më të ulët të rritjes në vitin 2008, pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në PBB u zvogëlua në 24.8 përqind (nga 26.4 përqind sa ishte në vitin 2007). Raporti ndërmjet të hyrave buxhetore dhe PBB-së në Kosovë është në nivel më të ulët krahasuar me disa vende të rajonit (Shqipëria, Bosnia e

Hercegovina dhe Mali i Zi). Kjo tregon se të hyrat buxhetore mund të rriten edhe më tej, sidomos me masa për zvogëlim të ekonomisë joformale dhe zgjerim të bazës tatimore. Në këtë drejtim, kontribut të rëndësishëm mund të ketë zvogëlimi i normave tatimore që nga janari i vitit 2009.

Figura 3. Struktura e të hyrave buxhetore, në përqindje.



Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Burimi kryesor i të hyrave buxhetore në Kosovë vazhdojnë të jenë të hyrat nga tatimet e mbledhura në kufi, të cilat në vitin 2008 përfaqësuan 64.1 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore (58.9 përqind në vitin 2007). Sa i përket ndryshimit në vlerë, të hyrat nga tatimet e mbledhura në kufi shënuan një rritje vjetore prej 13.7 përqind. Mbështetja e lartë në këto të hyra rezulton nga shkalla e lartë e varshmërisë së ekonomisë së Kosovës në importe, gjë që shpjegohet edhe nga pjesëmarrja e lartë që TVSH e mbledhur në kufi ka në gjithsej të hyrat e Buxhetit të Kosovës.

Burim tjetër i rëndësishëm i të hyrave të Buxhetit të Kosovës janë tatimet vendore. Në vitin 2008 të hyrat e gjeneruara nga këto tatime përfaqësuan 21.3 përqind të gjithsej të hyrave (20.2 përqind në vitin 2007), ndërsa në vlerë shënuan një rritje vjetore prej 10 përqind. Burimi kryesor i tatimeve vendore janë të hyrat nga tatimet e korporatave të cilat në vitin 2008 përfaqësuan 32.3 përqind të gjithsej tatimeve vendore, pasuar nga TVSH me 29.4 përqind. Të hyrat jo-tatimore përfaqësuan 10 përqind të gjithsej të hyrave, një rënie prej 7.7 pp krahasuar me një vit më parë. Këto të hyra shënuan një rënie prej 40.7 përqind në vlerë krahasuar me vitin 2007 si rezultat i hyrjes në treg të operatorit të dytë të telefonisë


mobile gjatë vitit 2007, licencimi i të cilit siguroi të hyra buxhetore prej 75 milion euro. Të hyrat jokatimore kryesisht përbëhen nga taksat, licencat, gjobat dhe të hyra të tjera.

Një burim tjetër i të hyrave buxhetore, rëndësia e të cilit vazhdimisht po rritet, janë të hyrat e mbledhura nga qeveritë komunale. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të të hyrave në gjithsej të hyrat buxhetore në vitin 2008 arriti në 4.5 përqind (nga 3.2 përqind në vitin sa ishte 2007). Vlera e këtyre të hyrave në vitin 2008 shënoi një rritje vjetore prej 46.4 përqind.

### 3.2.2. Shpenzimet buxhetore

Gjatë vitit 2008, shpenzimet buxhetore kanë ndjekur një trend relativisht të shpejtë të rritjes duke realizuar normën më të lartë të rritjes vjetore që nga viti 2002. Shuma e shpenzimeve buxhetore në vitin 2008 arriti në 950.5 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 43.8 përqind. Në raport me PBB-në, shpenzimet buxhetore arritën në 25 përqind (krahasuar me 19.3 përqind në vitin 2007). Rritja e shpenzimeve buxhetore kryesisht është mbështetur në rritjen e shpenzimeve kapitale të cilat në vitin 2008 arritën vlerën prej 347.1 milion euro, një rritje vjetore prej 124.3 përqind. Kjo bëri që shpenzimet kapitale në vitin 2008 të absorbojnë pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës me një pjesëmarrje prej 36.5 përqind në gjithsej shpenzimet buxhetore, krahasuar me 23.4 përqind sa ishin në vitin e kaluar (Figura 4). Pjesëmarrjen më të lartë në shpenzimet kapitale e kanë investimet në infrastrukturën rrugore. Rritja e këtyre investimeve ka kontribuar në rritjen e vendeve të punës (së paku në afat të shkurtër), duke kontribuar edhe në stimulimin e kërkesës. Në afat më të gjatë, investimet kapitale do të krijojnë kushte më të volitshme për zhvillimin e biznesit në Kosovë, duke ndikuar edhe në tërheqjen e investimeve të huaja, me çka përmirësohen kushtet për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

Figura 4. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në përqindje.



Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Një kategori tjetër e shpenzimeve që ka kontribuar në masë të madhe në rritjen e nivelit të tërësishëm të shpenzimeve buxhetore janë shpenzimet për transfere dhe subvencione. Në vitin 2008, kjo kategori e shpenzimeve shënoi një rritje vjetore prej 42.8 përqind, duke arritur vlerën 218.5 milion euro (23 përqind e gjithsej shpenzimeve buxhetore). Kjo normë e rritjes së këtyre shpenzimeve kryesisht ka rezultuar nga rritja e subvencioneve për ndërmarrjet publike të cilat në vitin 2008 arritën vlerën 60.1 milion euro (28.6 përqind të gjithsej shpenzimeve për subvencione dhe transfere), që paraqet dyfishim krahasuar me vitin 2007. Rritja e vazhdueshme e subvencioneve ndërmarrjeve publike parashton nevojën për ristrukturimin e tyre. Në anën tjetër, në kuadër të shpenzimeve për subvencione dhe transfere, në mes tjerash, pagesat për pensionet bazë marrin pjesë me 37 përqind, ndërsa ato për ndihma sociale marrin pjesë me 12.4 përqind.

Në vitin 2008, pjesëmarrja e shpenzimeve për paga dhe mëditje në gjithsej shpenzimet buxhetore ishte 23.9 përqind, që është për 7.6 pp më e ulët se në vitin e kaluar. Ky zvogëlim ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të shpenzimeve kapitale, të cilat në masë të konsiderueshme rritën pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet. Sidoqoftë, shpenzimet për paga dhe mëditje shënuan një rritje në vlerë prej 8.9 përqind krahasuar me vitin 2007. Kjo rritje kryesisht është rezultat i rritjes së pagave për të punësuarit në sistemin arsimor të Kosovës (shkollat fillore dhe të mesme) që filloi të zbatohet nga muaji shtator i vitit 2008. Varësisht nga niveli i kualifikimit, pagat e të punësuarëve në sistemin arsimor shënuan një rritje prej 20

deri 40 përqind, gjë që ngriti pagën mesatare në arsim prej 191 euro në vitin 2007 në 233 euro. Gjatë vitit 2008, po ashtu u regjistrua edhe një rritje prej 10 përqind në pagat e administratës publike.

Mallrat dhe shërbimet absorbuan pjesën më të vogël të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2008. Pjesëmarrja e tyre në gjithsej shpenzimet buxhetore në vitin 2008 ishte 16.6 përqind krahasuar me 21.9% në vitin 2007. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së shpenzimeve për mallra dhe shërbime në gjithsej shpenzimet buxhetore rezultoi përkundër rritjes së vlerës së tyre për 8.9 përqind krahasuar me vitin 2007. Kjo po ashtu ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale.

Sa i përket vitit 2009, shpenzimet e buxhetuara arrijnë vlerën 1.1 miliard euro (16 përqind më të larta se në 2008) ndërsa të hyrat e planifikuara janë 956.5 milion euro (1.5 përqind më të larta se sa në 2008). Si rezultat, buxheti i Kosovës në vitin 2009 planifikohet të ketë deficit në vlerë prej 137.9 milion euro. Sidoqoftë, efektet e krizës në ekonominë e Kosovës mund të ndikojnë në performancën e të hyrave buxhetore dhe mund të thellojnë deficitin buxhetor më tej. Fillimi i vitit 2009 ka treguar ngadalsim të importeve, çka mund të shërbejë si tregues për ngadalësimin e aktivitetit të gjithëmbarshtëm ekonomik në Kosovë, e që në mënyrë direkte mund të ndikojë në zvogëlimin e të hyrave buxhetore. Si pasojë e rënies së importeve, në masën më të madhe mund të ndikohen të hyrat e mbledhura në kufi të cilat njëherit janë edhe burimi kryesor i të hyrave buxhetore.

Që nga janari 2009 kanë filluar të zbatohen ndryshimet në sistemin tatimor të Kosovës. Këto ndryshime karakterizohen me uljen e normave tatimore për të ardhurat personale nga 5, 10 dhe 20 përqind në 4, 8 dhe 10 përqind, përkatësisht. Gjithashtu, norma tatimore në të hyrat e tatueshme të korporatave (që ishte ndër më të lartat në rajon) zbriti prej 20 në 10 përqind, gjë që e rradhitë Kosovën ndër vendet me normën më të ulët të tatimit në të hyrat e korporatave në rajon. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, të hyrat buxhetore mund të ndikohen në mënyrë negative në afat të shkurtër. Sidoqoftë, vlerësimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave sugjerojnë se kjo rënie e mundëshme do të kompenzohet nga ngritja e normës së TVSH-së (nga 15 në 16 përqind) dhe akcizës në duhan (nga 17 euro në 21 euro për një kilogram) që ka hyrë në fuqi nga janari i vitit 2009.

### 3.3. Sektori financiar

Edhe përkundër zhvillimeve negative në sektorin financiar në nivel botëror, sektori financiar në Kosovë vazhdoi të rritet. Në fund të vitit 2008 totali i asetëve të sektorit arriti vlerën prej 2.3 miliarda euro, një

rritje prej 20.2 përqind krahasuar me vitin 2007. Kësaj norme të rritjes në masën më të madhe i ka kontribuar rritja e asetëve të sektorit bankar që përbëjnë rreth 80 përqind të gjithsej asetëve të sektorit financiar. Fondet pensionale përbëjnë 11.4 përqind të gjithsej asetëve të sektorit financiar, pasuar nga institucionet mikrofinanciare me pjesëmarrje prej pesë përqind, kompanitë e sigurimeve me 3.4 përqind dhe ndihmësit financiar me 0.2 përqind. Aktiviteti i institucioneve financiare në Kosovë nuk është kompleks dhe kryesisht bazohet në veprimtaritë financiare tradicionale. Sektori bankar kryesisht bazohet në kreditimin e ekonomisë duke u financuar nga depozitat e mbledhura nga qytetarët. Industria e sigurimeve si aktivitet kryesor ka sigurimin e Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë, ndërsa gjatë vitit 2008 ka filluar të ofrojë edhe produktet e sigurimit të jetës. Natyra e aktiviteteve të institucioneve financiare në Kosovë ka bërë që sektori financiar në masë të madhe të mos preket nga kriza financiare globale, me përjashtim të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) vlera e aksioneve e të cilit në bursat ndërkombëtare ka shënuar rënie të konsiderueshme.


Në fund të vitit 2008, Asetet e Jashtme Neto (AJN) të sektorit financiar kapën shumën 1.6 miliard euro.<sup>4</sup> Gjatë tremujorit të fundit të po këtij viti AJN për herë të parë patën rënie në vlerën e tyre. Krahasuar me tremujorin paraprak vlera e këtyre asetëve ishte për 9.5 përqind më e ulët (Figura 5). Kjo rënie kryesisht i atribuohet rënies së AJN-ve të BQK-së dhe pjesërisht të fondit pensional. Duke pasur parasysh se BQK menaxhon mjetet e qeverisë, rënia e AJN-ve në BQK lidhet me rritjen e konsiderueshme të shpenzimeve të qeverisë në tremujorin e fundit të vitit, përderisa rënia e AJN-ve të fondeve pensionale lidhet me rënien e vlerës së aksioneve të TKPK-së.

Sa i përket strukturës së kërkesave të sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm, në tremujorin e fundit të vitit 2008 ka pasur zhvendosje të këtyre asetëve prej depozitave në investime në letra me vlerë (kryesisht në bono thesari). Kështu, përderisa në fund të shtatorit 2008 rreth 66 përqind të kërkesave ishin depozita, në fund të vitit kjo pjesëmarrje zbriti në 46 përqind. Në anën tjetër, pjesëmarrja e investimeve në letra me vlerë përveç aksioneve u rrit prej 19 përqind sa ishte në fund të shtatorit 2008 në 38 përqind në fund të vitit. Kjo lëvizje ishte si rezultat i situatës në tregjet financiare botërore për faktin se bonot e thesarit konsiderohen si investime me nivel më të lartë të sigurisë. Për sa i përket detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, vlera e tyre në vitin 2008 ishte vetëm 133.6 milion euro, kryesisht të përbëra nga linjat kreditore që kanë institucionet financiare në Kosovë dhe nga depozitat e jo-rezidentëve.

---

<sup>4</sup> Këtu përfshihet BQK dhe të gjitha insitucionet financiare që operojnë në Kosovë.

Figura 5. Sektori financiar ndaj sektorëve të tjerë, në miliona euro.




Si rezultat i normës së lartë të rritjes së shpenzimeve qeveritare, kryesisht gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008, detyrimet e sektorit financiar ndaj atij fiskal regjistruan një normë më të ulët të rritjes. Detyrimet ndaj sektorit fiskal në fund të vitit 2008 ishin 877.2 milion euro, që paraqet një rritje prej vetëm 2.4 përqind krahasuar me dhjetorin e vitit 2007. Në anënt tjetër, kërkesat e sektorit financiar ndaj këtij sektorit mbeten inekzistente. Neto kërkesat e sektorit financiar vazhdojnë të kenë bilanc negativ edhe në raport me sektorin real (Figura 5). Detyrimet ndaj këtij sektori kapin vlerën 1.63 miliardë euro (te dominuara nga depozitat në sektorin bankar), ndërsa kërkesat në vitin 2008 arritën në 1.29 miliardë euro (të dominuara nga kreditë e lëshuara nga sektori bankar). Krahasuar me vitin e kaluar, dallim ndërmjet detyrimeve dhe kërkesave ndaj sektorit real është ngushtuar si rezultat i rritjes më të theksuar të kreditimit të sektorit privat të ekonomisë.

### 3.3.1. Struktura dhe aktiviteti i sektorit bankar

Që nga janari i vitit 2008, dy banka të reja me pronësi të huaj, Türk Ekonomi Bankasi (TEB) nga Turqia dhe Nova Ljubljanska Banka (NLB) Prishtina nga Sllovenia, filluan të operojnë në tregun bankar të Kosovës. Hyrja e TEB në tregun bankar të Kosovës në fund të vitit 2007 pasoi licencimin e plotë të kësaj banke nga BQK-ja. Në anën tjetër, NLB Prishtina është krijuar nga bashkimi i dy bankave vendore

(Kasabank dhe Banka e Re e Kosovës), pjesa më e madhe e aksioneve të të cilave ishte blerë paraprakisht nga NLB. Nga gjithsej tetë banka komerciale që operojnë në Kosovë vetëm dy kanë pronësi vendore, ndërsa pjesëmarrja e aseteve të bankave të huaja në gjithsej asetet e sektorit bankar është rreth 90 përqind (Figura 6).

Figure 6. Struktura e aseteve sipas pronësisë, në përqindje.



Hyrja e bankave të reja në treg ka nxitur edhe rritjen e konkurrencës në sektorin bankar të Kosovës, e cila deri në një masë mund të shprehet përmes rënies së shkallës së koncentrimit. Në vitin 2008 Indeksi Herfindahl-Hirschman (tregues i shkallës së koncentrimit në një industri) ra në 2,747 krahasuar me 2,862 sa ishte në vitin 2007. Rritja e shkallës së konkurrencës në sektorin bankar të Kosovës mund të vërehet edhe nga ngushtimi i hendekut në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita si dhe ofrimi i produkteve të reja në treg. Për më tepër, është vërejtur një shtrirje më e madhe gjeografike e bankave, gjë që ka sjellur shërbimet bankare më afër qytetarëve. Numri i degëve të bankave komerciale në vitin 2008 arriti në 46 (38 në vitin 2007), ndërsa numri i nëndegëve arriti në 233 (189 në vitin 2007). Po ashtu, është shënuar një rritje e konsiderueshme e ofrimit të shërbimeve bankare si bankomatët, pikat e shitjes, llogaritë elektronike bankare, etj., të cilat kanë lehtësuar qasjen e klientëve në shërbimet bankare (Tabela 2).

Tabela 2. Rrjeti i sektorit bankar.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
Numri i degëve dhe nëndegëve	230	214	227	279
Numri i bankomatëve	102	116	155	240
Numri i pikave të shitjes	1,406	1,767	2,554	3,426
Numri i llogarive elektronike	837	2,872	4,742	13,051

Gjatë vitit 2008, sektori bankar i Kosovës ka intensifikuar aktivitetin duke rritur në masë të konsiderueshme si kreditë ashtu edhe depozitat. Rritja e shkallës së ndërmjetësimit financiar është reflektuar në rritje të profitit të bankave, përderisa sistemi vazhdon të jetë i qëndrueshëm me nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe solvencës.

### 3.3.1.1. Bilanci i gjendjes

Asetet e sektorit bankar në vitin 2008 arritën vlerën 1.8 miliard euro (47.5 përqind e PBB) e cila paraqet një rritje vjetore prej 26.3 përqind. Pjesa më e madhe asetëve të sektorit bankar vazhdojnë të jenë kreditë të cilat në vitin 2008 përfaqësuan 65.4 përqind të gjithsej asetëve. Gjatë vitit 2008, investimet e sektorit bankar në letra me vlerë kanë vazhduar të shënojnë rënie. Pjesëmarrja e letrave me vlerë në gjithsej asetet e sektorit bankar në vitin 2008 ishte 2.2 përqind, krahasuar me 5.5 përqind sa ishte në vitin 2007(Tabela 3).

Tabela 3. Struktura e asetëve, në miliona euro.


Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	131.7	141.1	189.0	218.2
Bilanci me bankat komerciale	221.9	243.3	208.1	283.9
Letrat me vlerë	82.9	99.4	78.9	40.5
Kreditë bruto dhe lizingu	513.9	636.6	892.1	1,183.4
Asetet fikse	16.9	23.0	27.2	39.0
Asetet tjera	17.0	17.9	39.7	43.1
<b>Gjithsej asetet</b>	<b>984.4</b>	<b>1,161.2</b>	<b>1,435.0</b>	<b>1,808.2</b>

Në fund të vitit 2008, kreditë e lëshuara nga sistemi bankar arritën vlerën 1.2 miliard euro, apo 31.1 përqind e PBB-së, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 32.7 përqind. Rritja e kreditimit të sektorit bankar është e një rëndësie të veçantë pasi që shtrëngimi eventual i kredidhënies në këtë periudhë do të ndikonte negativisht në nivelin e konsumit dhe investimeve në Kosovë. Kjo do të rritë pasojat që ekonomia e Kosovës mund të bartë nga recesioni ekonomik global. Rrjedhimisht, rënia e aktivitetit ekonomik mund të reflektohet negativisht në vet qëndrueshmërinë e sektorit bankar. Sidoqoftë, vazhdimi i rritjes së kreditimit nga sektori bankar duhet jetë në harmoni me kapacitetet e bankave komerciale për t'iu përmbajtur parimeve të kreditimit të shëndoshë.

Me gjithë rritjen e shpejtë të kredisë gjatë vitit 2008, cilësia e portofolit kreditor mbetet e mirë me një pjesëmarrje prej vetëm 3.3 përqind të kredive joperformuese në gjithsej kreditë (4.1 përqind në vitin 2007). Ky nivel i kredive me probleme si dhe niveli i kënaqshëm i provizionimit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit sigurojnë se edhe në rast të një rritje më të theksuar të kredive me probleme, sistemi bankar i Kosovës mbetet stabil. Këtë konstatim e përkrahin edhe rezultatet e gjeneruara përmes modelit 'stress-test' për sektorin bankar në Kosovë.


Struktura e kredive sipas sektorëve edhe në vitin 2008 ka mbetur e ngjajshme me periudhat e kaluara. Pjesëmarrjen më të madhe në kredi e kanë ndërmarrjet me 76.3 përqind të gjithsej kredive (77.5 përqind në 2007), ndërsa ekonomitë familjare 23.7 përqind (22.5 përqind në 2007). Në kuadër të kredive të ndërmarrjeve, dominojnë ndërmarrjet që merren me tregti me një pjesëmarrje prej 42.6 përqind në gjithsej kreditë e sistemit bankar (Figura 7). Megjithatë, krahasuar me vitin 2007, pjesëmarrja e kredive të ndërmarrjeve tregtare në gjithsej kreditë ishte për 4.3 pp më e ulët dhe kjo kryesisht si rezultat i rritjes më të shpejtë të kredisë për ndërmarrjet që merren me shërbime të tjera. Pjesëmarrja e lartë e kredive lëshuar ndërmarrjeve të cilat merren me tregti në gjithsej kreditë e sektorit bankar reflekton strukturën e ekonomisë së Kosovës e cila në masë të madhe dominohet nga ky sektor. Sektori me pjesëmarrjen më ulët në kreditë e sektorit bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, përfaqësuar me vetëm 4.1 përqind në gjithsej kreditë. Megjithatë, në vitin 2008 vërehet një rritje vjetore prej 29 përqind në kreditë e lëshuara këtij sektori. Rritja e kreditimit të bujqësisë dhe sektorëve tjerë prodhues të ekonomisë do të kontribuonte në substituimin e importeve dhe eventualisht do të stimulonte eksportin, duke u reflektuar në mënyrë direkte në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në rritje ekonomike. Megjithatë, rritja e kreditimit për këta sektorë është e kushtëzuar edhe nga ngritja e kapaciteteve absorbuese të tyre.

Figura 7. Struktura e kredive të ndërmarrjeve, në miliona euro.



Rritja e vazhdueshme e kreditimit të ekonomisë së Kosovës nga sektori bankar gjithashtu flet për ngritje të shkallës së pjekurisë të ambientit afarist në Kosovë. Kjo tregohet edhe nga rritja e vazhdueshme e kredive me afat maturimi më të gjatë. Kreditë me afat maturimi prej më shumë se dy vite përfaqësojnë pjesën më të madhe të kredive duke arritur në 68.3 përqind e totalit të kredive në fund të vitit 2008, nga 60.7 përqind në vitin 2007 (Figura 8).

Figura 8. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje.




Sa i përket detyrimeve të sektorit bankar, ato kryesisht përbëhen nga depozitat të cilat përfaqësojnë 79.9 përqind të gjithsej detyrimeve (Tabela 4). Kjo tregon se aktiviteti i sektorit bankar të Kosovës kryesisht mbështetet në burimet e financimit në Kosovë dhe ka ndjeshmëri të ulët ndaj fluktuimeve në ofertën dhe koston e fondeve në sektorin e jashtëm. Bilanci nga bankat tjera në vitin 2008 përfaqësoi 1.9 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar.

Tabela 4. Struktura e detyrimeve, në miliona euro.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
Bilanci nga bankat tjera	23.0	30.3	25.8	34.9
Depozitat	836.7	924.3	1,143.1	1,444.1
Huamarrjet tjera	6.4	4.2	2.7	...
Detyrimet Tjera	37.3	92.1	103.7	129.8
Borxhi vartës	7.0	7.0	7.0	7.0
Mjetet vetanake	74.0	103.3	152.7	192.5
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>984.4</b>	<b>1,161.2</b>	<b>1,435.0</b>	<b>1,808.2</b>

Gjatë vitit 2008, depozitat shënuan një normë më të lartë të rritjes krahasuar me vitet e kaluara. Duke shënuar një rritje vjetore prej 26.4 përqind, vlera e depozitave në vitin 2008 arriti në 1.4 miliard euro, apo 38 përqind e PBB-së. Burimi kryesor i depozitave të sektorit bankar vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare të cilat në vitin 2008 gjeneruan 58.4 përqind të gjithsej depozitave. Burim tjetër me rëndësi për depozitat e bankave komerciale në Kosovë janë ndërmarrjet publike, depozitat e të cilave përfaqësojnë 18.3 përqind të gjithsej depozitave, të pasuara nga depozitat e ndërmarrjeve private të cilat përbëjnë 15.8 përqind të gjithsej depozitave. Sa i përket afatit të maturimit, 29.9 përqind e depozitave janë të transferueshme ndërse pjesa e mbetur përbëhet nga kursimet dhe depozitat e afatizuara ku dominojnë depozitat me afat të shkurtër (Figura 9). Depozitat me afat maturimi prej më pak se dy vite në vitin 2008 përfaqësuan 64.9 përqind të gjithsej depozitave (62.1 përqind në vitin 2007), ndërsa ato me afat maturimi prej më shumë se dy vite përfaqësuan vetëm 5.2 përqind të gjithsej depozitave (4.7 përqind në vitin 2007).

Figura 9. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit, në përqindje.




### 3.3.1.2. Normat e interesit <sup>5</sup>

Rritja e konkurrencës në sektorin bankar ka ndikuar deri në një masë në ngushtimin e dallimit në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita. Në vitin 2008, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita qëndroi në 9.37pp, krahasuar me 11.56pp në vitin 2007. Në dhjetor të vitit 2008 norma e interesit në kredi ishte 13.79 përqind, që paraqet një rënie prej 1.8pp krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007 (Figura 10). Për të pasur një ulje edhe më të theksuar të normave të interesit, rol shumë i rëndësishëm i takon edhe vetë bizneseve të cilat përmes avancimit të kapaciteteve planifikuese të tyre dhe raportimit më të saktë financiar mund të ndikojnë në zvogëlimin e nivelit të perceptuar të rrezikut nga sistemi bankar për mjedisin afarist në Kosovë.

<sup>5</sup> Normat e interesit janë mesatare të ponderuara sipas produkteve dhe afateve të ndryshme.

Figura 10. Normat e interesit, në përqindje.



Rritja e konkurrencës gjatë vitit 2008 u reflektua edhe në ngritjen e normave të interesit në depozita. Në dhjetor të vitit 2008, normat e interesit në depozita qëndruan në 4.42 përqind krahasuar me 4.00 përqind në dhjetor të vitit të kaluar. Rritja e normave të interesit në depozita mund të ngadalësojë uljen e normave të interesit në kredi, pasi që ndikon drejtëpërsëdrejti në rritjen e kostos së ndërmjetësimit financiar të bankave.

### 3.3.1.3. Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2008 ishte profitabil me një profit neto prej 36.4 milion euro, që është për 8.7 përqind më i lartë se profiti i realizuar në vitin 2007 (Tabela 5). Në vitin 2008, kthimi mesatar në asete ishte 2.2 përqind, ndërsa kthimi mesatar në kapital ishte 20.2 përqind.

Të hyrat e sektorit bankar në vitin 2008 arritën vlerën 195 milion euro, që është për 24 përqind më e lartë se në vitin e kaluar. Ato vazhdojnë të mbështeten kryesisht në të hyrat nga interesi, të cilat përfaqësojnë 79.8 përqind të gjithsej të hyrave. Pjesa më e madhe e të hyrave gjenerohet nga interesi në kredi që përbën 72 përqind të gjithsej të hyrave. Varësia e lartë e të hyrave të sektorit bankar nga interesi në kredi e bën të ndjeshëm profitin e këtij sektori ndaj këtyre të hyrave. Rritja e vazhdueshme e konkurrencës në sektorin bankar shkakton presion të mëtejshëm për uljen e normave të interesit në kredi,

gjë që ndikon drejtpërsëdrejti këto të hyra. Sidoqoftë, rezultatet e gjeneruara nga modeli 'stress-test' tregojnë se sistemi bankar i Kosovës është i qëndrueshëm kundrejt rrezikut nga normat e interesit. Kjo kryesisht për shkak të normës së lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit në sektorin bankar si dhe për shkak se pjesa më e madhe e kredive të lëshuara nga sistemi bankar ka norma fikse të interesit.

Tabela 5. Bilanci i suksesit, në miliona euro.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
<b>Të hyrat</b>				
Të hyrat nga interesi	74.6	88.8	117.9	155.7
Të hyrat nga jo-interesi 1/	19.7	25.2	39.5	39.3
Gjithsej të hyrat	94.3	114.0	157.3	195.0
<b>Shpenzimet</b>				
Shpenzimet e interesit	15.4	19.9	26.0	38.1
Shpenzimet tjera përveç të interesit	13.4	13.7	19.9	21.9
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative 1/	49.2	54.8	69.7	86.0
Gjithsej shpenzimet	78.0	88.5	115.6	146.0
<b>Të hyrat neto</b>				
Të hyrat operuese neto	16.3	25.5	41.7	49.0
Të hyrat neto para tatimit	16.9	26.6	41.3	47.6
Provizionet për tatim	3.4	6.4	7.9	11.2
Neto fitimi/humbja brenda periudhës	13.5	20.2	33.5	36.4

1/ Ndryshime metodologjike nga viti 2007.

Në vitin 2008, vlera e shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 146.0 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 26.3 përqind. Struktura e shpenzimeve kryesisht përbëhet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të cilat në fund të vitit 2008 përfaqësuan 58.9 përqind të totalit (60.3 përqind në vitin 2007). Gjatë vitit 2008, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative treguan një trend relativisht të shpejtë të rritjes, që kryesisht mund t'i atribuohet hyrjes së bankave të reja në treg dhe shpenzimeve për konsolidimin e tyre si dhe zgjerimit të rrjetit të degëve dhe nëndegëve të bankave ekzistuese. Megjithatë, trendi i rritjes së këtyre shpenzimeve u ngadalësua dukshëm në fund të vitit. Një rritje relativisht e shpejtë u regjistrua edhe në shpenzimet e interesit në depozita, të cilat në fund të vitit 2008 përfaqësuan 24.1 përqind të gjithsej shpenzimeve (20 përqind në vitin 2007). Kjo kryesisht i atribuohet rritjes së shpejtë në vëllimin dhe normat e interesit të depozitave gjatë vitit 2008.

Pjesëmarrja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative në mesataren e aseteve të sektorit bankar shënoi një rënie të lehtë në vitin 2008, çka sugjeron përmirësim të efikasitetit në këtë sektor. Në

vitin 2008, ky tregues ishte 5.3 përqind krahasuar me 5.4 përqind në vitin 2007. Gjithashtu, një përmirësim i lehtë i efikasitetit të sektorit bankar shprehet edhe përmes vlerës së kredive të sektorit bankar për një punëtor në këtë sektor. Në vitin 2008, vlera mesatare e kredive të lëshuara nga sektori bankar për një punëtor ishte 315 mijë euro, krahasuar me 312 mijë euro në vitin 2007. Megjithatë, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave të sektorit bankar shënoi një ngritje të lehtë (74.9 përqind në 2008 krahasuar me 73.5 përqind në 2007), çka mund të shërbejë si tregues për një rënie të lehtë në efikasitetin e sektorit. Sidoqoftë, kjo mund të jetë si rezultat i rritjes së shpejtë të numrit të punëtorëve në sistemin bankar gjatë vitit 2008 për shkak të hyrjes së bankave të reja si dhe zgjerimit të rrjetit të bankave ekzistuese.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të jetë likuid. Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në fund të vitit 2008 ishte rreth 80 përqind, që është në kuadër të margjinave të rekomanduara nga BQK-ja. Përkundër rritjes së shpejtë të kredisë gjatë vitit 2008, pjesëmarrja e asetëve likuide në gjithsej asetet e sektorit bankar ishte 30 përqind (33.2 përqind në vitin 2007). Gjendja e kënaqshme e likuiditetit në sistemin bankar tregohet edhe nga rezultatet e modelit 'stress-test'. Po ashtu, sistemi bankar i Kosovës gjithashtu vazhdon të jetë solvent me Tregues të Mjaftueshmërisë së Kapitalit prej 16.5 përqind, që është dukshëm mbi nivelin minimal prej 12 përqind të përcaktuar nga BQK-ja. Për më tepër, asnjë nga bankat që operojnë në Kosovë nuk e ka këtë tregues nën nivelin minimal të kërkuar nga rregullatori.

### 3.3.2. Kompanitë e sigurimeve

Gjatë vitit 2008 në tregun kosovar të industrisë së sigurimeve hyri edhe një kompani e re, që solli në 10 numrin e kompanive që operojnë në vend. Shtatë nga kompanitë e sigurimeve në Kosovë janë me pronësi të huaj, e që menaxhojnë rreth 73 përqind të gjithsej asetëve të këtij sektori. Aktiviteti dominues i këtij sektori mbetet sigurimi i automjeteve përmes policave të Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë (PPT). Megjithatë, gjatë vitit 2008 sektori i sigurimeve në Kosovë filloi edhe me një produkt të ri – atë të sigurimit të jetës. Edhe pse ky produkt ofrohet vetëm nga një kompani e sigurimeve, kjo tregon interesimin e kompanive për avancimin dhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre, duke ndikuar kështu në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar në Kosovë. Gjatë vitit 2008, BQK lejoi liberalizimin e kontrolluar në përcaktimin e tarifave për policat PPT, çka pritet të ndikojë në rritjen e mëtutjeshme të konkurrencës në këtë sektor.

Në krahasim me vitin 2007, zgjerimi i aktivitetit të sektorit të sigurimeve dëshmohej edhe me rritjen e numrit të policave të shitura gjatë vitit 2008. Në fund të vitit 2008 numri total i policave të shitura arriti në 476,000, apo një rritje vjetore prej 17.2 përqind. Struktura e policave të shitura mbetet e ngjashme me vitet e kaluara, ku mbi 50 përqind të tyre të jenë polica PPT, 32 përqind polica doganore, ndërsa pjesa e mbetur përfaqësohet nga policat e tjera (jo PPT). Premiumet e akumuluar nga kompanitë e sigurimeve gjatë vitit 2008 arritën shumën 56.4 milion euro, apo 11 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2007. Shuma e dëmeve të paguara gjatë vitit 2008 ishte për 37.8 përqind më e lartë se ajo e vitit 2007, duke arritur kështu vlerën prej 17.7 milion euro. Si rezultat, niveli i dëmeve të paguara në raport me premiumet e akumuluar arriti në 31.4 përqind, krahasuar me 25.2 përqind sa ishte në fund të vitit 2007.

Në fund të vitit 2008, asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën prej 78.4 milion euro, apo 10.7 përqind më të lartë se sa në fund të vitit 2007. Depozitat vazhdojnë të jenë komponenti dominant në anën e aseteve, përderisa detyrimet dominohen nga kapitali aksionar (45.8 përqind e gjithsej detyrimeve). Kjo tregon se niveli i kapitalizimit të sektorit të sigurimeve është mjaft i lartë, çka rezulton në qëndrueshmëri e stabilitet të këtij sektori.

### 3.3.3. Fondet pensionale

Sistemi pensional i Kosovës është sistem modern i cili është i organizuar në tri shtylla kryesore. Shtylla e parë përfshinë pensionin bazë i cili paguhet nga Buxheti i Kosovës të gjithë personave më të vjetër se 65 vjet në vlerë prej 75 euro. Shtylla e dytë përfshinë kontributet individuale për pension, të menaxhuara nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) dhe të financuara nga vetë kontribuesit dhe punëdhënësit (pesë përqind secila palë). Shtylla e tretë përfshinë skemat vullnetare të pensioneve, të menaxhuara nga TKPK dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve dhe të financuara vullnetarisht nga kontribuesi apo edhe punëdhënësi.

Në vitin 2008, asetet e fondeve të pensioneve që operojnë në Kosovë shënuan vlerën 256.3 milion euro, që paraqet një rënie vjetore prej 10.4 përqind. Zvogëlimi i aseteve të këtyre fondeve është rezultat i krizës financiare globale që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ka goditur vlerën e aksioneve të TKPK-së, që njëherit menaxhon pjesën më të madhe të kontributeve pensionale në Kosovë. Në fund të vitit 2008, TKPK raportoi se vlera e kursimeve në këtë fond ka rënë për 91 milion euro apo 29 përqind. Kjo rënie kryesisht është regjistruar gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008. Megjithatë, masat e ndërmarra nga

vendet e zhvilluara për luftimin e krizës kanë filluar të kontribuojnë në kthimin e besimit në tregjet ndërkombëtare, gjë që ka rezultuar me ngritje të çmimeve të aksioneve në bursat ndërkombëtare kohëve të fundit. Si rezultat i kësaj, vetëm në muajin prill të vitit 2009, TKPK ka raportuar një kthim pozitiv prej 12.4 milion euro.

Gjatë vitit 2008, numri i kontribuesëve në shtyllën e dytë të pensioneve (TKPK) ka vazhduar të rritet. Në fund të vitit, numri i kontribuesve në këtë shtyllë arriti në rreth 270,000 përderisa beneficionet e paguara arritën vlerën 2.6 milion euro. Sa i përket investimit të fondeve të menaxhuara nga TKPK, rreth 20 përqind e tyre janë të depozituara në Kosovë, prej të cilave afërsisht gjysma në dy banka komerciale kurse pjesa e mbetur në BQK. Pjesa më e madhe e mjeteve të TKPK-së (rreth 204 milion euro apo 80 përqind) vazhdon të jetë e investuar në tregjet e jashtme.

### **3.3.4. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar**

Krahas bankave komerciale, edhe institucionet mikrofinanciare kanë rol të rëndësishëm në kreditimin e ekonomisë së Kosovës. Aktiviteti kryesor i këtyre institucioneve është dhënia e kredive ekonomive familjare, bizneseve të vogla dhe agro-bizneseve. Grumbullimi i depozitave nuk është i lejuar për këto institucione, andaj burimi kryesor i financimit të tyre janë linjat kreditore që përbëjnë 55.1 përqind të gjithsej aseteve, përderisa pjesa tjetër kryesisht financohet nga kapitali.

Në fund të vitit 2008 numri i institucioneve mikro-financiare që operonin në Kosovë ishte 16, të cilat së bashku kanë lëshuar 50,127 kredi që kapin vlerën 93.6 milion euro. Kjo kategori e institucioneve mbulon 7.3 përqind të gjithsej kredive të sektorit financiar në Kosovë.

Në Kosovë operojnë edhe institucionet financiare të ashtuquajtura ndihmësit financiar, që aktivitet kryesor kanë këmbimin e valutës apo transferin e parave me jashtë. Gjatë vitit 2008 përmes agjensioneve për transferimin e parave janë transferuar rreth 233 milion euro, prej të cilave mbi 90 përqind janë transfere hyrëse në Kosovë. Megjithatë, shumica e transfereve ndërkombëtare në Kosovë kryhen përmes bankave komerciale (rreth 73 përqind të gjithsej transfereve ndërkombëtare).

### 3.4. Sektori i jashtëm

Karakteristikë e bilancit të pagesave të Kosovës mbetet deficit i lartë në llogarinë rrjedhëse si dhe bilanci pozitiv në llogarinë kapitale dhe financiare (Tabela 6). Deficiti në llogarinë rrjedhëse në vitin 2008 arriti vlerën 743.8 milion euro apo 19.5 përqind të PBB-së ( 12.5 përqind e PBB-së në vitin 2007), përfshirë edhe asistencën e jashtme. Deficiti në llogarinë rrjedhëse vjen si rezultat i varshmërisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe si dhe niveli mjaft i ulët i eksporteve. Në vitin 2008 importet shënuan rritje si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme (kryesisht rritja e shpenzimeve publike dhe konsumit privat). Ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e konsumit privat është edhe rritja e kredive të lëshuara nga bankat komerciale. Ndikim në thellimin e deficitit ka mundur të ketë edhe vlerësimi i normës reale efektive të këmbimit (NREK) që kryesisht është nxitur nga norma më e lartë e inflacionit në Kosovë.<sup>6</sup> Kjo mund të ketë ndikuar negativisht konkurrueshmërinë e produkteve Kosovare në tregjet e jashtme duke dekurajuar eksportet, përderisa importet mund të jenë bërë më të lira për importuesit Kosovarë. Në anën tjetër, faktorët të cilët kanë kontribuar në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë dërgesat e emigrantëve (14.1 përqind i PBB-së) dhe asistenca e jashtme (7.6 përqind i PBB-së), vlera e të cilave në vitin 2008 ishte 535.8 milion euro dhe 288.9 milion euro, përkatësisht.

---

<sup>6</sup> NREK bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit u vlerësua me mesatarisht 2.9 përqind kundrejt valutave të partnerëve tregtar. Ky vlerësim u shkaktua nga dallimi në inflacion ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera, ndërsa efekti i normës nominale efektive të këmbimit (NNEK) ishte më pak i rëndësishëm. Në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, NREK në Kosovë ka shënuar zhvlerësim sidomos në raport me BE-në. Ky trend pritet të vazhdojë edhe në muajt e ardhshëm.

Tabela 6. Bilanci i pagesave, në miliona euro.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
<b>1. LLOGARIA RRJEDHËSE</b>	<b>-300.8</b>	<b>-329.8</b>	<b>-428.4</b>	<b>-743.8</b>
<b>A. Mallrat dhe shërbimet</b>	<b>-1,087.8</b>	<b>-1,163.1</b>	<b>-1,371.2</b>	<b>-1,658.0</b>
1. Mallrat	-1,043.7	-1,141.3	-1,338.2	-1,638.5
2. Shërbimet	-44.2	-21.8	-33.0	-19.5
<b>B. Të ardhurat</b>	<b>146.9</b>	<b>155.1</b>	<b>183.7</b>	<b>143.3</b>
1. Kompenzimi i punëtorëve	141.5	142.8	149.6	160.2
2. Të ardhurat nga investimet	5.4	12.3	34.2	-16.9
<b>C. Transferet rrjedhëse</b>	<b>640.1</b>	<b>678.2</b>	<b>759.0</b>	<b>770.9</b>
1. Qeveria qendrore	366.4	317.7	323.4	288.9
2. Sektorët e tjerë	273.6	360.5	435.6	481.9
<b>2. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE</b>	<b>118.4</b>	<b>37.1</b>	<b>91.8</b>	<b>388.4</b>
<b>A. Llogaria kapitale</b>	<b>2.0</b>	<b>3.2</b>	<b>2.6</b>	<b>-1.6</b>
1. Transferet kapitale	2.0	3.2	2.6	-1.6
<b>B. Llogaria financiare</b>	<b>116.4</b>	<b>33.9</b>	<b>89.2</b>	<b>390.0</b>
1. Investimet direkte	80.0	244.4	413.7	340.4
2. Investimet në letra me vlerë	-17.5	-65.4	-36.6	16.8
3. Investimet e tjera	21.6	-67.3	2.4	27.3
4. Asetet rezervë	32.4	-77.9	-290.3	5.5
<b>GABIMET DHE LËSHIMET NETO</b>	<b>182.4</b>	<b>292.7</b>	<b>336.6</b>	<b>355.4</b>

Llogaria financiare që u dominua nga investimet e huaja direkte (IHD) vazhdoi të ketë bilanc pozitiv duke arritur pjesëmarrjen në PBB prej 9.4 përqind (Tabela 6). Niveli i IHD-ve në Kosovë në vitin 2008 ishte për 14.6 përqind më i ulët krahasuar me 2007. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se gjatë vitit 2007 mbi gjysma e IHD-ve ishin si rezultat i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike si dhe licencimit të operatorit të dytë të telefonisë mobile, ndërsa në vitin 2008 privatizimi ishte ndërprerë në pjesën më të madhe të vitit. Si rezultat i rënies së vlerës së aksioneve në tregjet ndërkombëtare, gjatë vitit 2008 u vërejt tendencë e zhvendosjes nga investimet në letra me vlerë në formën e investimeve tjera, kryesisht depozita. Në anën tjetër, asetet rezervë shënuan rënie si rezultat i rritjes së investimeve publike.

### 3.4.1. Llogaria rrjedhëse

#### 3.4.1.1. Mallrat

Si rezultat i rritjes së vazhdueshme të importeve, bilanci negativ tregtar i Kosovës në vitin 2008 në raport me PBB-në arriti në 43 përqind. Gjatë vitit 2008 importet u rritën për 22.2 përqind (20.1 përqind në vitin 2007) ndërsa eksportet u rritën me 20.2 përqind (49.1 përqind në vitin 2007). Si pasojë e rritjes më të lartë të importeve dhe rritjes më të ulët të eksporteve, mbulesa e importeve me eksporte për vitin 2008 ishte 10.8 përqind.

Tabela 7. Bilanci tregtar i Kosovës, në miliona euro, nëse nuk ceket ndryshe.

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008
Eksportet	56.3	110.8	165.1	198.5
Importet	1100.0	1252.1	1503.3	1837.0
Bilanci tregtar	-1043.7	-1141.3	-1338.2	-1638.5
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-34.0	-35.8	-39.1	-43.0
Mbulesa e importeve me eksporte (%)	5.1	8.8	11.0	10.8


Struktura e eksporteve edhe në vitin 2008 u dominua nga metalet bazë dhe produktet minerale të cilat përbënë 63.3 përqind dhe 9.1 përqind të gjithsej eksporteve, përkatësisht. Edhe përkundër rritjes vjetore prej 67.4 përqind, në dy muajt e fundit të vitit 2008 eksportet e metaleve bazë shënuan rënie si rezultat i rënies së çmimeve të këtyre produkteve në bursat ndërkombëtare. Eksporti i produkteve minerale, si kategoria e dytë më e rëndësishme në eksportet e përgjithshme, shënoi rënie prej 34.4 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Kategoria e tretë për nga rëndësia në eksportet e përgjithshme janë produktet ushqimore, që në vitin 2008 përbënë 5.4 përqind të eksporteve të përgjithshme (5.1 përqind të eksporteve në vitin 2007).

Struktura e importeve vazhdon të jetë e ngjashme me vitet e kaluara, ku peshën më të madhe e kanë produktet minerale që kryesisht përfshijnë karburantet (19.6 përqind të importeve të përgjithshme). Krahasuar me vitin 2007, importi i produkteve minerale në vitin 2008 shënoi rritje vjetore prej 19.2 përqind duke arritur vlerën 378.6 milion euro. Megjithatë, duhet pasur parasysh se norma reale e rritjes së importit të produkteve minerale ishte nëntë përqind, ndërsa ndikimi më i madh në rritjen e normës nominale erdhi si rezultat i inflacionit. Në vitin 2008, importi i produkteve ushqimore arriti vlerën 261.9

milion euro (13.2 përqind të importeve të përgjithshme) që paraqet një rritje prej 17.6 përqind ndërsa norma reale e rritjes ishte 7.6 përqind. Produktet ushqimore, së bashku me produktet minerale, ishin ndër faktorët më me ndikim në nivelin relativisht të lartë të inflacionit. Kategoritë tjera në importet e përgjithshme mbeten metalet bazë me pjesëmarrje prej 9.3 përqind dhe mjetet e transportit me pjesëmarrje prej 6.8 përqind.

Të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2009 tregojnë se eksportet gati u përgjysmuan krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2008. Kjo si rezultat i bllokadës nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina për mallrat kosovare si dhe rënies së kërkesës dhe çmimeve për shkak të recesionit ekonomik që ka kapluar shumë vende. Sa i përket importeve, të dhënat preliminare për tremujorin e parë të vitit 2009 tregojnë se është shënuar një rënie në këtë kategori si rezultat i rënies së çmimeve, pasi që vlera reale e importeve ka pasur një rritje prej 0.6 përqind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2008.

Figura 11. Kategoritë kryesore ekonomike (KKE), në përqindje të importeve të përgjithshme.




Në Figurën 11 është paraqitur struktura e importeve në bazë të klasifikimit të ashtuquajtur KKE, që identifikon qëllimin përfundimtar të përdorimit të mallrave të importuara. Siç mund të vërehet, në vitin 2006 importet që i takojnë kategorive të mallrave të ndërmjetme dhe mallrave për konsum së bashku kishin pjesëmarrje prej 90.2 përqind në importet e përgjithshme, ndërsa me rritjen e vazhdueshme importit të mallrave kapitale, pjesëmarrja e tyre u zvogëlua në 87.6 përqind. Në vitin 2008, pjesëmarrja e importit të mallrave kapitale në gjithsej importe ka arritur 12.4 përqind. Rritja e importit të mallrave

kapitale, të cilat kryesisht përbëhen nga makineritë, pajisjet dhe produkte tjera të ngjashme tregojnë se aktiviteti prodhues në Kosovë po shënon rritje. Kjo tregohet edhe nga rritja e vazhdueshme e kredive të bankave komerciale për sektorin e industrisë.

Partnerët kryesor tregtar të Kosovës në eksporte në vitin 2008 mbeten vendet e BE-së dhe anëtarët e CEFTA-s me pjesëmarrje prej 47.7 përqind dhe 31 përqind të eksporteve të përgjithshme, përkatësisht (Figura 12). Ndryshim vërehet në rritjen e eksporteve në BE për 5.7pp si dhe zvogëlim të tyre në vendet e CEFTA-s për 8pp. Rënia e eksporteve të Kosovës në vendet e CEFTA është rezultat i zhvillimeve politike dhe aplikimi i embargos tregtare nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Këto vende të cilat si Kosova janë anëtare të kësaj marrëveshje, vendosën embargo tregtare për produktet e prodhuara në Kosovë, të cilat kishin destinim ose kalonin tranzit nëpër këto dy vende.

Figura 12. Tregtia me vendet e CEFTA-s dhe BE-së, në përqindje.



Vendet e BE-së dhe CEFTA-s, prej nga Kosova importon 36.2 dhe 37.5 përqind të importeve të përgjithshme, përkatësisht, përfaqësojnë partnerët kryesor tregtarë të Kosovës edhe për sa i përket importeve.

### 3.4.1.2. Shërbimet

Bilanci i shërbimeve në vitin 2008 shënoi përmirësim krahasuar me vitin paraprak, duke zvogëluar deficitin në vitin 2008 në 19.5 milion euro, krahasuar me 33 milion euro në vitin 2007. Rritja vjetore e eksportit të shërbimeve në vitin 2008 ishte 24.4 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rënie prej 14.8 përqind. Importi i shërbimeve të transportit vazhdon trendin e rritjes duke qenë burimi kryesor i deficitit në shërbime, duke sjellë bilanc negativ prej 85 milion euro, që është një rritje me 37.8 përqind krahasuar me vitin 2007. Faktorët kryesor që ndikuan në zvogëlimin e deficitit të llogarisë së shërbimeve janë zvogëlimi i deficitit në shërbime të udhëtimit dhe rritja e vazhdueshme e eksportit të shërbimeve të komunikimit.


### 3.4.1.3. Të ardhurat

Bilanci i të ardhurave vazhdon të jetë pozitiv në vlerë neto prej 143.3 milion euro në vitin 2008. Kjo është rezultat i të hyrave prej 218.3 milion euro si dhe daljeve prej 75 milion euro. Shuma neto e të ardhurave krahasuar me vitin 2007 ka shënuar një rënie prej 22 përqind. Krahasuar me vitin paraprak, kjo rënie ishte si rezultat i rënies së të ardhurave nga jashtë me 4.9 përqind si dhe rritjes së daljeve me 63.3 përqind. Si shkaktar kryesor i rënies së të ardhurave nga jashtë ishte zvogëlimi i të ardhurave nga investimet në 57.3 milion (rënie me 28.4 përqind). Për më tepër, gjatë 2008 u rritën daljet në të ardhura nga investimet me 61.6 përqind dhe arritën shumën prej 74.2 milion euro. Kjo kryesisht rezultatat i rritjes së fitimit nga bankat e huaja që veprojnë në Kosovë. Në rënien e të ardhurave ndikoi edhe zvogëlimi i të hyrave nga investimet në letra me vlerë (për 72.9 përqind), që mund të jetë pasojë e zvogëlimit të investimeve në letra me vlerë në favor të depozitave. Të ardhurat nga investimet tjera shënuan rritje për 14.6 përqind, rritje kjo që i atribuohet investimeve jashtë vendit të realizuara nga ana e BQK-së dhe bankave komerciale. Pjesëmarrjen më të lartë në të ardhurat e kanë pagat për kompensim të punëtorëve e që kryesisht vijnë nga Serbia dhe Afganistani. Të hyrat nga Serbia janë të dedikuara për zonat e banuara nga minoriteti serb. Për vitin 2008 këto të hyra ishin rreth 120 milion euro.

### 3.4.1.4. Transferet rrjedhëse


Vlera neto e transfereve rrjedhëse për vitin 2008 arriti shumën prej 770.9 milion euro, një rritje prej 1.6 përqind krahasuar me vitin 2007. Pjesën më të madhe të transfereve e përbëjnë transferet e sektorëve tjerë (joqeveritar) që përbëjnë 62.6 përqind të gjithsej transfereve, të dominuara nga dërgesat e emigrantëve.

Figura 13. Transferet rrjedhëse, në miliona euro.



Vlera neto e transfereve të sektorëve tjerë në vitin 2008 arriti 481.9 milion euro, që paraqet një rritje prej 10.6 përqind krahasuar me vitin 2007. Kjo vjen si rezultat i rritjes së të hyrave me 6.0 përqind, si dhe rënies së daljeve me 6.0 përqind. Rritja e të hyrave i atribuohet rritjes së dërgesave të emigrantëve kosovar e cila arriti shumën prej 535.8 milion euro (2.7 përqind më e lartë se në vitin 2007). Daljet për vitin 2008 ishin 148.2 milion euro, që janë dërgesa jashtë të punëtorëve të huaj të punësuar në Kosovë (një përqind më e vogël se në vitin 2007).

Figura 14. Hyrjet dhe daljet e dërgesave të emigrantëve, në miliona euro.



Dërgesat e emigrantëve janë njëra ndër burimet kryesore të zbutjes së deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kanë një pjesëmarrje prej rreth 14.1 përqind në PBB. Këto dërgesa janë për 2.7 herë më të larta se eksportet si dhe për 1.7 herë më të larta se IHD-të. Kjo tregon se dërgesat e emigrantëve janë të një rëndësie të veçantë për ekonominë e Kosovës. Megjithatë, në shumicën e vendeve ku diaspora kosovare është vendosur, është raportuar se ekonomitë e tyre janë ndikuar nga kriza ekonomike. Për shembull, në vendet e BE-së parashikohet një rënie reale ekonomike prej 0.6 përqind. Kjo tregon se edhe emigrantët kosovar mund të kenë qenë të prekur nga kriza ekonomike e vendeve të BE-së. Si pasojë, rritja e këtyre dërgesave gjatë vitit 2008 ishte vetëm 2.7 përqind krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 11.7 përqind sa ishte në vitin 2007. Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2009 tregojnë për rënie të dërgesave prej rreth pesë përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

### 3.4.2. Llogaria kapitale dhe financiare

Edhe pse në dy vitet e fundit llogaria kapitale dhe financiare qëndroi në bilanc pozitiv, gjatë vitit 2008 u shënuar një rritje prej 296.5 milion euro dhe arriti vlerën e 388.4 milion euro. Kjo rritje i atribuohet aseteve rezervë të Kosovës, të cilat në vitin paraprak regjistruan rritje prej 290.3 milion euro, ndërsa në vitin 2008 vërehet rënie prej 5.5 milion euro. Llogaria financiare për vitin 2008 shënoi bilanc pozitiv prej 390 milion euro, kryesisht IHD-të që arritën vlerën neto prej 340.4 milion euro. Zhvillimet në tregjet ndërkombëtare sollën një situatë ku investimet në letra me vlerë u zhvendosën në investime tjera, kryesisht në depozita,

duke sjellë bilanc pozitiv prej 16.8 milion euro. Bilanci pozitiv në investimet tjera dhe asetet rezervë gjithashtu ndikuan në bilancin pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare të Kosovës.

#### **3.4.2.1. Investimet e huaja direkte**

IHD-të për vitin 2008 arritën shumën neto prej 340.4 milion euro, që tregon për një rënie prej 17.7 përqind krahasuar me vitin 2007. Kjo rënie i atribuohet ndërprerjes së procesit të privatizimit i cili në vitet e kaluara ishte ndër gjeneratorët kryesor të IHD-ve. Gjithashtu, liçencimi dhe investimet për telefoninë e dytë mobile ndikuan që në vitin 2007 të ketë pasur nivel më të lartë të IHD-ve.

Në vitin 2008 daljet arritën shumën prej 19.2 milion euro, kryesisht investimet e qytetarëve të Kosovës në Shqipëri. Sa i përket IHD-ve në Kosovë, ato janë të dominuara nga investimet kapitale (63.7 përqind), investimet e tjera në formë të kredive nga kompanitë mëmë (21.4 përqind) si dhe investimi i fitimit të pashpërndarë (14.9 përqind). Në baza sektoriale, IHD-të në Kosovë dominohen prej investimeve në sektorin financiar (34.9 përqind), pastaj sektori i transportit dhe telekomunikacionit (13.8 përqind), industria përpunuese (tetë përqind), sektori i energjisë, ujit dhe gazit si dhe investimet në industrinë e minierave (secila nga rreth 5 përqind). Pjesëmarrje relativisht të lartë në IHD-të patën edhe investimet në patundshmëri, të cilat tërhoqën 16.8 përqind të IHD-ve të përgjithshme.


Zhvillimet e politikave ekonomike të cilat hynë në fuqi në vitin 2009 mund të rrisin IHD-të në Kosovë. Ndër këto zhvillime mund të veçohen rifillimi i procesit të privatizimit dhe ulja e tatimit mbi korporata. Gjithashtu anëtarësimi i Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare në vitin 2009, si në FMN dhe Bankë Botërore, mund të jenë një sinjal tjetër pozitiv për investitorët potencial. Faktor tjetër që gjithashtu mund të rrisë nivelin e IHD-ve është edhe përmirësimi i infrastrukturës, e sidomos asaj rrugore.

#### **3.4.2.2. Investimet në letra me vlerë**

Zhvillimet në tregjet ndërkombëtare rezultuan në zhvendosje të një pjese të investimeve të bankave komerciale në kategorinë e investimeve tjera (kryesisht depozita) si dhe tërheqjen e një pjese, duke sjellë bilanc pozitiv prej 16.8 milion euro në vitin 2008 krahasuar me bilancin negativ prej 36.6 milion euro në vitin 2007. Bilanci prej 16.8 milion euro erdhi si rezultat i investimeve në letra me vlerë prej 21.6 milion euro, investime të cilat mund të kenë ndodhur në pjesën e parë të vitit kur kriza ende nuk ishte shfaqur.

Gjatë vitit 2008, bankat komerciale zvogëluan investimet në letra me vlerë për 38.4 milion euro, krahasuar me 20.5 milion në vitin 2007.


Figura 15. Bilanci i investimeve në letra me vlerë, në miliona euro.



### 3.4.2.3. Investimet tjera

Në vitin 2008 bilanci i investimeve tjera, të përbëra nga kreditë tregtare, kreditë bankare dhe depozitat, ishte pozitiv (27.3 milion euro). Asetet e Kosovës jashtë vendit u përbënë kryesisht nga depozitat e bankave komerciale, BQK-së si dhe sektorëve të tjerë. Vlera e aseteve të Kosovës jashtë vendit (të cilat nuk janë asete rezervë) në vitin 2008 arriti në 78.6 milion euro, që krahasuar me vitin 2007 është më e lartë për 32.6 përqind. Një pjesë e investimeve të Kosovës jashtë vendit është në formën e kredive tregtare të cilat arrijnë vlerën e 10.8 milion eurove. Pjesa tjetër është e përbërë nga kreditë e lëshuara jashtë vendit në vlerë prej 3.8 milion euro.

Figura 16. Bilanci i investimeve të tjera, në miliona euro.



Në anën tjetër, detyrimet e Kosovës ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 105.9 milion eurove, apo 71.6 përqind më të larta se në vitin 2007. Investimet e tjera në Kosovë në vitin 2008 kryesisht ishin në formën e huamarrjeve dhe kredive tregtare duke arritur vlerën e 48.5 milion euro dhe 38.9 milion euro, përkatësisht, për vitin 2008. Krahasuar me vitin paraparak, në vitin 2008 kreditë tregtare shënuan një rënie prej 40.6 përqind. Pjesa tjetër e kësaj kategorie përbëhet prej depozitave në bankat komerciale vendore të cilat për vitin 2008 ishin 18.5 milion euro.



#### 4. Mbikëqyrja financiare

BQK-ja ka autoritet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë, si dhe merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, i cili aktualisht mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare (institucionet mikro financiare, institucionet financiare jo bankare, zyret e këmbimit të valutave dhe institucionet për transferin e parave).

Synimi i BQK –se është që të ketë një mbikëqyrje financiare dhe një proces rregullativ që është efikas, fleksibil dhe i cili promovon një sektor financiar konkurrues të bazuar në treg, duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Qasja e mbikëqyrjes së institucioneve financiare është zhvilluar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për mbikëqyrësit, duke filluar nga qasja e “bazuar në rregulla” në drejtim të lëvizjes në qasjen e “bazuar në rrezikun”, e formuluar sipas Prinsipeve Themelore të Basel-it dhe Shtyllës së 2-të, Basel-it II për bankat, dhe një regjim të aftësisë paguese bazuar në rrezikun e cila është duke u adoptuar ndërkombëtarisht për kompanitë e sigurimeve.

Qasja e bazuar në rrezikun ka për qëllim t'i mundësojë BQK–së që në mënyrë të përshtatshme të përdorë burimet e saj mbikëqyrëse në ato fusha me rrezik më të lartë, brenda institucioneve individuale financiare dhe sektorit financiar në përgjithësi. Mbikëqyrja bankare në bazë të rrezikut kryesisht përqendrohet në aftësinë e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun, kurse mbikëqyrja e sigurimit në bazë të rrezikut përqendrohet në kërkesat e aftësisë paguese dhe krijon kornizë të matur e cila pasqyron në mënyrë më të saktë rreziqet e ndërmarr nga sigurvearit. Qëllimi është krijimi i një mbikëqyrje sa më efektive dhe të balancuar mirë të sektorit të sigurimit e cila do të siguroj perspektivën e aftësisë paguese si dhe çeshtjet tjera me rendësi për mbikëqyrjen e sigurimeve të cilat mund të drejtojnë në liberalizimin e tarifave.

Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj të paraparë me kornizën ligjore ( Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës Nr.03/ L-074 , Ligjin Nr.03 /L -084 mbi Pensionet në Kosovë, Rregulloret e UNMIK-ut me Nr. 1999/21 dhe 2001/25), BQK-ja ka vendosur standarde dhe kërkesa mbikëqyrëse të hollësishme në mënyrë që të arrijë një sektor financiar të rregulluar mirë. Gjithashtu, Ligji mbi Bankën Qendrore dhe Rregulloret e lartpërmendura i japin Bordit Drejtues të

BQK-së autoritet për të adoptuar rregulla prudente të mbikëqyrjes, të cilat përcaktojnë limitet, direktivat operuese, procedurat dhe kërkesat raportuese për institucionet financiare, si dhe masat zbatuese në rast mospajtueshmërie me kërkesat ligjore ose për shkak të praktikave të pasigurta dhe pa shëndosha.

Korniza ligjore prudente vazhdimisht rishikohet dhe freskohet, për të siguruar që vazhdon të jetë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo kornizë gjithashtu rishikohet për të siguruar ekuilibrin e duhur në krijimin e një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

#### **4.1. Veprimtaria rregullative e sektorit financiar**

Si rregullator, BQK-ja merr pjesë në zbatimin kornizës ligjore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut. Korniza ligjore për drejtimin e këtyre veprimtarive në përputhje me standardet e BE-së është përshtatur në nivelin aktual të zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë dhe gjithashtu është plotësuar me rregullat dhe vendimet e BQK-se.

Korniza e rregullave të mbikëqyrjes financiare është krijuar në fillim të themelimit të BQK-së, që nga ajo kohë sektori financiar ka ndryshuar, po ashtu ka ndryshuar edhe qasja e BQK-së ndaj mbikëqyrjes. Bazuar në faktorët e lartpërmendur dhe rekomandimeve të asistencës teknike, mbikëqyrja financiare e BQK-se ka punuar në mënyrë aktive për sa i përket rishikimit dhe plotësimit të kornizës së rregullave, dhe të themelimit të politikave dhe procedurave. Veç kësaj, për të udhëzuar industrinë financiare në implementimin e “praktikave më të mira”, BQK-ja ka publikuar “Letra Këshilluese” si referenca mbështetëse dhe plotësuese.

Gjatë vitit 2008 u bënë zhvillime të dukshme në plotësimin e rregullativës ligjore bankare, të sigurimeve, pensioneve dhe asaj financiare jo bankare. Bordi Drejtues i BQK-se gjatë vitit 2008 aprovoj këto plotësime të rregullave për mbikëqyrje adekuate të institucioneve financiare:

**Mbikqyrja bankare:**

- (a) **Rregulla XXVI mbi Shpalosjet e Normave të Interesit, Tarifave dhe Reklamimet** -Rregulla e plotësuar kryesisht përfshin ndryshime të vogla dhe teknike , si dhe është shtuar Paragrafi 8 - **Shpalosjet tjera** për qëllim që të gjitha institucionet financiare duhet të sigurohen që secila degë e tyre e cila merret me klient t'i kenë listat e çmimeve të printuara, të cilat lista përmbajnë informacionin e duhur, të gatshëm për shpërndarje tek klienti kureshtar.
- (b) **Rregulla për auditimin dhe auditorët e jashtëm të institucioneve financiare**- Rregulla e plotësuar kryesisht përfshin ndryshime të vogla dhe teknike dhe atë në kërkesën për auditorët e huaj dhe firmat e huaja audituese të cilat tani kërkohen të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e licencimit që janë të aplikueshme në Kosovë. Është shtuar limiti i kohës për angazhimin e një firme të njëjtë audituese nga ana e një institucioni financiar që është 5 vite.
- (c) **Rregulla e XXX mbi sistemin e kontrollit të brendshëm**-Rregulla është draftuar në pajtim me kornizën për sistemin e kontrollave të brendshme të publikuar nga ana e Komitetit të Bazelit për mbikqyrje bankare. Kjo Rregull themelon parimet bazë mbi organizimin dhe operimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm të të gjitha institucioneve financiare. BQK-ja me këtë rregull kërkon që të gjitha institucionet financiare të themelojnë një sistem të shëndosh të kontrollit të brendshëm me qëllim të parandalimit të humbjeve, mirëmbajtjen e raportimit të besueshëm financiar dhe të menaxhmentit, zgjerimin e operimit të tyre të matur, dhe promovimin e qëndrueshmërisë në sistemin financiar.

Bordi i BQK-se gjatë vitit 2008 po ashtu ka aprovuar edhe politikën mbi Depozitën Ekuivalente të Kapitalit për filialat e bankave të huaja. Një bankë e huaj e cila dëshiron të hapë degë në Kosovë, e jo zyrë të inkuorporuar është e kërkuar që sipas Rregullës bankare Nr. VI mbi Licensimin dhe kufizimin e filialave të bankave të huaja që të depozitojë fillimisht në BQK depozitën ekuivalente të kapitalit në formë të kapitalit aksionar .Shuma e depozitit ekuivalent të kapitalit është e njëjtë sikurse kërkesat e kapitalit minimal që kërkohet për bankat e inkuorporuara. Kjo shumë e depozitit ekuivalent të kapitalit mund që kohë pas kohe të ngritet në pajtim me kërkesat e kapitalit për mjetet e rrezikuara që është efektive për të gjitha bankat që operojnë në Kosovë. Qëllimi i depozitit ekuivalent të kapitalit i siguron BQK-së garancë se fondet ekzistojnë , dhe se në raste të likuiditetit të nevojshëm mjetet janë të sigurta në këtë mënyrë.

Në maj të vitit 2008 ka hyrë në fuqi Rregullorja Nr. 2008/28 e për licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve mikrofinanciare . Po ashtu janë bërë efektive edhe dy rregulla mbi veprimtarinë e institucioneve financiare jo-bankare dhe mikrofinanciare: Rregulla e plotësuar XIV-të mbi licensimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare dhe Rregulla e XVI-të për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtarinë e institucioneve financiare jo-bankare tjera . Me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr. 2008/28 dhe dy rregullave ka filluar edhe procesi i ri licensimit të të gjitha institucioneve mikro financiare , me qëllim të ri kategorizimit të aktiviteteve të tyre

#### **Mbikqyrja e sigurimeve:**

- a) **Rregulla III mbi sigurimin e detyrueshem te autopergjegjesisë.** Ndryshimet në këtë rregull janë bërë si rezultat i liberalizimit të pjesërishëme të tarifave te autopergjegjesise per palen e trete gjegjesisht dispozita mbi standardet dhe strukturën e llogaritjes së primit për sigurimin e detyrueshëm të autopergjegjesisë, dhe se qëllimi i amandamentimit të rregullës ka qënë: që kompanitë e sigurimeve me rastin e aplikimit për aprovimin e primit, në mënyrë të pavarur të përcaktojnë tarifën duke ju përmbajtur standardeve të përcaktuara në rregull.Përmes këtyre ndryshimeve është përcaktuar baza për kalkulimin e primit, si dhe janë përcaktuar kushtet për aprovimi në primit për sigurimin e autopergjegjesise.
- b) **Rregulla X mbi ndryshimin e rregullës mbi themelimin e forumit te arbitrazhit.** Në këtë rregull është bërë plotësimi pothuajse i të gjitha dispozitave me qëllim që rregulla të jete e aplikueshme, të jetë më e qarte dhe te jetë sa më koncize. Me plotësimin e rregullës përcaktohen më për së afërmi: të drejtat e përfituesit të policës me rastin e shprehjes së moskënaqësisë së tij/saj ndaj vendimit të kompanisë së sigurimit dhe janë përcaktuar dispozitat e vendimit të arbitrazhit, ku vendimi i arbitrazhit është i plotëfuqishëm dhe ka fuqinë e titullit përmbarimor.

#### **Mbikqyrja e pensioneve:**

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Rregulloren në mënyrë që të arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjera të rëndësishme gjatë vitit 2008 Kuvendi i

Kosovës miratoi Ligjin Nr.03 /L -084 per ndryshimin e Rregullores se Unmikut 2005/20 mbi Pensionet ne Kosove.

#### 4.2. Licencimi dhe struktura

Në përputhje me legjislacionin qe drejton funksionin e saj statusor, BQK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e institucioneve financiare dhe për te refuzuar ato të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Vizioni i BQK-se për sektorin financiar është të jetë i qëndrueshëm dhe i drejtuar nga forcat e tregut, por që vepron brenda rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikqyrjes të harmonizuar në bazë të direktivave të BE-se/ KE-së.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të duhur dhe të përshtatshëm për aksionarë dhe menaxhment, jane të aftë që të drejtojnë një qasje në zhvillimin e matur te biznesit për te mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar ne këtë mënyre ne forcimin e sistemit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Kështu që për të përmbushur në mënyrë më efektive misionin e BQK-së në aspekt të licensimit dhe rregullimit të institucioneve financiare, si dhe per te siguruar vazhdimësin e avancimit te me trended zhvillimore te mbikqyreseve ne nivel regjional dhe nderkomebtar, ne Maj të vitit 2008 është krijuar Drejtoriati i Korporatës, Legjislativës dhe Metodologjisë. Drejtoriati ka për detyrë kompletimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje financiare në përputhje me Direktivat e Bashkësisë Evropiane dhe praktikat e mira ndërkombëtare ashtu siq janë të prezentuara në “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare” të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (Bank for International Settlements- BIS), si dhe Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikqyrësve të Sigurimeve ( International Association of Insurance Supervisors- IAIS). Në kryerjen e këtij misioni Drejtoriati është përgjegjës për licensimin dhe rregullimin e bankave komerciale, kompanive të sigurimit, ndërmjetësuesve, fondeve pensionale suplementare dhe të gjitha institucioneve tjera financiare jo bankare.

Aktiviteti i licensimit të bankave nga BQK-ja gjatë vitit 2008 kryesisht ka përfshirë hapje të degëve të reja, si dhe hyrja e bankave të reja në treg. Gjatë vitit 2008 Bordi Drejtues i BQK-se ka aprovuar licensën preliminare të FIMA Validus nga Kroacia për të hapur bankë në Kosovë. Rritja e numrit të bankave të huaja është një aspekt i rëndësishëm i ngritjes së konkurrencës në sistemin bankar, dhe me këtë ngritja e efikasitetit dhe cilësisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme. Gjatë vitit 2008, sistemi bankar u zgjerua me një rrjet prej tëte bankave me 287 degë dhe nen-degë.

Edhe në fushën e sigurimeve gjatë vitit 2008 Bordi Drejtues i BQK-se gjatë vitit 2008 ka aprovuar licensën e kompanisë së sigurimeve jo jetë Elsig si dhe kompanisë për sigurimin e jetës Dukagjini Life. Njokohësisht, kompania e sigurimeve Elsig ka hyrë në partneritet me Kompaninë e Sigurimeve Grawe AG Graz nga Austria duke shitur pronësinë në vlerë prej 60 përqind të aksioneve tek e fundit.

**Institucionet Mikro Financiare.** Në fund të vitit 2008 në Kosovë kanë operuar katërmëdhjetë (14) institucione mikro financiare dhe tetë ( 8) institucione jo bankare financiare. Gjatë vitit 2008 Bordi Drejtues i BQK-së aprovoi regjistrimin e katër Institucioneve Financiare Jo Bankare: Crimson Finance Fund dhe Lesna për të kryer aktivitete të kredidhënjes, Raiffeisen Lizing dhe Factor Lizing për të kryer aktivitete të lizingut financiar dhe operativ. Po ashtu, me kërkesën e institucionit në vitin 2008, iu është tërhequr regjistrimi i Balcanactie si institucion mikro financiar.

**Zyret e Këmbimit të Valutave dhe Zyret e Transferit të Parave.** Gjatë vitit 2008 nuk ka pasur ndonjë aktivitet të regjistrimit të zyreve të reja të këmbimit të valutave dhe të transferit të parave. Po ashtu, me kërkesën e pronarëve të institucionit në vitin 2008, iu është tërhequr regjistrimi dy zyreve të këmbimit “ Pikon” në Prizren dhe “ Ari” në Pejë . Në fund të vitit 2008 , kanë operuar në Kosovë 21 zyrë të këmbimit të valutave dhe tri agjensione të transferit të parave.

Tabela 8. Aktiviteti i licensimit të bankave.

Description	2004	2005	2006	2007	2008
Të Licensuara më parë	7	7	6	8 <sup>7</sup>	8
Aprovime Preliminare *	0	0	2	1	1
Revokim I Licencës	0	0	-1	0	0
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>9</b>

Tabela 9. Aktiviteti i licensimit të kompanive të sigurimeve.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Të Licensuara më parë	8	8	8	9	9
Të licensuar	2	1	1	0	2
Refuzuar	-2	-1	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>11</b>

Tabela 10. Aktiviteti i licensimit të fondeve pensionale.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Fondet Pensionale të detyrueshme	1	1	1	1	1
Fondet pensionale Suplementare	6	6	6	1	0
Ofruesit e pensioneve individuale	0	0	1	2	1
<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>2</b>

Tabela 11. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikro financiare dhe jo bankare financiare.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Të Regjistruara më parë	15	18	19	18	19
Regjistruara	3	1	1	1	4
Tërheqja e Regjistrimit	0	0	-2	0	-1
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>22</b>

Tabela 12. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Agjentët	446	658	784	347	479
Brokerët e Sigurimit	0	2	2	3	3
Trajtuesit e dëmeve	1	2	2	2	2
Trajtuesit e pavarur te ankesave	2	3	3	3	4

Tabela 13. Aktiviteti i regjistrimit të agjensioneve të transferit të parave.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Të regjistruara më parë	1	1	2	3	3
Regjistruara	0	1	1	0	0
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

Tabela 14. Aktivitetet e regjistrimit të zyreve të këmbimit të valutave.

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008
Të regjistruara më parë	4	3	6	16	23
Regjistruara	0	4	10	7	0
Tërheqja e Regjistrimit	-1	-1	0	0	-2
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>16</b>	<b>23</b>	<b>21</b>

#### 4.3. Veprimtaria e mbikëqyrjes financiare

Një nga funksionet kryesore të BQK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, të arritshëm si dhe konkurrues, i cili sistem është i besueshëm dhe ofron një sferë të gjerë të shërbimeve financiare. Në kryerjen e këtij misioni, Drejtoratet Korporatës,Legjislativës dhe Metodologjisë, së Mbikëqyrjes së Bankave, Sigurimeve dhe Pensioeneve janë përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe kontrollimin e institucioneve financiare dhe institucioneve jo bankare financiare që operojnë në Kosovë.

Mbikëqyrja Bankare ka për qëllim mbrojtjen e fondeve të depozituesve si dhe ruajtjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm duke u kujdesur për një ambient efikas dhe konkurrues financiar. Promovimi i një sistemi financiar të sigurtë, shëndoshë dhe të qëndrueshëm është një nga arsytet themelore të mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare. Një sistem financiar i qëndrueshëm iu siguron depozituesve një vend të sigurtë për të mbajtur mjetet e tyre. Po ashtu u siguron bizneseve dhe individëve një kornizë të besueshme për kryerjen e transaksioneve monetare. Qëllim tjetër kryesor i mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare është krijimi i një sistemi konkurrues financiar . Një sistem konkurrues financiar iu siguron konsumatorëve produkte dhe shërbime financiare me të çmime më të arsyeshme, produkte dhe shërbime më të mira financiare.

Një synim tjetër shumë me rëndësi i rregullimit është mbrojtja e konsumatorëve. Rregulloret dhe rregullat e përshtatshme kërkojnë që institucionet financiare të shpalosin informatat që ju ndihmojnë konsumatorëve të vlerësojnë opcionet e hapura të produkteve, siç është kostoja e kredisë , të drejtat dhe obligimet e mundshme, si dhe shkallën reale të kthimit në depozitat e tyre.

Rregullat e BQK-së dhe rregulloret ekzistuese drejtojnë shumë aspekte të institucioneve financiare bankare dhe jobankare. Çështje të tilla si: kush zotëron, kontrollon dhe administron institucionet financiare; çfarë vlere kreditimi mund t'i japin institucionet financiare një konsumatori të vetëm ose grupe konsumatorësh; sa kapital duhet të kenë institucionet financiare; ku mund t'i vendosin institucionet financiare zyrat e tyre; dhe çfarë shërbimesh mund të ofrojnë ato, janë të gjitha çështje të rregulluara nga rregullat dhe rregulloret bankare dhe jobankare.

Objektivi kryesor i procesit të mbikëqyrjes është vlerësimi i sigurisë dhe efikasitetit të institucioneve financiare. Ky vlerësim përfshin vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të institucioneve, gjendjen financiare, portofolion e kredisë si dhe pajtueshmërinë me rregullat dhe rregulloret e zbatueshme bankare dhe jobankare.

Procesi i mbikëqyrjes përfshin ekzaminimin në vend dhe ekzaminimin dhe monitorimin përmes analizës së jashtme. Në përgjithësi, stafi i BQK-së kryen ekzaminime në vend të bankave dhe institucioneve financiare jobankare të paktën çdo 12 muaj. Kjo rutinë mbështetet me ekzaminime më të shpeshta të "limituara", mvarësisht nga profili i rrezikut të institucionit financiar nën mbikëqyrje .

**a) Mbikëqyrja nga jashtë – Analizat e raporteve financiare**

Mbikëqyrja nga jashtë ka të bëjë me mbledhjen e informacioneve (raporteve, të dhënave të cilat dorëzohen në BQK nga bankat dhe institucionet financiare jobankare), dhe **vlerësimin** e treguesve të operacioneve të tyre, si dhe krahasimi i tyre me limitet e përcaktuara, të dhënat e mëparshme dhe standardet e pranuar ndërkombëtare. Analiza e jashtme është funksion i vlefshëm i mbikëqyrjes në vlerësimin e gjendjes financiare të institucionit dhe rezultatin e operacioneve.

Funksionet primare të analizave të jashtme janë për të identifikuar ndryshimet dhe kushtet e institucionit, që të reflektoj trendet financiare në secilin institucion dhe në sistemin financiar, të monitorojë progresin e përmirësimit të dobësive dhe mangësive, monitorojë pajtueshmërinë me urdhërat e mbikëqyrjes si dhe masat e detyrueshme/ direktivat e mbikëqyrjes, dhe që të konstatojnë pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret.

Sistemi i shqyrtimit dhe analizave të jashtme është një nga mjetet primare me anë të së cilës BQK-ja e vëzhgon institucionin në sistemin financiar duke gjeneruar inpute në shërbim të informimit të menaxhmentit në BQK dhe për ekzaminimin në vend.

**b) Mbikëqyrja në vend e insitucioneve financiare**

Mbikëqyrja në vend kryen vlerësimin e cilësisë së veprimtarive të bankave dhe institucioneve financiare jo-bankare përmes kontrollit të të dhënave të tyre të brendshme në përputhje me profilin e rrezikut të institucionit.

Ekipi i mbikëqyrjes në vend i BQK-së kryen vlerësime në thellësi të fushëveprimit të politikave formale, procedurave, praktikave, sistemeve dhe modeleve të cilat janë përdorë nga institucionet financiare për të menaxhuar aktivitetin e institucionit në përgjithësi dhe rreziqet ndaj të cilave institucionet financiare ekspozohen. Mbikëqyrja në vend është faza e mbikëqyrjes për gjetjen e fakteve. Faktet analizohen për të përcaktuar gjendjen e institucionit financiar. Duke i përdorur këto fakte, përcaktohet profili i rrezikut të institucionit financiar, i cili përcakton mënyrën se si do të trajtohet institucioni nga mbikëqyrësit gjatë ciklit të ardhshëm mbikëqyrës. Këto të gjetura përmblihen në Raportin e Ekzaminimit. Raporti i Ekzaminimit shërben për t'i komunikuar Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit të lartë të institucionit të ekzaminuar gjendjen aktuale dhe trendet, problemet, ecuritë dhe drejtimin për të ardhmen. Poashtu, raporti i ekzaminimit i siguron Këshillit Drejtues të institucionit një

përmbledhje të çështjeve që kërkojnë masa korigjuese dhe adresimin e tyre. Mbikqyrja në vend dhe analizat e jashtme koordinojnë veprimet e trye që shërbejnë për ngritjen e efikasitetit të mbikqyrjes së institucioneve financiare.

### **c) Qasja e mbikqyrjes financiare – promovimi i mbikqyrjes bazuar në rrezik**

Me rritjen e sektorit financiar, BQK vazhdoj të formalizoj qasjen mbikqyrjes së bazuar “bazuar në rrezik”, me manualin dhe procedurat tjera të nevojshme, me tendencë të shfrytëzimit sa më racional të resurseve ekzistuese në mbikqyrjen sa më efektive të sektorit financiar. Synimi i procesit të mbikqyrjes së përqendruar në rrezik është identifikimi i rreziqeve më të mëdha të një institucioni financiar dhe vlerësimi i aftësisë së menaxhmentit të institucionit për të identifikuar, monitoruar dhe kontrolluar këto rreziqe. Vlerësimi i këtyre rreziqeve bëhet në parametrat e rrezikut të vetëvetëshëm, praktikave të menaxhmentit si dhe tendencave të këtyre rreziqeve për të ardhmen.

#### **4.3.1. Zhvillimet domethënëse të mbikqyrjes bankare gjatë vitit 2008**

Gjatë 2008 Mbikqyrja Bankare ishte aktive në ushtrimin e përgjegjësive të saj përmes mbikqyrjes së përafërt të zhvillimeve në industrinë bankare dhe atë të mikro financave. Struktura ekzistuese e industrisë bankare reflektoj një sistem të nivelizuar në tre ‘peer grupe’<sup>7</sup>

1. Tre bankat sistemike që përfaqësojnë mbi 85 përqind të totalit të aseteve të industrisë bankare , në pronësi kryesisht të huaj, (Procredit Bank, Raiffeisen dhe NLB)
2. Dy bankat në pronësi vendore (Banka për Biznes dhe Banka Ekonomike)
3. Bankat e reja, të inkuorporuar më vonë në tregun bankar Turkish Economic Bank -TEB, Banka Kombëtare Tregtare -BKT dhe Komercijalna Banka – KMB.

Mbikqyrja bankare , gjatë 2008 bazuar në profilet e rrezikut të këtyre tre seteve të bankave, arriti:

- Te kryej ekzaminime të plota dhe të shtoj ekzaminimet e fokusuar në 3 Bankat sistemike

<sup>7</sup> Grupe përafërsisht me parametra financiar të të njëjtit nivel

- Me sukses validoj rezultatet e bashkimit të dy bankave (ish Kasabank dhe Banka e Re e Kosovës) në NLB Prishtina, përmes ekzaminimit të plotë në bankë. Procesi i bashkimit, dhe konsolidimit ishte i suksesshëm vlerësuar nga prizmi i kohës së shkurtër dhe gabimeve minore që kanë shoqëruar këtë proces. Ky ekzaminim ishte i suksesshëm edhe për faktin se u koordinua si i ‘përbashkët’ me kolegët nga Banka e Sllovenis, duke këmbyer përvojat në mbikëqyrje.
- Vazhdojë të mbikëqyr për së afërmi dhe siguroj implementimin e kërkesave dhe rekomandimeve nga ekzaminimet e mëparshme përmes ekzaminimeve të fokusuar.
- Pas licencimit, Komercijalna Banka konsolidoj filialet e veta në nivel të degës në Kosovë duke u integruar në sistemin e raportimit dhe përmbushjes së të gjitha kërkesave rregullatore nga BQK.
- TEB dhe BKT – vazhduan operimet e tyre sipas parametrave të buxhetuar duke shtuar edhe më tutje konkurrencën në shërbim të kualitetit.

Procesi i Likuidimit të Bankës Kreditore në Likuidim BQK vazhdoj të jetë pro-aktive në koordinimin e veprimeve me zyrën e likuidatorit. Gjatë 2008 u paguan 2.3 milion € me prioritet depozitarëve të më të vogël dhe kategorive më nevojë siç përcaktohet me kornizën ligjore në fuqi. Që nga vënja nën likuidim të bankës, gjithsej depozitat e rimbursuara janë 14.4 milion €, përkatësisht 43 përqind e shumës së përgjithshme. Janë likuiduar tërësisht (ri-paguar) 99.6 përqind e numrit të llogarive të depozitarëve .

Rimbursimet mundësohet nga arkëtimet e kredive. Gjendja aktuale e sistemit gjyqësor në masë të konsiderueshme ka afektuar inkasimin sekondar të borxheve nga kredimarrësit përmes ekzekutimit të proceseve gjyqësore në mbledhjen e kolateraleve të kategorive të ndryshme

#### **a) Pajtueshmëria me Principet Themelore të Bazelit për mbikëqyrje bankare - BCP**

Në fillim të 2008 BQK, përkatësisht Mbikëqyrja Bankare, iu nënshtrua vlerësit për kornizën ligjore dhe praktikën e mbikëqyrjes në kontekst të pajtueshmërisë me principet themelore të Komitetit të Bazelit për mbikëqyrje bankare.

Rezultatet e dokumentuara në raportin e vlerësuesve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore ishin të mira dhe inkurajuese për të vazhduar rifreskimin e strukturës ligjore mbi të cilën bazë operon BQK dhe Mbikëqyrja Bankare.

Rrjedhimisht, Mbikëqyrja Bankare nxori rregulla të reja, direktiva dhe dokumente me standardet minimilae/praktikat më të mira për mbikëqyrje bankare. Këto dokumente u jetësuan përmes një procesi interaktive me industrinë financiare, në koordinim me Shoqatën e Bankave, ku çdo dokument i përgatitur ishte subjekt i komenteve dhe vlerësimeve nga industria financiare, para finalizimit.

Sistemi CAMEL i vlerësimit dhe notimit të insitucioneve nën mbikëqyrje mbetet vegël me vlerë e mbikëqyrjes. Ky sistem mbikëqyrës është një akronim për pesë përbërësit e sistemit të vlerësimit: **C**- Mjaftueshmëria e kapitalit, **A**-Cilësia e asetëve, **M**-Manaxhmenti dhe administrimi, **E**- Të Hyrat, dhe **L**- Likuiditeti.

Tabela 15. Mbikëqyrja Bankare: Ekzaminimet në vend të kryera gjatë vitit 2008.

Përshkrimi	Nr. i Ekzaminimeve
Banka – i plotë	5
Banka – i fokusuar	3
Bankat – degët – para hapjet dhe zhvendosjet	69 (48 para-hapje, 21 zhvendosje)
Institucionet mikro-financiare – i plotë	5
Institucionet financiare jo bankare – i plotë	18
Institucionet financiare jo bankare - para hapjet dhe zhvendosjet	4 (2 para-hapje, 2 zhvendosje)

Viti 2008 është manifestuar me turbulencë të mëdha në tregjet financiare globale, prandaj BQK-ja, me koordinimin e përafërt me industrinë bankare dhe palët tjera me interes, vazhdoi të promovoj veprime pro-aktive. BQK ngriti kërkesat rregullatore për sa i takon limiteve ekzistuese të ekspozimeve të bankave në institucionet financiare jashtë vendit si dhe planeve kontingjente operative. Kërkesat ishin të menjëhershme edhe në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese në banka në harmoni me trendet e rritjes së asteteve të tyre.

Mbikëqyrja Bankare gjithashtu ka rritur shpeshësinë e monitorimit të performancës financiare të industrisë bankare, ndonëse sistemi bankar vazhdoi të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid. Trendet e kualitetit të mjeteve reflektuan përmirësime të vazhdueshme duke gjeneruar treguesit më të mirë në rajon

për sa i përket normës së kthimit të kredive. Bankat gjithashtu vazhduan të tregojnë norma të larta profitabiliteti dhe mjeteve të disponueshme likuide.

#### **b) Parametrat financiar të gjeneruar gjatë 2008 për sistemin bankar**

Shfrytëzimi i mirë i burimeve financiare, mundësuar edhe nga kërkesa e madhe për kredi ka sjellë rezultate të mira financiare. Kjo ka ndikuar që sistemi bankar të shënojë performancë shumë të mirë të profitabilitetit. Treguesit kryesorë të profitabilitetit, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (ROA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (ROE), edhe gjatë vitit 2008 kanë vazhduar të shënojnë nivel mjaftë kënaqshëm. Ndonëse me një rënje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rritjes më të shpejtë të aktivitetit mesatar dhe kapitalit mesatar se sa të fitimit neto. Kthimi nga aktivet mesatare (ROA) në dhjetor të vitit 2008 ka shënuar nivelin prej 2.4 përqind, derisa në vitin e kaluar ishte 2.7 përqind, ndërsa ROE nga 25.9 përqind në vitin e kaluar ka shënuar një nivel prej 20.2 përqind në vitin . Trendi stabil i treguesit të kapitalizimit (mjaftueshmërisë së kapitalit) të sektorit bankar ka vazhduar gjatë tërë vitit 2008. Treguesit e likuiditetit dhe kapitalizimit kanë qenë pozitiv dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ. Gjatë periudhës, ka vijuar hyrja e kapitalit të huaj në sistemin bankar, dhe është funksionalizuar marrëveshja për bashkimin e dy bankave në një, duke konsoliduar më tepër konkurrencën në tregun financiar. Kapitalizimi i sektorit bankar në fund të periudhës i përcaktuar sipas treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerësohet 16.49 përqind, kundrejt kërkesës rregullatore prej 12 përqind.

Aktiviteti likuide të sektorit bankar përfaqësojnë 30.16 përqind të totalit të aktivitetit si dhe 36.01 përqind të totalit të depozitave.

Aktiviteti kreditues merr pjesë me 67.17 përqind në totalin e aktivitetit të sistemit bankar, derisa në vitin e kaluar ky tregues ishte 63.47 përqind. Treguesit e kualitetit të mjeteve, përcaktojnë një gjendje më të kënaqshme se në vitin e kaluar për kualitetin e mjeteve në sistemin bankar. Trendi i kredive jo-performuese dhe i kredive me vonesa në bazën bruto ka shënuar rënje të lehtë për 0.8 përqind për kreditë jo-performuese dhe 0.4 përqind për kreditë me vonesa (nga 4.1 përqind në 3.3 përqind për kreditë jo-performuese dhe nga 7.1 përqind në 6.7 përqind për kreditë me vonesa) krahasuar me vitin e kaluar. Përmirësimi i vazhdueshëm i kualitetit të mjeteve ka bërë që sistemi bankarë në Kosovë të gjeneroj treguesit më të mirë në rajon për sa i përket normës së kthimit të kredive.

#### 4.3.2. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes së sigurimeve gjatë vitit 2008

Objektivë primare e BQK-se është mbajta e tregut të sigurt, stabil dhe eficient, mbrojtja e policembajtësve, ofrimi i një mjedisi adekuat për aksionaret dhe zhvillimi i konkurrencës së drejtë.

Në pajtim me legjislacionin qeverisës (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25), në fund të vitit 2006, BQK-ja ka vendosur standardet dhe kërkesat e mbikëqyrjes me qëllim të arritjes së një Industri Sigurimesh të mirë të rregulluar dhe të orientuar kah ofrimi i produkteve dhe shërbimeve kualitative. Procesi i mbikëqyrjes përfshin ekzaminimin në vend (On-Site) dhe monitorimin përmes analizës së jashtme (Off-Site).

Në përgjithësi, stafi i mbikëqyrjes së sigurimeve i BQK-së kryen ekzaminime në vend të kompanive të sigurimit të paktën çdo 12 muaj, sipas programit (Manuelit) të inspektimit On-Site. Kjo rutinë mbështetet edhe me ekzaminimet e fokusuara, më të shpeshta të "limituara", me qëllim të përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.

**BQK-ja ekzaminon veprimtaritë kompanive të sigurimit përmes:** Analizave të jashtme (Off-Site) – mbledh të dhëna (raporte, informacione dhe të dhëna të cilat ofrohen nga Kompanitë e sigurimeve në baza ditore, javore, mujore, quartale dhe vjetore. Këto të dhëna vleresohen dhe shërbejnë për të llogaritur indikatorë (tregues) të ndryshëm financiarë që tregojn mivëvajtjen e aktivitetit të kompanive të sigurimeve si:

- Marxhinen Minimale të Solvencës
- Fuqin financiare – Likuiditeti
- Mjaftushmeria e kapitalit variable (Risku sigurues)
- Raportin e Humbjeve, Raportin e Shpenzime, Dëmeve të Paguara, Margjinës së Profitit, Raportin e kthimit në Asete dhe Ekuitet.
- Kalkulimin e Provizioneve teknike, ekspozimin e Riskut, maksimumin e riskut të mbajtur nga KS, Kualitetin e Risigurimit, kontratat e risigurimit.

Sistemi i shqyrtimit dhe analizave të jashtme është një nga ekanizmat primare me anë të së cilës BQK-ja e vëzhgon institucionin në sistemin financiar në mes të ekzaminimeve të brendshme.

Sikurse të bankat dhe Insitucionet Financiare, edhe të kompanite e Sigurimeve ekzaminimet në vend janë pjese qenësore e procesit të mbikëqyrjes, të lidhura ngushtë me Analizat e jashtme. Për ta kryer

këtë aktivitet, BQK shfrytëzon programin e inspektimit dhe sistemin e notimit (vlerësimit) i cili përmban notat nga 1 deri në 5. Nota 1 identifikohet me risk të lartë, nota 2 me risk me të ulte, nota 3 me risk mesatar, nota 4 është e mirë dhe nota 5 e shkëlqyeshme. Ky lloj inspektimi I ofron BQK-se mundësi për të vlerësuar kualitetin e aseteve, kontrollet e brendshme, provizionet teknike, risigurimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Ekzaminimi në vend është faza e mbikëqyrjes për gjetjen e fakteve. Faktet analizohen për të përcaktuar gjendjen e Kompanisë së Sigurimit. Duke i përdorur këto fakte, përcaktohet profili i rrezikut të Kompanisë së Sigurimit, i cili përcakton mënyrën sesi do të trajtohet institucioni nga mbikëqyrësit gjatë ciklit të ardhshëm mbikëqyrës.

Këto të gjetura përmblihen në Raportin e Ekzaminimit. Raporti i Ekzaminimit shërben për t'i komunikuar BQK-së dhe Këshillit Drejtues të institucionit të ekzaminuar gjendjen aktuale, problemet, ecuritë dhe drejtimin për të ardhmen. Poashtu, raporti i ekzaminimit i siguron Këshillit Drejtues të institucionit një përmbledhje të çështjeve dhe adresimin e tyre që kërkojnë masa korrigjuese. Inspektimet në vend mund të jenë të plota dhe të pjesëshme.

#### a) Performanca financiare e industrisë së sigurimeve

Industria e Sigurimeve në Kosovë, ka vazhduar veprimtarinë me rritje progressive të qëndrueshme financiare gjatë vitit 2008

Tabela 16. Bruto primet e shkruara, në miliona euro, nëse nuk ceket ndryshe.

Përshkrimi	2008	2007	Ndryshimi në %	2008	2007
TPL	35,008,412	35,519,170	-1.44	66.75	73.51
Sigurimet kufitare	9,800,771	7,609,230	28.80	18.69	15.75
Jo -TPL	9,117,255	6,184,518	47.42	17.38	12.80
Kthimet	-1,477,886	-995,258	48.49	-2.82	-2.06
<b>BPSH</b>	<b>52,448,552</b>	<b>48,317,660</b>	<b>8.55</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

Tabela e mësipërme tregon se bruto primi i shkruar ka shënuar rritje për 8,55 përqind në 2008 në krahasime me vitin 2007. Rritjen më të madhe në 2008, krahasuar me 2007, e kanë shënuar sigurimet jo TPL (vullnetare) për 47,42 përqind dhe sigurimet kufitare për 25,80 përqind, ndërsa pjesën tjetër e përbën sigurimi i detyrueshëm të autopërgjigjesisë.

Në 2008 pjesëmarrja e Sigurimeve vullnetare në total Portofolin e sigurimeve merr pjesë me 17.38 përqind, ndërsa në 2007 me 12.80 përqind. Lëvizja e industrisë drejt portfolios së sigurimeve vullnetare është tregues zhvillimor për industrinë e sigurimeve në KosovëPo ashtu kemi rritje në përqindje të të shumës së dëmeve të paguara (9.28 përqind) më e madhe në vitin 2008 krahasuar me virtin 2007 (Nga 13,388,000 euro sa kishte në vitin 2007, në 14,630,000 euro për vitin 2008).

Si rezultat i liberalizimit të kontrolluar të tarifave të autopergjegjesise, me ç'rast kompanite e sigurimit kanë arritur që të jenë më të kujdeshme në menaxhimin e shpenzimeve operative, këto të fundit kanë pësuar një rënie drastike në krahasim me vitin 2007 nga 73.31 përqind sa ishte në vitin 2007, ka rënë në 51.12 përqind në vitin 2008. Në vazhdim janë të prezentuar koeficientet e dëmeve të paguara, të ndodhura dhe të disa koeficienteve tjerë të industrisë.

Tabela 17. Raportet e humbjeve, në përqindje.

Përshkrimi	2008	2007
Raporti i Dëmeve të paguara	27.35%	26.77%
Raporti i Dëmeve të Ndodhura	27.72%	43.71%
Raporti i Shpenzimeve	51.12%	73.31%
Raporti i kombinuar	82.64%	138.97%
Raporti i Humbjeve Bruto	23.20%	39.08%
Raporti i humbjeve Neto	25.80%	43.67%

Raporti i kombinuar paraqet: Dëmet e paguara të ndodhura dhe shpenzimet në raport me Neto primin e fituar.

Raporti i humbjeve Bruto = Dëmet e Paguara + ndryshimi i rezervave për dëme / Bruto primin e shkruar plus ndryshimi i reserves për primin e pafituar.

Raporti i Humbjeve Neto = Dëmet e paguara plus ndryshimi i rezervave për dëme / neto primin e fituar.

Kthimi në pasuri (asete) dhe ekuitete si koeficient mjaftë të rëndësishëm për industrinë e sigurimeve në Kosove për vitin financiar 2008 krahasuar me vitin financiar 2007 janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 18. Kthimi në asete dhe kapital, në përqindje.

Përshkrimi	Standard	2008	2007
Kthimi ne Asete (ROA)	9%	5.54%	2.97%
Kthimi në Pasuri (ROE)	15%	11.44%	3.44%

Tabela 19. Kompanitë e sigurimeve: performimi i ekzaminimeve në vend gjatë periudhës 2007-2008.

Përshkrimi	2007	2008
	Nr. i Ekzaminimeve	
Kompania e Sigurimit - plotë	8	9
Kompania e Sigurimit - fokusuar	18	12
Kompanitë e sigurimeve – zyrat e agjenteve	226	
Brokerat e linjave shtesë	3	
Brokerat e Sigurimeve	0	
CIU & GFK	2	

Njejte si mbikqyrja bankare ashtu edhe ajo e Sigurimeve është dizajnuar si mbokqyrje ne rrezik me qëllim që të sigurojë BQK-në me instrumentet e nevojshme për zhvillimin e industrisë që shpie në rritjen dhe mbajtjen e kërksave të kapitalit në nivelin optimal. Kjo qasje ofron infrastrukturë të nevojshme për liberalizmin e tarifave te sigurimit te detyrueshem ndaj palëve të treta, gjithashtu në të njëjtën kohë krijon fuqinë financiare të Kompanive të Sigurimit. Gjatë vitit 2008 BQK në bashkëpunim me Industrinë e Sigurimeve kanë filluar të implementojne procesin e kontrolluar të liberalizimit te trafivae se autopergjigjesise ndaj paleve te treat. Duke krijuar bazën e liberalizimit të tërësishem të tarifave. Elementi esencial I kësaj qasje ishte kërkesa e BQK-së ndaj kompanive të sigurimit për ta bërë ndarjen e riskut sigurues (Kolaterali variabil).

Qasja "Mbikëqyrja e përqendruar në rrezik mbështetet në:

- Kapitalin minimal të kërkuar
- Kapitali variabil
- Kërkesat për mbajtjen minimale të Solvencës

- Mbjajtjen e riskut dhe menaxhimin e investimeve

Të gjitha këto kërkesa të lartcekura janë të lidhura me kërkesat e kapitali minimal të cilat janë qenësore në arritjen e stabilitetit financiar. Edhe më tepër, Kompanitë e Sigurimit përveç shumës së kapitalit minimal prej 3 milion euro, janë obliguar të ndajnë rezerva për kapitalin variabil i cili rezulton si funksion i kërkesave të riskut sigurues dhe operacional.

#### **b) Liberalizimi i pjesshem i tarifave të sigurimit të autopergjegjesise ndaj palës së tretë.**

Procesi i Liberalizimit të pjesshem të këtyre tarifave nënkupton liberalizimin e kontrolluar ku BQK-ja cakton bazën minimale të nivelit të riskut sigurues bazuar në Riskun Sigurues, Kompanitë e Sigurimit do të krijojnë çmimin e këtyre tarifave duke u bazuar në kalkulime akruaristike. Objektiva primare e procesit të liberalizimit të kontrolluar është që të:

- sigurojë tarifat të produktit në fjalë të cilat do të jenë, të drejta, adekuate dhe jo diskriminuese
- nxisë zhvillimin respektivisht do të rrisë tregun e sigurimeve bazuar në riskun e ekspozuar
- caktojë kontroll në riskun sigurues i cili parashikohet nga polica MTPL

Kalimi nga tarifat e kontrolluara në ato pjesërisht të liberalizuara, ku çmimi caktohet nga tregu do të shpie në një konkurrencë reale.

Përmes kësaj rregulle, BQK-ja krijon infrastruktur adekuate për liberalizimin e tarifave autopergjegjesise ndaj palës së tretë dhe të tregut sigurues në përgjithësi, gjithashtu në të njëjtën kohë rritë kërkesat minimale të solvencës dhe ofron mundësitë për të kaluar më lehtë në Solvencen II, të cilën UE do të fuqizojë nga viti 2012

#### **c) Procesi i Likuidimit të Kompanisë së Sigurimit “Kosova”**

BQK vazhdon të jetë aktive në procesin e përmbylljes – likuidimit të KS “KOSOVA”, duke mbiqkyrur procesin e likuidimit dhe ofruar asistencën e nevojshme Likuidatorit në përmbylljen sa më adekuate të procesit të Likuidimit.

Likuidatorit ka arritur që të sjellë vlerën e dëmeve të paguara në vitin 2008 në 89,687 euro, prej të cilave hyjnë dëmet vendore dhe ato ndërkombëtare që i takojnë kartonit të gjelbërt. Nëse i marrim në total dëmet e paguara nga viti 2004 e deri më 31 dhjetor 2008 janë 2,577,446 euro.

Më 31 Dhjetor 2008 të gjitha llogaritë e KS "Kosova" në Likuidim janë mbyllur, është përgaditur raporti financiar deri më 31 Dhjetor 2008 si dhe është audituar periudha Prill 2004 - Maj 2008. Ka mbetur që të auditohet edhe periudha maj – dhjetor 2008. Në fund të procesit mbetja në vlerë monetare e mbetur do të ju ndahet aksionarëve në bazë të të drejtave të tyre ligjore.

#### **4.3.3. Zhvillimet domethënëse te mbikëqyrjes se pensioneve gjatë vitit 2008**

Gjatë vitit 2008, ka vazhduar procesi i likuidimit të fondeve pensionale suplementare që operonin në kompani publike si që është KEK dhe PTK. Likuidimi i këtyre fondeve është bërë për shkak të obligimeve të pafinancuara ndaj Fondeve. Mjetet pensionale nga fondet në fund të procesit të likuidimit, janë transferuar në TKPK dhe FSKP sipas përcaktimit të secilit pjesëmarrës- pensioner.

Viti 2008 ishte ndër vitet më të rënda në tregjet financiare ndërkombëtare. Kriza financiare që filloi të evoluojë në masë më të madhe që nga fundi i vitit 2007, për një kohë shkurtër u shpërnda në tregjet financiare të pothuaj të të gjitha vendeve të zhvilluara. Përveç sektorit financiar, efektet e krizës u reflektuan edhe në sektorin real të ekonomisë duke shkaktuar rënie të konsiderueshme në çmimin e aksioneve në bursat ndërkombëtare.

Në Kosovë, megjithatë efektet negative të krizës financiare kanë qenë të kufizuara vetëm në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe në mase me të vogël në Fondin Sloveno Kosovar të Pensioneve, aksionet e të cilit në bursat ndërkombëtare kanë shënuar rënie të konsiderueshme në vlerë.

Zhvillimi dhe thellimi i shpejtë i krizës financiare ndërkombëtare gjatë këtij viti, në veçanti gjatë muajve shtator dhe tetor, kur Trusti kishte mbetur pa bord, kushtëzoi që për vitin 2008 neto kthimi në investime të jetë negativ për -29.3 përqind. Vlera e një aksioni të Trustit në dhjetor të vitit 2008 ishte 0.86 euro në krahasim me 1.22 euro në dhjetor të vitit 2007. Si pasojë e kësaj, vlera e kursimeve të përgjithshme pensionale në fund të vitit 2008 ka qenë për 29 përqind më e ulët se sa në fund të vitit 2007. Kjo është humbje e përllogaritur. Nëse për ndonjë arsye Trusti, do të kishte shitur këto gjatë këtyre periudhave ku vlera e aksioneve në tregjet financiare ishte e ulët, atëherë humbja "e përllogaritur" do të bëhej "humbje reale". Humbjet reale të realizuara nga Trusti më datë 31 dhjetor 2008, janë në shumë prej 240 mijë euro, humbje e cila ndikon në pagesat e realizuara të pensioneve gjerë më tani nga ana e Trustit. Megjithatë, zhvillimet në investimet e Trustit janë në linjë me zhvillimet botërore, ku kriza financiare ka prekur çmimet e aksioneve në të gjitha bursat dhe investimet pa dallim. Për më tepër, investimet e Trustit janë bërë në pajtim me ligjet dhe politikën investive në fuqi.

Në tabelën vijuese pasqyrohet aktiviteti investues i mjeteve të Trustit, klasat e investimeve dhe shtrirjet gjeografike per vitin 2007 dhe 2008.

Tabela 20. Investimet e Trustit, në miliona euro.

Menaxhuesi i Mjeteve	Klasa e Investimit	Selia	Plasmanet	Dec-07	Dec-08
Vanguard	Aksione	Belgjikë	Globale	158.4	112.3
Schroders	Bono Thesari/Korporatash	Luksemburg	Globale	49.9	49.2
European Credit Management-ECL	Tregu i Kredive (Letra me Vlerë)	Britani e Madhe	Europë	23.7	14.2
European Credit Management-DEC	Tregu i Kredive (Letra me Vlerë)	Britani e Madhe	Europë	23.6	12.3
Raiffeisen Bank Kosova	Depozit Bankar	Kosovë	Kosovë	-	10.4
FX Concepts	Tregu i Valutave	ShBA	Globale	6.5	7.4
ProCredit Bank Kosova	Depozit Bankar	Kosovë	Kosovë	-	5.2
Fortis (ish Abn-Amro)	Tregu i Keshit	Belgjikë	Globale	3.9	4.1
Auriel Capital Management	Tregu i Valutave	Britani e Madhe	Globale	6.5	4.4
<b>Të investuara</b>				<b>272.5</b>	<b>219.4</b>
Të pa investuara (në BQK)				7.1	36.3
<b>Totali i mjeteve nën menaxhim</b>				<b>279.6</b>	<b>255.7</b>

Në tabelën e mësipërme mund të shihet aktiviteti investues i mjeteve me të cilat ka menaxhuar Trusti. Të paraqitura janë vlerat në fund të vitit 2007, ato në fund të vitit 2008. Si rrjedhojë e krizës globale financiare të vitit 2008, shihet se rëniet më të mëdha janë pësuar nga investimet në tregun e aksioneve, si dhe në tregun e kredive në letra me vlerë. Në mënyrë të njëjtë nga tabela mund të shihet performanca individuale e menaxhuesve tjerë në tregjet tjera, përmes të cilëve investon Trusti.

Në rolin e mbikëqyrësit të institucioneve financiare në Kosovë, me këtë edhe të Trustit, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, ka ndërmarrë një varg masash për të minimizuar rënien e mëtutjeshme të vlerës së investimeve të Trustit.

Duke përcjellë zhvillimet e krizës financiare si dhe ndikimin e saj në investimet e Trustit, BQK-ja që nga mesi i vitit 2008, intensifikoi kontaktet dhe monitorimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Hapi i parë preventiv, që ka marr BQK-ja në këtë drejtim, ishte diskutimi me Bordin dhe Menaxhmentin e Trustit para se t'i skadojë mandati i bordit, më ç' rast atyre ju kemi rekomanduar që të

mos vazhdojnë të investojnë kontributet e reja të grumbulluara në tregjet financiare ndërkombëtare por mjetet t'i mbajnë në Kosovë brenda parametrave të përcaktuara me rregullativën dhe politikat ekzistuese që limitojnë mundësinë e investimit të mjeteve substanciale në Kosovë si rezultat i mungesës së tregu të letrave me vlerë, mungesës së gradimit/rejtingut, etj. Si rezultat mjetet e akumuluar nga shtatori deri më tani në shumë prej 59 milionë euro dhe janë të depozituara në llogarinë e Trustit në BQK. Me zgjedhjen para pak kohe të bordit të ri drejtues të Trustit, do të caktohet edhe destinimi i ri i këtyre mjeteve që mund të jenë edhe depozitat në bankat komerciale në Kosovë.

Duke parë se kriza financiare vazhdonte të thellohej dhe se ndikimi në mjetet e Trustit ishte i madh, BQK-ja në pajtueshmëri me kornizën ligjore ka lëshuar një urdhëresë me shkrim, përmes së cilës është kërkuar që:

1. Menaxhmenti i TKPK-së të raporton në BQK në baza javore për performancat e mjeteve të investuara, në mënyrë që për së afërmi të njohet me trendët e lëvizjes së mjeteve, si dhe Mbajtësit e mjeteve dhe Aset Menaxherët e mjeteve të Trustit të raportojnë drejtpërdrejt edhe në BQK- gjë të cilën janë duke e bërë në baza të rregullta. **BQK-ja ekzaminon veprimtaritë e Trustit dhe fondeve pensionale përmes:** Analizave të jashtme (Off-Site) – mbledh të dhëna (raporte, informacione dhe të dhëna të cilat ofrohen në baza ditore, javore, mujore, quartale dhe vjetore. Këto të dhëna vleresohen dhe shërbejnë për të llogaritur indikatorë (tregues) të ndryshëm financiarë që tregojn mirevajtjen e aktivitetit të Trustit dhe fondeve tjera pensionale. Gjithastu, ekzaminimi në vend i (përgjithshëm dhe I fokusuar) cili është kryer se paku një herë në vit për Trustin dhe FSKP-ne ka ndikuar në përcjelljen për së afërmi të gjendjes financiare të këtyre insitucioneve.

Tabela 21. Fondet Pensionale: performimi i ekzaminimeve në vend.

Përshkrimi	2008
	Nr. i ekzaminimeve
TKPK	1
Fondet Pensionale Suplementare në Liquidim- udhëheqja e procesit të likuidimit, KEK, PTK	aktivë
FSKP- fokusuar, përgjithshëm,	1+1

#### 4.4. Veprimet ndëshkuese ndaj institucioneve financiare

Shtrirja dhe frekuenca e aktiviteteve të mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme rritet në raste kur keqësohet profili i rrezikut të një institucioni. Sa më i pafavorshëm të jetë profili i rrezikut, aq më e madhe do të jetë shkalla e ndërhyrjes së mbikëqyrjes, dhe më të mëdha do të jenë gjasat e ndërmarrjes së masave korigjuese dhe gjobave si mjete të përforcimit të pajtueshmërisë apo sigurimit të kthimit në gjendje të sigurtë dhe të shëndoshë.

Pavarësisht nga përpjekjet e mbikqyrësve, gjatë vitit 2008 janë krijuar situata kur institucionet financiare kanë dështuar për të arritur kërkesat prudente të mbikëqyrjes ose janë përdorur praktika të pa sigurta dhe jo të shëndosha bankare dhe siguruese. Mbikëqyrja e posaçme, masat përmirësuese dhe gjobat janë imponuar në atë mënyrë që të jenë transparente dhe të paanshme, gjë që ka reflektuar mbikëqyrjen shqetësuese të BQK-së, duke pasur në konsiderim bashkëpunimin dhe perceptimin e kompetencës së menaxhmentit të institucionit.

Si rezultat i shkeljeve të rregulloreve ose praktikave bankare të pa sigurta ose jo të shëndosha, BQK-ja ka inicuar 2 veprime detyrues ndaj bankave gjatë vitit 2008, ndërsa mbikëqyrja e sigurimeve ka inicuar 16 veprime detyrues kundër kompanive të sigurimit.

Veprimet detyruese në vitin 2008 të ndërmarra bazuar nga Rregullorja Nr. 1999/21 dhe 2001/25, shtrihen duke filluar nga vërejtjet me shkrim, urdhëresat administrative dhe ishin të bazuara në masën e shkeljes, ekspozimit të rrezikut, shkeljeve të përsëritura, etj. Tipet e veprimeve detyruese të ndërmarra nga BQK-ja duke përfshirë komunikimet me gojë dhe me shkrim, kufizimi i aktiveve të caktuara, marrëveshjet formale në mes të BQK-së dhe institucioneve financiare, dhe kërkesat për ngritjen e kapitalit aksionar, ngritjen e rezervave teknike, pagesën e dëmeve dhe dënimet monetare. Veprimet detyruese ndaj institucioneve financiare kanë rezultuar në pozita më të mira financiare të institucioneve financiare dhe kanë zvogluar rrezikun.

#### 4.5. Procesi i themelimit të Agjencionit për Sigurimin e Depozitave

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bashkëpunim me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Shkollën e Frankfurtit (SHF), ka vazhduar përpjekjet gjatë vitit 2008 për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë.

Kontaktet dhe koordinimi i vazhdueshëm me KfW ka qenë esencial në sigurimin e përkrahjes së Qeverisë Gjermane me grantin prej 5 milion EUR.

Gjithashtu aktivitetet janë koordinuar edhe me palët tjera me interes si : Shoqata e Bankave të Kosovës dhe bankat komerciale, Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare dhe institucionet mikrofinanciare, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, USAID, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komisioni Europian, Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës, dhe Oda e Avokatëve të Kosovës.

Ligji për sigurimin e depozitave si dhe modeli financiar, dhe struktura e depozitave janë përgatitur nga ekipi i ekspertëve duke analizuar të dhënat e pranuar nga bankat komerciale në Kosovë. Sipas parakushteve pasi është kërkuar, ligji i përgatitur ka qenë në formë të Rregullores së UNMIK-ut fillimisht, pasi kjo fushë bënte pjesë në kompetencën e rezervuar për UNMIK.

Bordi i BQK-ës pas analizave të dokumenteve, ka përkrahur themelimin e sistemit të sigurimit të depozitave, si rrjedhojë e arritjes së një prej pikave strategjike të saj në krijimin e mekanizmave për forcimin e sektorit financiar.

Pasi parakusht për të vazhduar me sistemin e sigurimit të depozitave ishte edhe vlerësimi Bazeli i mbikqyrjes bankare të BQK-ës, në fillim të vitit 2008 është angazhuar ekipi i ekspertëve me ndihmën nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore për të hartuar raportin e vlerësimit sipas Bazeli.

Raporti Bazeli i cili është finalizuar në fillim të majit 2008 rezultoj të ishte pozitiv në të gjitha kriteret e ndërlidhura me sigurimin e depozitave, dhe në këtë mënyrë është siguruar që mund të vazhdohet me themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave.

Në ndërkohë kanë pasuar ndryshime qenësore në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë me 17 shkurt 2008. Institucionet kanë pranuar kompetencat nga UNMIK, dhe si rrjedhojë ligji për sigurimin e depozitave duhej të ndryshohej dhe të përkonte me procedurat për hartimin e ligjeve sipas kërkesave të Qeverisë së Kosovës.

BQK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) ka përmbushur kërkesat ligjore për sponsorimin e ligjit nga MEF. Ligji për sigurim të depozitave ka pas parasysh ligjet në region si nga Shqipëria, Mali i Zi, Bosnje e Hercegovina, Sllovenia dhe vendet europiane dhe amerikane. Praktika më e mirë ndërkombëtare është ndjekur gjatë propozimeve të përfshira në ligjin për sigurim të depozitave si dhe Direktiva Europiane për garantimin e depozitave.

Projekti për Sigurimin e depozitave për institucionet financiare është shqyrtuar nga MEF dhe ligji është paraparë në planin legjislativ për miratim në fillim të vitit 2009.

#### 4.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e mbikëqyrjes financiare

Bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare dhe të sigurimeve, i është kushtuar një vëmendje më e posaqme gjatë vitit 2008 .

Bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Shqipërisë, të Sllovenisë, të Kroacisë dhe Autoritetin Rregullativ të Mbikëqyrjes në Turqi dhe Austri është zgjeruar edhe më tepër gjatë vitit 2008, me rastin e vizitave të bëra nga stafi i BQK-së në këto vende dhe anasjelltas. Këto vizita të dyanshme ndikuan shumë në forcimin e bashkëpunimit në sistemin bankar, në aspektin e investimeve të huaja që rrjedhën gjatë vitit. Si rezultat i këtij bashkëpunimi në Maj të vitit 2008 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Autoritetin Rregullativ të Mbikëqyrjes së Turqisë, dhe kjo ka kontribuar edhe me shumë në zgjerimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave mbikëqyrëse në mes dy vendeve. Gjithashtu, janë shkëmbyer shumë informata mbikëqyrëse me Bankën Qendrore të Kroacisë me rastin e procesit të shqyrtimit të aplikacionit të Fima Validus nga Kroacia për të hapur bankë në Kosovë.

Gjithashtu, bashkëpunimi me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Shqipërisë, të Sllovenisë, Kroacisë dhe Austrisë është zgjeruar më tepër në aspektin e shkëmbimit të informatave rregulluese dhe mbikëqyrëse. Sidomos, janë shkëmbyer informata me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Austrisë me rastin e hyrjes së partnerit strategjik GRAWE AG nga Austria në Kosovë, posaqërisht në blerjen e aksioneve të Kompanisë së posa licensuar të Sigurimeve "Elsig".

Nga viti 2005 BQK është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrjes së Siguruesve (IAIS) dhe asaj të pensioneve (IOPS). Anëtarësimi i BQK-së në këto Shoqata profesionale është relevant dhe mjaft i dobishëm. Gjatë vitit 2008 personeli i BQK-se ka përfituar nga pjesmarrja në komitete dhe nënkomitete të këtyre shoqatave oer qeshtjet aktuale të trendeve të idnsutrise së sigurimeve, si dhe trajnimet e ndryshme në fushën e sigurimeve.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe bashkëpunimi dhe asistencë teknike nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe këshilluese si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, etj në ngritjen e kapacitetit të mbikëqyrjes dhe në plotësimin e rregullativës ligjore ka vazhduar në mënyrë të frytshme, dinamike dhe shumë efektive gjatë vitit 2008.

## 5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) u siguron institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjërë shërbimet e rëndomta që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të kreditimit ose ofrimit të likuiditetit të përkohshëm meqë BQK-ja nuk është bankë emetuese. Valuta që përdoret në Republikën e Kosovës është euroja.

### 5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK-ja është kompetente për sigurimin e një furnizimi të duhur të ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme. Meqë euroja është valuta që përdoret në Kosovë, përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë në radhë të parë me euron.

Figura 17. Furnizimi me kartëmonedha euro, numri i copëve.




Figura 18. Furnizimi me monedha euro, numri i copëve.





Figura 19. Furnizimi me para të gatshme, lëvizja mujore, në miliona euro.



Siç është paraqitur në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2008, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me mbi 4,5 milionë kartëmonedha euro në shumë prej afro 140 milionë euro dhe mbi 1,5 milionë monedha euro në shumë prej afro 0,6 milion euro. Sa i përket vlerës së përgjithshme, paratë e gatshme të furnizuara gjatë vitit 2008 patën një zvogëlim prej 13 për qind krahasuar me 2007, ndërkaq struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve ndryshoi dukshëm nga viti në vit. Përderisa furnizimi i kartëmonedhave 5 dhe 10 euro u rrit, furnizimi i kartëmonedhave me

denominime më të larta u zvogëlua. Mandej, gjersa furnizimi i monedhave 1 dhe 0.05 euro u zvogëlua, furnizimi i monedhave të denominimeve të tjera (2, 1, 0.2, 0.1, 0.02 dhe 0.01 euro) u rrit. Furnizimi me monedhat 1 dhe 2 eurocent shënoi rritje meqë BQK përkrahu përdorimin e tyre dhe vuri në dispozicion të akterëve ekonomikë sikurse viteve të kaluara sasi të shtuara të tyre. Rritja e furnizimit të monedhave 1 dhe 2 eurocent reflekton rritjen e nevojës për to të shkaktuar kryesisht nga strukturimi konkurrues i çmimeve të shitjes me pakicë.

Figura 20. Kartëmonedha euro të pranuar, numri i copëve.






Figura 21. Monedha euro të pranuar, numri i copëve.




Në vitin 2008, BQK-ja pranoi afër 10 milionë copë kartëmonedha euro dhe afër 2,6 milionë copë monedha euro si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 520,4 milionë euro dhe 1,9 milionë euro, përkatësisht. Ngjashëm me furnizimin me para të gatshme, vlera totale e parave të gatshme të depozituara u zvogëlua, duke shënuar një rënie modeste prej 1,92 për qind krahasuar me vitin paraprak.

Figura 22. Pranimi i parave të gatshme, lëvizja mujore, në miliona euro.




Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2008, paratë e gatshme të depozituara ishin në një vlerë dukshëm më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 383 milionë euro, ky ndryshim ishte në një masë të konsiderueshme më i lartë se sa në dy vitet e mëhershme, kur kishte vlerat rreth 371,7 milionë euro dhe rreth 294,7 milionë euro, përkatësisht. Meqë BQK-ja mban në trezorë vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme duke dërguar tepërcat në bankat e eurozonës, ku kthehen në mjete interes-prurëse, rritja vjetore e parave të gatshme të depozituara kundrejt parave të gatshme të furnizuara ka rezultuar gjithashtu në rritjen neto të dërgesave jashtë vendit të parave të gatshme. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2008 në shumën prej 409,1 milionë eurove gjithsej, kanë qenë mjaft më të larta se sa në vitet 2007 dhe 2006, kur ishin 318,9 milionë euro dhe 308,0 milionë euro, respektivisht.

Figura 23. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi, numri i copëve.



Gjatë vitit 2008, operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. BQK-ja avancoi më tej pajisjet e procesimit të parave të gatshme, dhe operacionet e Njesisë së operacioneve me para të gatshme dhe të trezorit përfituan në efikasitet edhe nga utilizimi i plotë i hapësirave të reja të procesimit të parave të gatshme dhe të transaksioneve me para të gatshme, të cilat u futën në përdorim një vit më herët.

Figura 24. Përpjestimi i kartëmonedhave të vjetërsuara nga gjithsej të pranuar, numri i copëve.



Gjatë vitit, rreth 3,1 milionë kartëmonedha euro (31,1 për qind e numrit të kartëmonedhave euro të depozituara) u klasifikuan si të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar drejt bankave emetuese. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës.

Paratë e gatshme në qarkullim shënuan përmirësim cilësie edhe duke iu falënderuar furnizimit të kartëmonedhave të reja euro, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2008, BQK-ja furnizoi akterët ekonomikë me rreth 2,2 milionë copë kartëmonedha euro të papërdorura (34,4 për qind e të gjitha kartëmonedhave euro të furnizuara). Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve të ulëta, me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Për më tepër, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të cilësisë standarde më të lartë.

Figura 25. Përpjestimi i kartëmonedhave të reja (të papërdorura) të futura në qarkullimi nga gjithsej të furnizuara, në përqindje.





Figura 26. Furnizimi me kartëmonedha të reja (të papërdorura), numri i copëve.



Për sa i përket luftës kundër falsifikimit të parave të gatshme, BQK-ja vazhdoi të përcjellë rastet e valutave të falsifikuara të raportuara nga bankat komerciale. Po ashtu u vazhdua bashkëpunimi me autoritetet për raportimin e falseve dhe trajnimin mbi identifikimin e falseve. Vlen të përmendet një trajnim i specializuar dy-ditor në këtë lëmë, i cili u organizua me Policinë e Kosovës dhe në të cilin morën pjesë përfaqësues të të gjitha bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare që kryejnë operacione me para të gatshme.

## 5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

Kompetenca e ofruesit të shërbimeve bankare për Thesarin dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), ndërmarrjet publike, institucionet financiare dhe organizatat ndërkombëtare i është dhënë BQK-së me ligj. Në vitin 2008, në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme, këto shërbime konsistojnë kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe operacionet e pagesave, duke përjashtuar çfarëdo forme të kreditimit.

Tabela 22. Të dhënat përmblledhëse mbi transaksionet bankare, numri dhe shuma.

Përshkrimi	Numri i transaksioneve		Shuma e transaksioneve	
	2007	2008	2007	2008
<b>1. Transaksionet me para të gatshme</b>				
Depozita në para të gatshme	2,475	951	533,177,716	524,346,149
Tërheqja në para të gatshme	2,199	374	-161,432,875	-139,233,327
Ndryshimi i gjendjes si rezultat i transaksioneve me para	4,674	1,325	371,744,841	385,112,822
<b>2. Pagesat vendore</b>				
Pagesat vendore ardhëse	89,805	87,997	1,055,471,937	1,076,145,138
Pagesat vendore dalëse	130,439	135,541	-697,289,660	-998,066,861
Ndryshimi i gjendjes si rezultat i pagesave vendore	220,244	223,538	358,182,277	78,078,278
<b>3. Pagesat ndërkombëtare</b>				
Pagesat ardhëse ndërkombëtare	356	409	335,613,000	203,113,260
Pagesat dalëse ndërkombëtare	726	1,326	-322,488,656	-567,908,323
Ndryshimi i gjendjes si rezultat i pagesave ndërkombëtare	1,082	1,735	13,124,344	-364,795,063

Siç u theksua edhe më herët, pothuajse të gjitha transaksionet me para të gatshme janë kryer në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, ndërsa numri më i madh i transaksioneve të pagesave janë kryer në emër të dhe për llogari të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Thesari dominon te pagesat vendore ardhëse dhe dalëse si për nga vëllimi ashtu edhe për nga vlera e tyre. Po ashtu është urdhërdhënësi kyç edhe sa i përket vëllimit të pagesave dalëse ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket vlerës së pagesave ndërkombëtare, bankat komerciale prijnë. Natyrisht, bankat komerciale i gjenerojnë vetë transaksionet e pagesave vendore.

Institucionet e sigurimit, të cilat po ashtu kërkohen të kenë llogari të hapura në BQK, nuk shfrytëzojnë në masë shërbimet bankare të BQK-së dhe pothuajse të gjitha pagesat e tyre i kryejnë përmes bankave komerciale. Në të vërtetë, edhe të gjithë llogarimbajtësit e tjerë i shfrytëzojnë operacionet në llogari të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

Figura 27. Vëllimi vjetor i pagesave vendore të gjeneruara dhe atyre të pranuar përmes BQK-së.





Figura 28. Vlera vjetore e pagesave vendore të gjeneruara dhe atyre të pranuar përmes BQK-së, në euro.



Si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), BQK-ja merr pjesë në kanalizimin e urdhërpagesave vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve. Gjatë vitit 2008, BQK-ja ka dërguar përmes SEKN-së në emër të klientëve të vet mbi 135,5 mijë urdhërpagesa dalëse (një rritje prej 3,91 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të klientëve të vet afër 88 mijë urdhërpagesa ardhëse (një zvogëlim prej 2,01 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Shprehur në vlerë, shuma e urdhërpagesave dalëse në vitin 2008 ishte pothuajse 1 miliard euro (një rritje prej 43.14 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe vlera e urdhërpagesave ardhëse ishte mbi 1 miliard euro (një rritje prej 1,96 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Depozitat e Thesarit dhe institucioneve të tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me depozitat e AKP-së përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave të gjithmbarshme të mbajtura në llogaritë në librat e BQK-së. Më 31 dhjetor 2008, depozitat e Thesarit dhe institucioneve të tjera qeveritare arritën shumën prej 470 milionë euro. Gjatë vitit, depozitat e AKP-së u rritën si rezultat i privatizimeve të reja, duke arritur shumën prej 405.9 milionë euro në fund të vitit. Zhvillimi i depozitave të Thesarit dhe të institucioneve të tjera qeveritare si dhe të AKP-së të mbajtura në llogaritë e BQK-së janë të paraqitura në vijim.

Figura 29. Ecuria e depozitave të llogarimbajtësve kryesorë të BQK-së, në miliarda euro.






Figura 30. Ecuria e depozitave të Thesarit, insitucioneve të tjera qeveritare dhe të AKP-së gjatë vitit 2008, në miliona euro.



Gjatë vitit 2008, BQK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe rakordimeve të Thesarit dhe të entiteteve të tjera qeveritare. Në veçanti, u punua në automatizim të mëtejme si në raport me sistemin bazë bankar të BQK-së ashtu edhe në raport me SEKN-në.

Figura 31. Ecuria e depozitave të bankave komerciale dhe kompanive të sigurimeve, në miliona euro.



Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave që mbahen në llogari në BQK. Të dy këto lloje të institucioneve financiare mbajnë rezerva të detyrueshme në BQK dhe përgjithsisht niveli i depozitave të tyre në BQK është i barabartë me nivelin e rezervave të kërkuara.

Depozitat e bankave dhe kompanive të sigurimit përbënë 15 për qind të depozitave të gjithseja që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2008. Më 31 dhjetor 2008, ato ishin në shumën prej 159,6 milionë euro. Gjatë vitit, depozitat e bankave komerciale në BQK u ngritën kryesisht si rezultat i rritjes së bazës depozituese të shumicës së bankave komerciale. Rritja e bazës depozituese (depozitave të qytetarëve dhe bizneseve) të bankave komerciale çoi në ngritjen e nivelit të rezervave të detyrueshme që duhet të mbahen në BQK. Depozitat e institucioneve të sigurimit mbeten relativisht të pandryshueshme gjatë tërë vitit. Në të vërtetë, ato kanë qenë në një nivel të këtillë tash sa vite me radhë.

### 5.3. Menaxhimi i mjeteve

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) duke bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës Nr.03/L-074, Neni 6, është e autorizuar të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe të ofrojë këshilla financiare me kërkesë të kësaj Ministrie.

Ndërsa sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Neni 7, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është autorizuar të investojë Mjetet e Qeverisë.

Kjo formë e investimeve financiare mundëson kthimin në investime, krijimin e mjeteve të paguara nga interesi mjete të cilat pastaj derdhen në Buxhetin e Kosoliduar të Kosovës.

Në praktikë, fondet e depozituara ju takojnë kryesisht Institucioneve Qeveritare, ku Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (rezervat buxhetore) është ndër depozitorët kryesor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)-së (të ardhurat nga procesi i privatizimit) dhe institucioneve financiare (rezervat likuide mandatorë).

Poashtu Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është e ngarkuar me menaxhimin e fondeve të depozituara nga, agjencitë publike, institucionet financiare, dhe organizatat donatore.

Deri më datën 31 dhjetor 2008, totali i mjeteve të menaxhuara ishte mbi 1 miliard euro, nga këto depozitimi nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe entitet relevante ishte rreth 470 milion euro

(44 përqind të shumës së përgjithshme), Agjensia Kosovare e Privatizimit (AKP) 403 milion euro (38 përqind) dhe institucionet financiare 197 milion euro (18 përqind).

Politika e Investimeve e aprovuar nga bordi drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) ndiqet nga Menaxhmenti, dhe nën kontrollin e tij, implementohet nga ana e Departamentit të Menaxhimit të Mjeteve. Për arsye se një pjesë e madhe e fondeve që menaxhohen janë mjete të fondeve publike, ose mund të kthehen për një afat të shkurtër kohor, ku përqendrim i veçantë i është dhënë *sigurisë, likuiditetit dhe kthimit në investime*.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) i investon mjetet në instrumentet e tregut të parasë. Gjatë vitit 2008, procesi i investimeve të mjeteve ka hasur në ndryshimin e strategjisë së investimit për shkak të krizës financiare globale. Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve gjatë kësaj periudhe është koncentruar në investimin e mjeteve me afat më të shkurtër kohor, prej investimit të mjeteve me afat maturimi deri në një vit sipas Politikës së Investimeve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në investimin e tyre me afate më të shkurtra kohore në depozita bankare një javore, dy javore si dhe në letra me vlerë me afat maturimi jo më shumë se tre muaj. Vëmendje e posaçme gjatë kësaj periudhe i është kushtuar shpërndarjes së rrezikut, ku koncentrimi më i madh i mjeteve të investuara është kryer me Bankat Qendrore të Shteteve të Bashkimit Evropian me të cilat bashkëpunon Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).

Të gjitha proceset investuese janë kryer me bankat të cilat kanë një klasifikim të lartë (Aaa dhe Aa ose ekuivalente). Investimi i mjeteve të paraqitura në valutën euro, ose në depozitimin bankar (49 përqind në fund të vitit 2008), ose në letra me vlerë qeveritare (51 përqind në fund të vitit 2008), me maturitet jo më shumë se tre muaj dhe me një shkallë të lartë investimi (Aaa dhe Aa ose ekuivalente) dhe në së fundi në llogaritë aktuale. Përcaktimet i kufijve të investimeve për secilën bankë korrespondente dhe për vendet ku investohet janë të kufizuara rreptësisht.

Përputhshmëria me rregullat e investimeve të brendshme është punuar në baza ditore, deri sa të gjitha aktivitetet janë të ndara nga "back office-i" dhe të raportuara tek Guvernatori. Analizat e rreziqeve si dhe auditimet e funksioneve të menaxhimit të mjeteve janë bërë rregullisht.


Depozitimet e marra nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) janë paguar në bazë të *normës së kamatës* së Bankës Qendrore Evropiane (BQE), dhe vlerës aktuale në të cilën ndodhet sistemi global financiar bazuar në Politikën mbi Normën e Kamatës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Kthimi nga investimet i arritur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në mesatare është minimum i normës kamatës së ofruar, ku Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ndal një diferencë e cila kontribuon në kthimin nga investimet e saj.

#### 5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave

Zhvillimi i një sistemi efikas dhe të sigurt për pagesat vendore është një funksion parësor i BQK-së. Krijimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) në vitin 2001, si sistem i parë ndërbankar i pagesave, qe një hap i madh përpara në drejtim të lehtësimit të operacioneve të pagesave vendore përmes sistemit bankar. SEKN vazhdon të mbetet sistem i vetëm ndërbankar i pagesave që nga atëherë, mirëpo është ngritur funksionalisht dukshëm viteve të fundit, sidomos në vitin 2008, me synim modernizimin dhe pasurimin e mënyrave të kryerjes së transaksioneve. Konkretisht, gjatë vitit 2008, u kalua në platformën teknologjike të uebit dhe u zhvillua skema e debitimit direkt. Skema e debitimit direkt do të funksionalizohet në vitin 2009.

Figura 32. Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së.



Në vazhdimësi, vëllimi dhe vlera e transaksioneve të përshkuara përmes SEKN-së janë rritur, duke pasqyruar rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besimit në sistemin bankar vendor. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2008, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së

transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Rreth 2,7 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 3,16 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së. Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 107,2 për qind, dhe vlera e transaksioneve u rrit për 28,7 për qind.

Rritja e rëndësishme e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2008 ishte rreth 12,7 milionë euro, krahasuar me rreth 9,8 milionë euro në vitin 2007. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2008 ishte afro 10,9 mijë, krahasuar me rreth 5,3 mijë transaksione në vitin 2007.

Figura 33. Vëllimi dhe vlera mesatare ditore e transaksioneve të SEKN-së.



Janë disa lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: prioritare – individuale dhe masive, Kos-Giro, të rregullta – individuale, dhe të rregullta – masive. Nivelet krahasuese të vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2008 dhe 2007 janë të paraqitura në figurat e mëposhtme.

Pagesat e rregullta përbejnë rreth 90 për qind të transaksioneve të SEKN-së, dhe ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto.

Figura 34. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre.





Figura 35. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre.



Transaksionet Kos-giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e entiteteve të ndryshme, transaksionet Kos-giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të institucioneve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2008, institucionet e sektorit të sigurimeve

i janë bashkuar skemës Kos-giro, ndërsa përparime janë bërë edhe lidhur me transaksionet Kos-giro të KEK-ut.

Transaksionet prioritare procesohen dhe shlyhen menjëherë në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së, edhe pse në vitin 2008, si vëllimi ashtu edhe vlera e tyre më se u dyfishua. Sa i përket vëllimit, vazhdojnë të përfaqësojnë më pak se një për qind të transaksioneve të SEKN-së. Ndërsa sa i përket vlerës, arritën të përfaqësojnë më shumë se 10 për qind të transaksioneve të SEKN-së. Ky lloj vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

### 5.5. Regjistri i krediteve

Mundësimi i këmbimit të informacionit kreditor mes institucioneve kredidhënëse është një angazhim shumëqëllimor i BQK-së në funksion të zhvillimit të infrastrukturës ndërbankare, avancimit të tregut të krediteve dhe promovimit të stabilitetit financiar. Regjistri i Krediteve të Kosovës (RKK) është një sistem bashkëkohor teknologjik dhe telekomunikues i zhvilluar nga BQK-ja me qëllim të këmbimit të informacionit kreditor mbi kredimarrësit dhe aplikuesit për kredit të kredidhënësit e ndërlidhur. Edhe vetë kredimarrësit dhe aplikuesit për kredit si subjekte kreditore mund të sigurojnë informacionin përkatës personal. RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga institucionet kredidhënëse, mirëpo subjektet kreditore mund t'i qasen informacionit përkatës vetëm përmes BQK-së. RKK-së i qasen edhe mbikëqyrësit e institucioneve kredidhënëse.

RKK-ja siguron një mjet me rëndësi për funksionimin e tregut të krediteve. Mundëson vlerësimin më të mirë të mundësisë kredimarrëse dhe rreziqeve të kredimarrësit/ aplikuesit për kredit dhe, si rrjedhojë, lehtëson në masë të madhe procesin e lejimit të kreditit. Kjo është dëshmuar si për banka ashtu edhe për institucionet e tjera kredidhënëse në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2008, RKK-ja është përmirësuar në funksionalitet dhe roli i saj është përsosur edhe më tej. Zyra e regjistrimit të krediteve përpos menaxhimit të sistemit, gjithashtu ka koordinuar zhvillimin e mëtutjeshëm dhe ka monitoruar veprimin sipas kërkesave teknike të stafit përgjegjës të institucioneve

kredidhënëse dhe stafit të Drejtoratit të mbikëqyrjes bankare. Një sërë takimesh janë mbajtur me institucionet kredidhënëse dhe akterët e tjerë relevantë. Mandej, janë vënë dhe zhvilluar kontaktet me regjistrat e krediteve në rajon.

#### **5.6. Aktivitetet kërkimore dhe statistikore**

Gjatë vitit 2008 është përmirësuar më tej cilësia e përpilimit dhe publikimit të statistikave monetare dhe financiare si dhe të atyre të sektorit të jashtëm. Për më tepër, duke filluar që nga janari i vitit 2008, janë zbatuar versionet e reja të Raportit Statistikor Bankar dhe Raportit mbi Normat e Kamatës. Statistikat monetare dhe financiare përpilohen në bazë mujore dhe tremujore, i cili periodicitet është në përputhje me standardet ndërkombëtare statistikore.

Arritje e konsiderueshme lidhur me statistikave monetare dhe financiare gjatë vitit 2008 konsiderohet plotësimi i standardeve për publikimin e këtyre statistikave në FMN, gjegjësisht në Statistikat Financiare Ndërkombëtare. Krahas statistikave të shteteve të tjera, kjo do të rezultojë me publikimin e statistikave monetare dhe financiare të Kosovës në publikimet e FMN-së. Jetësimi i këtij projekti pritet të ndodhë pas përfundimit të procesit lidhur me anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.

Sa i përket statistikave të sektorit të jashtëm, që nga shkurti 2008 është jetësuar edhe versioni i ri i Sistemit të Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare, është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme numri i kompanive të anketuara dhe është rritur bashkëpunimi ndërinstytucional në kuadër të Komitetit për Statistika të Tregtisë së Jashtme. E gjithë kjo ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së statistikave të bilancit të pagesave të cilat kanë filluar të publikohen në bazë vjetore që nga viti 2006. Në kuadër të statistikave të sektorit të jashtëm objektiv kryesor në vitin 2009 është përpilimi dhe publikimi i këtyre statistikave në bazë tremujore, konform standardeve ndërkombëtare mbi periodicitetin e statistikave të bilancit të pagesave.

Gjatë vitit 2008 janë përpiluar po ashtu edhe analiza lidhur me zhvillimet ekonomike në Kosovë, me theks të veçantë sektorin financiar dhe bilancin e pagesave, të cilat janë botuar në publikimet periodike dhe jo periodike të BQK-së. Për herë të parë, gjatë vitit 2008, është përpiluar analiza 'stress-test' për sektorin bankar përmes së cilës vlerësohet ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj tronditjeve të

mundshme në ekonomi. Përmes kësaj analize, është vlerësuar rreziku i likuiditetit, rreziku kreditor dhe rreziku i normave të interesit. Për më shumë, janë përpiluar një numër i analizave interne të cilat kanë synuar të ndihmojnë vendimmarrjen në BQK dhe mbështesin politikat e përgjithshme ekonomike. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare si dhe prezantimi i punimeve shkencore përbëjnë po ashtu një nga aktivitetet me rëndësi gjatë vitit 2008.

Analizat ekonomike dhe statistikat e përpiluara botohen në publikimet e BQK-së, siç janë: Buletini Mujor Statistikor, Buletini i Bilancit të Pagesave, Buletini i Sektorit Financiar, Raporti Vjetor i BQK-së (pjesët e caktuara), etj. Në vitin 2008, aktivitetet kërkimore dhe statistikore në BQK u performuan në kuadër të Drejtorisë së Analizave Ekonomike dhe Statistikës e cila përbëhej nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Departamenti i Statistikës. Që nga janari 2009, Drejtoria e Analizave Ekonomike dhe Statistikës është promovuar në Zyrën e Kryeekonomistit e përbërë nga Drejtoria e Analizave Ekonomike dhe Drejtoria e Statistikës. Drejtorisë së Analizave Ekonomike, krahas Njesisë për Analiza të Sektorit Financiar dhe Njesisë për Publikime i është shtuar edhe Njësia për Analiza Makroekonomike, përderisa Drejtoria e Statistikës përbëhet nga Njësia e Statistikave Monetare dhe Financiare si dhe Njësia e Statistikave të Sektorit të Jashtëm.

## 6. Zhvillimet e Brendshme

### 6.1. Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm

#### Struktura e përgjithshme qeverisëse

Bordi drejtues formulon politikat për operacionet e BQK-së dhe mbikëqyr implementimin e tyre. Menaxhmenti i raporton Bordit drejtues për implementimin e operacioneve dhe politikave si dhe për kushtet ekonomike përkatëse në Kosovë.

Në baze të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Kosovës Bordi drejtues i BQK-së përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarët e Bordit emërohen në baze të nenit 18 të Ligjit për BQK-së. Drejtori i thesarit është një nga katër anëtar jo ekzekutiv të Bordit. Ndërsa tre anëtar tjerë jo ekzekutiv dhe Guvernatori emërohen ashtu si parashikohet nga nene 18.2 të këtij Ligji. Kryesuesi i Bordit drejtues i cili është drejtor jo-ekzekutiv dhe një tjetër drejtor jo-ekzekutiv janë emëruar në vitin 2007. Ndërsa në vitin 2008 është emëruar Drejtori i përgjithshëm gjegjësisht Guvernatori si i vetmi drejtor ekzekutiv, dhe një anëtar tjetër pra Drejtorë tjetër jo-ekzekutivë, në proces është emërimi anëtarit të katërt jo ekzekutiv pasi që ky vend është pa plotësuar pas dorëheqjes së anëtarit të Bordit të përfaqësuesit të shtyllës së IV të UNMIK-te, pas shpalljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe tërheqjes graduale të UNMIK-ut prej qeverisjes të institucioneve të Shtetit të Pavarur dhe Sovran të Kosovës.

Menaxhmenti i BQK-së përbëhet nga Guvernatori dhe dy shtyllave ekzekutive pra dy zëvendësguvernator; të operacioneve të bankës qendrore dhe zëvendësguvernator i mbikëqyrjes financiare cilët propozohen nga Guvernatori dhe emërohen nga Bordi drejtues.

Shtyllën e tret në strukturën organizative pra qeverisjen e mirëfillte dhe transparent e përfaqëson Inspektori i Përgjithshëm i BQK-së në bazë të nenit 30 të Ligjit mbi BQK-së.

#### Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm

Inspektori i Përgjithshëm nominohet nga Guvernatori me aprovim të Bordit drejtues, dhe ai ose ajo mund të largohet prej zyrës vetëm me vendim të bordit drejtues të BQK-së. Inspektori i Përgjithshëm aktual është caktuar në shkurt të vitit 2007. Detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit gjeneral përfshijnë:

- Vlerësimi i cilësisë së sistemeve ekzistuese dhe të atyre të propozuara të menaxhimit si dhe atyre të kontrollit financiar;
- Vlerësimi i punës së atyre sistemeve dhe i besueshmërisë e integritetit të informatave dhe transaksioneve të bëra;
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së kontrolleve për ruajtjen e aktives së BQK-së dhe, sipas nevojës, vërtetimin e ekzistimit të aktives;
- Vlerësimi i përputhjes me ligje, rregullore, urdhëresa administrative, rregulla, urdhra dhe me politika me të cilat udhëhiqen punët e BQK-së;
- Zbatimi i rishikimeve të përdorimit të efektshëm dhe të përpiktë të burimeve të BQK-së dhe dhënia e rekomandimeve të duhura menaxhmentit dhe
- Zbatimi i rishikimeve të posaçme me kërkesë të menaxhmentit dhe bashkëpunimi me auditorët e jashtëm të BQK-së.

Inspektori i Përgjithshëm ofron përmbledhjen e gjetjeve dhe sugjerimeve të tij në raportet që i paraqiten çdo gjashtë muaj Komitetit të auditimit/Bordit drejtues. Përveç kësaj, inspektori gjeneral i raporton Komitetit të auditimit/Bordit drejtues në çdo kohë kurdo që ai ose ajo e sheh si të nevojshme.

Zyra e inspektorit të Përgjithshëm përfshin auditimin e brendshëm, kontrollin dhe implementimin e buxhetit dhe analizat operacionale (kontabiliteti i shpenzimeve është mbarte ne operacione për veprim pas zyrtarizmit nga Bordi drejtues i BQK ne mars te vitit 2008).

### **Auditimi i brendshëm**

Auditimi i brendshëm si edhe viteve paraprake edhe në vitin 2008 ka vepruar në bazë të planit vjetor të propozuar nga Inspektori i Përgjithshëm ma aprovimin paraprakë nga Komitetit Auditimit si organ i pavarur dhe aprovimin final nga ana e Bordit Drejtues. Auditimi Intern në BQK-së ka punuar në bazë të këtij plani përpiluar nga Drejtorati i Auditimit e që ka pasur një qasje të bazuar në rrezik dhe ka qenë konform standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të Auditimit Intern, konkretisht standardi 2010- Planifikimi. Gjithashtu plani i auditimit intern është përpiluar në atë mënyrë që të jetë në harmoni me objektivat e BQK-së 2007/09 si dhe është përshtatur ndërrimeve ne strukturën organizative te disa drejtorive dhe departamenteve ne kuadër te strukturës së përgjithshme organizative të BQK-së.

Në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe duke marrë në konsideratë humbjet e mundshme materiale dhe të reputacionit të institucionit, auditimet janë kryer në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore, dhe vjetore. Fushat në vazhdim janë konsideruar të kenë rrezik më të shprehur:

- Kontabiliteti
- Operacionet e parave të gatshme
- Menaxhimi Mjeteve (Investimet e jashtme)
- Sistemi i kliringut ndërbankar
- Prokurimet
- Resurset Humane etj.

Përveç auditimeve të planifikuara, me kërkesë të Guvernatorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm janë kryer edhe disa auditime ad hoc.

Qëllimi i Auditimit të brendshëm është të ekzaminojë, të vlerësojë dhe të raportojë mbi përshtatshmërinë e sistemeve të kontrolleve të brendshme duke bërë sugjerime dhe rekomandime për përmirësime. Në bazë të ekzaminimit dhe vlerësimit të sistemeve të kontrolleve të brendshme, vlerësimit të transaksioneve, dhe verifikimit të përputhshmërisë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi, Auditimi i brendshëm përgatit raporte të shkruara, të cilat përfshijnë përgjigjet e menaxhmentit mbi gjetjet dhe rekomandimet. Raportet e auditimit të brendshëm pas aprovimit nga Inspektori i Përgjithshëm dorëzohen menaxhmentit dhe Guvernatorit. Në mënyrë që të përcjellët implementimi i rekomandimeve, auditimi i brendshëm në vazhdimësi azhurnon formën tabelore të përcjelljes së implementimit të rekomandimeve në mënyrë kronologjike me të gjitha informacionet relevante. Raportet e tilla përdoren si mjete të transparencës dhe komunikimit për t'i transmetuar nëpërmjet komitetit të Auditimit Bordit Drejtues statusin e implementimit të rekomandimeve.

Duhet përmendur se gjatë vitit 2008, Auditimi i brendshëm ka vazhduar monitorimin e procesit të rinumërimit të parave për dërgesa jashtë vendit në mënyrë që të rrisë kontrollin në operacionet përkatëse. Më pas, në mënyrë të suksesshme ka vazhduar me auditimin e Departamentit të TI-së lidhur me sistemin mbështetës të jashtëm (ruajtjes së shënimeve), duke dhënë rekomandime të rëndësishme për implementimit e plote të tij.

Përveç kësaj, Auditimi i brendshëm ka ekzaminuar - audituar në baza javore operacionet e investimeve në letra me vlerë dhe depozita të afatizuara. Kësaj fushe i është dhënë rëndësi të veçantë për shkak të krizës globale financiare. Me theks e veçante të urdhëruar nga Inspektori i Përgjithshëm është

bërë kontrolli i portofolios së investimeve të BQK-së dhe për këtë qëllim gjatë vitit 2008 janë përpiluar 53 raporte speciale për përcjelljen e të gjitha investimeve qofshin në tregun e parasë apo letrave me vlerë. Gjithashtu është përpiluar raporti special i auditimit të llogarive në librat e BQK-së depozitat/tërheqjet, lëvizjet e parave te gatshme (eksporti dhe importi i parave), interesat e paguara dhe fituara etj.

Në vazhden e zhvillimeve të përmendura i është kushtuar rëndësi vazhdimësisë se ngritjeve profesionale të gjithë personelit të Auditimit Intern, përmes ndjekjes së trajnimeve, seminareve brenda dhe jashtë Kosovës, studimeve post diplomike si dhe vazhdimësia e kooperimit me Bankat Qendrore të regionit me qëllim të këmbimit të përvojave në fushën e auditimit intern si dhe implementimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Bashkëpunimet me Bankat Qendrore dhe institucionet profesionale si Instituti "IBFI" – në kuadër të Bank de France, CEF në Slloveni, Rezerva Federale, anëtarësimi në "Institut of Internal Audit" SHBA, programi i trajnimit për "anti korrupcion" të udhëhequr nga USAID ka lehtësuar aftësimin dhe ngritjen e praktikës profesionale në këtë fushë të Auditimit.

### **Kontrolla dhe implementimi i buxhetit & Analizat operacionale**

Kontrolla e implementimit të buxhetit së bashku me analizat operacionale edhe gjatë vitit 2008 paraqet një vazhdimësi dhe tërësi e pandare të proceseve dhe punëve të filluar viteve paraprake, që zhvillohen sot dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen në BQK si një "unazë" shumë me rëndësi në zinxhirin e kontrollave të brendshme të instaluar dhe që veprojnë në kuadër të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm. Edhe gjatë vitit 2008, kontrolli dhe implementimi i buxhetit ka kontribuar me punën në atë mënyrë që të bëhet shfrytëzimi sa më racional dhe efektiv i resurseve në dispozicion dhe në harmoni me buxhetin e aprovuar nga Bordi Drejtues, ngase në implementimin e buxhetit AQBK-ja gjegjësisht BQK-së duhet ta ketë për qëllim arritjen e një buxheti sa më të balancuar.

Gjithashtu, kontrolli dhe implementimi i buxhetit për vitin 2008 i është përmbajtur edhe objektivave të planit të biznesit për vitin 2007/09.

Gjatë kontrollit të Buxhetit vëmendje e posaçme i është kushtuar shfrytëzimit sa më racional dhe efektiv të burimeve në pajtueshmëri me linjat buxhetore .

Njësia Kontrollit dhe implementimit të buxhetit në baza mujore ka gjeneruar raportet të cilat pasi që janë aprovuar nga Inspektori i Përgjithshëm janë dërguar Guvernatorit.

Te implementimi dhe realizimi i Buxhetit është bërë mbikëqyrja dhe aprovimi i shpenzimeve operative dhe kapitale në pajtim me linjat e aprovuara dhe të përcaktuara me Buxhet.

Janë kontrolluar dhe përcjellur njashtu të hyrat e realizuara të BQK-së ,posaçërisht të hyrat nga Interesi në Depozitat e afatizuara dhe letrat me vlerë .

Gjatë kontrollit /implementimit te buxhetit është bere edhe monitorimi i proceseve dhe mbikëqyrja dhe aprovimi i shpenzimeve /operative dhe kapitale/ ne krahasim me linjat e aprovuara buxhetore dhe ne këtë mënyre me kontrollin dhe implementimin e buxhetit bëhet mirëmbajtja e tërësishme e shpenzimeve të BQK-së

Raportet e Kontrollës dhe implementimit të buxhetit dhe analizat Operacionale janë përgatitur dhe punuar për çdo muaj dhe sipas periudhave ne baze te parimit akrual\* qe tregojnë performancen e buxhetit ne bazë aktuale

Arritjet kualitative janë bërë sa i përket të hyrave ve të BQK-se në:

- Kontrolli / verifikimi dhe mbikëqyrja e te hyrave e sidomos e te hyrave qe realizohen nga interesi ne plasmanët e afatizuara ne bankat e jashtme dhe nga letrat me vlerë si dhe
- Mirëmbajtja dhe evidenca mujore e depozitave te klientëve si dhe e Plasmanëve te BQK-së ne bankat e jashtme /te hyrat dhe shpenzimet e interesit /

Gjate vitit 2008, është vazhduar me zbatimin e zotuar te objektivave të planifikuara ne kontrollin dhe implementimin e buxhetit për periudhën 2007/09 dhe ne këtë drejtim janë kryer edhe këto pune vijuese :

- Përmirësimet dhe shtimi i informatave të dhënave mbi te hyrat dhe shpenzimet ne raportet javore , mujore dhe vjetore
- Përgatitja e raporteve mujore ,gjysmë vjetore dhe vjetore te Kontrollës dhe Implementimit të Buxhetit & Analizat Operacionale sipas bazës"aktuale" si dhe përforcimi i analizave Operacionale me paraqitjen grafike të hyrave dhe shpenzimeve - aktualja dhe buxhetimi / performanca e buxhetit /
- Përcjellja, evidenca e shpenzimeve te udhëtimeve zyrtare ne vend dhe jashtë vendit për secilin njësi ,departament dhe drejtorit veç e veç dhe ne tersi si dhe krahasimet me periudha javore për mëditjet brenda ne vend, si dhe

- Përcjellje te veçantë të kontrollesh dhe realizimit të linjave të buxhetuar për ngritje profesionale të stafit, trajnimet në vend dhe jashtë vendit.

Projekti i Kontabilitetit të Kostos, është zhvilluar dhe implementuar tërësisht nga ana e stafit lokal. Projekti në fjalë është iniciuar dhe rekomanduar nga FMN, por barrën e zhvillimit dhe implementimit e ka bartur plotësisht stafi lokal i departamentit të Kontrollesh dhe Implementimit të Buxhetit nën udhëheqjen e Inspektorit të Përgjithshëm. Ky projekt në vazhdimësi është monitoruar dhe mbikëqyrur nga ana e eksperteve të FMN-së, të cilët çdo fazë të zhvillimit të projektit kanë vëltuar me rekomandime pozitive deri në fazën përfundimtare.

Projekti që prej vitit 2003 është zhvilluar dhe adaptuar krahas sfidave dhe nderimeve në strukturën organizative të BQK-së përfundimisht deri në dhjetor të vitit 2007 gjegjësisht deri në mars të vitit 2008 kur departamenti i KIB filloj të gjeneron raportet e kontabilitetit të shpenzimeve për menaxhmentin e lartë të BQK-së. Në mars të vitit 2008 është aprovuar implementimi zyrtar i raporteve të kontabilitetit të shpenzimeve dhe njëkohësisht nga Bordi Drejtues të BQK-së është vendosur që kontabiliteti i kostos të kalon në operacione dhe në Drejtoratin e Planifikimit dhe Raportimit Financiar.

Departamenti i B&F-Analizat Operacionale & Kontabiliteti i kostos në periudhat vijuese 2008 - 2009 do të angazhohet që në mënyrë sa më kualitative dhe profesionale të përfundoj edhe objektivat tjera të filluara në vitin 2007 e të parapara me planin e biznesit 2007-2009 .

## **6.2. Zhvillimi i burimeve njerëzore**

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka rol të rëndësishëm në BQK qëllimi primar i së cilës është zhvillimi dhe implementimi i një programi progresiv të Burimeve Njerëzore duke filluar nga analiza dhe nevoja për trajnim të stafit, zhvillim të politikave të trajnimit dhe punësimit, përmbushjen e kodit të etikës dhe mirësjelljes, sigurimin me kohë të burimeve njerëzore, për të vazhduar me vlerësimin e performancës, pagat dhe beneficionet, si dhe duke mbështetur bashkëpunimin e ngushtë me menaxhmentin e lartë dhe grupet punuese.

Gjatë vitit 2008 janë shpallur 23 konkurse në gazetatat ditore të Kosovës dhe të njëjtat janë vendosur edhe në web faqen e BQK-së. Sipas këtyre shpalljeve janë rekrutuar 20 punëtorë të rinj prej këtyre tre me

mastër nga Universitetet të njohura jashtë vendit, 16 me diplomë universiteti dhe një me shkollë të mesme. Ndërsa gjate këtij viti 3 punëtoare vullnetarisht kane dhëne dorëheqje.

Vlen të theksohet se për secilën pozitë, si ato te krijuara ashtu edhe për ato ekzistuese, janë siguruar përshkrime të detajuara të detyrave dhe përgjegjësiive.

Gjate vitit 2008 numri i të punësuarve ishte 147 prej tyre 73 femra dhe 74 meshkuj, moshë mesatare e të cilëve është 39 vjeç.

Të dhënat, gjate vitit 2008, po që se marrim për bazë strukturën kualifikuese të punëtoreve, janë si në vijim:

PhD	1 punëtor
Master	16 punëtorë,
Diplomë Universitare	81 punëtorë,
Shkollë të lartë	1 punëtorë,
Shkollë të mesme	44 punëtorë dhe
Shkollë fillore	4 punëtorë.

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2008 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës 23 studentëve u ka ofruar "Programi i Praktikës për Student" që t'u siguroj një mundësi unike për të fituar përvojë pune në fusha të ndryshme të funksioneve dhe operacioneve te BQK-së.

BQK-ja vlerëson se personeli, si një ndër resurset me rëndësi të veçantë, vazhdimisht është e angazhuar që t'u siguron punëtoreve njohuri të duhura, aftësi dhe ekspertizë adekuate për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me standardet më të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes trajnimeve, kurseve, seminareve dhe shkollimeve akademike.

Gjatë vitit 2008 stafi i BQK-s ka ndjekur trajnime jashtë vendit në kohëzgjatje prej 270 ditë pune të cilat janë organizuar nga institucionet ndërkombëtare si: FMN-Join Viena Institute , Banka Qendrore Evropiane, Deutsche Bundesbank, Bankës së Francës, Banka Nazionale Austriane, Rezerva Federale e

Bankës së New York-ut, Bankës së Anglisë, Bankës së Holandës, ndërsa kurset online FSI i kanë ndjekur 10 punëtorë.

### 6.3. Riorganizimi i BQK-së

Duke marrë parasysh drejtimin e zhvillimit të sektorit financiar dhe mënyrën adekuate për ta mbikëqyrur atë, shtylla e mbikëqyrjes financiare ka bërë një rishikim të shkathtësive ekzistuese dhe atyre të nevojshme për mbikëqyrje të mirëfilltë të sektorit financiar. Gjithashtu, duke marrë parasysh rritjen e sektorit financiar si për nga madhësia ashtu edhe për nga ndërlikueshmëria, BQK-ja duke shkuar drejt qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, proces ky që siguron vazhdimësi në mbikëqyrjen e institucioneve financiare, ka parë si të duhur ndryshimin në strukturën organizative ekzistuese. Si rezultat i këtyre vlerësimeve, në janar të vitit 2008, u formalizua ideja e transformimit të strukturës organizative ekzistuese në një strukturë më funksionale e cila do t'i akomodojë zhvillimet dhe zbatimin e metodologjive që dalin nga solvenca e sigurimeve, Basel II i bankave, ndërlikueshmërisë së produkteve bankare me ato të sigurimeve, paraqitjet e reja të kompanive dhe fondeve investive, paraqitjen e kompanive të sigurimit të jetës si dhe llojeve të tjera të produkteve dhe të aktiviteteve. Objektivat kryesore të këtij riorganizimi ishin: kompletimi i platformës legjislative të mbikëqyrjes financiare në pajtim me Direktivat e Bashkësisë Evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, siç paraqiten në "Parimet themelore të mbikëqyrjes efikase bankare" të nxjerra nga Komitetit i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare të BIS-it, si dhe Parimet themelore për mbikëqyrje efikase të sigurimeve të lëshuar nga IAIS-i.

Krijimi i një stafi kompetent, që mund të arrihet me anë të vlerësimit të nevojave ekzistuese për trajnimin, parashikimin e nevojave të ardhshme për trajnim, dhe tutje, duke zhvilluar planet e duhura të trajnimit për ngritjen e shkathtësive të personelit dhe duke u siguruar që personeli i BQK-së, është i trajnuar në mënyrë adekuate për të kryer të gjitha funksionet mbikëqyrëse sipas nevojave të sistemit financiar. Si rrjedhojë, duke plotësuar nevojat e zhvillimit, menaxhmenti do të ketë më lehtë të zbatojë Planin për avancimin dhe kompensimin e punëtorëve, i cili do t'u mundësojë punëtorëve një shteg transparent për avancim në karrierën e tyre dhe me pagesën korresponduese e cila do të jetë drejtpërdrejt e lidhur me performancën, për të cilën stafi do të jetë i përgatitur në mënyrë adekuate.

Për përmbushjen e objektivave të BQK-së, Bordi drejtues i BQK-së, me anë të rikonstruktimit të përgjegjësive të deriatëhershme dhe krijimit të përgjegjësive ka marrë vendim për krijimin e tri drejtorateve dhe njësisive si në vijim:

Drejtorati i Mbikëqyrjes Bankare

Drejtorati i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve

Drejtorati i Korpoartës, Ligjor dhe i Metodologjive

Ristrukturimi i tillë ka për qëllim të kontribuojë ndaj zhvillimit të proceseve institucionale, që do të ofrojë një balancim ndërmjet rregullimit dhe mbikëqyrjes, disiplinim të tregut dhe qeverisje të mirë të institucioneve financiare të cilat do të krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin racional të sektorit financiar.

Edhe në lëmin e operacioneve bankare qendrore, në prill të 2008-ës, me qëllim të zhvillimit funksional, ngritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve profesionale, u bë restrukturimi dhe promovimi në nivel të drejtorateve i tri njësisive organizative. U bë themelimi i funksionit të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të sistemeve të pagesave në kuadër të njësisë së sistemeve ndër-bankare të pagesave dhe promovimi i kësaj njësie në nivel të drejtoratit. Si funksion i ri u shtua edhe menaxhimi i rrezikut dhe i vazhdueshmërisë së funksionimit në kuadër të njësisë së promovuar në drejtorat që është e ngarkuar me teknologjinë dhe sistemet e informacionit. Më pas, u bë bartja e funksionit të kontabilitetit të shpenzimeve nga lëmi i përgjegjësive së inspektorit të përgjithshëm në kuadër të njësisë përgjegjëse për planifikim dhe raportim financiar, dhe, rrjedhimisht, ngritja edhe e kësaj njësie organizative në nivel të drejtoratit.

#### **6.4. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar**

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë vazhdon të jetë një ndër çështjet e rëndësishme relevante për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Përgjatë vitit 2008, në këtë aspekt, me bankat qendrore të rajonit dhe me ato të BE-së janë vendosur marrëdhënie të reja por edhe janë avancuar ato ekzistueset dhe, pa dyshim, edhe me autoritetet mbikëqyrëse dhe institucionet të tjera ndërkombëtare financiare. Në BQK ekziston gatishmëria për t'i pranuar dhe zbatuar standardet, metodologjitë dhe praktikat më të mira

ndërkombëtarë, për të përfituar nga përvojat e rajonit si dhe për të shkëmbyer pikëpamje dhe informata mbi baza të rregullta. Përvojat e fituar nga bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë, si komponent domethënës për përaftrim me parimet evropiane, është edhe pjesëmarrja e personelit të BQK-së në seminare, konferenca e trajnime. Në këtë kontest vlen të cekem ato në Rezerva Federale të SHBA-ve, në Bankën Qendrore Evropiane, Joint Vjena Institute - JIV - të Vjenës, Deutsche Bundesbank, Bank of England, IMF- Washington, Banque de France por dhe shumë vende të tjera nga të cilat përvojat e fituar kanë ndikim në përmirësimin e proceseve dhe rrjedhave të BQK-së, me çka rrugëtimi drejt përmbushjes së standardeve është më i shpejt dhe me efikas.

Viti 2008 është karakterizuar me angazhime të shumta të personelit të BQK-së si në aspekt të pjesëmarrjes me punime shkencore në seminare e konferenca ashtu edhe me trajnime të shumta me karakter interaktiv profesional. Këtu duhet veçuar prezantimin e punimit shkencorë “The Determinants of Emigrant Earnings and Remittances: Evidence from Kosova” në punëtorinë e organizuar nga Banka e Shqipërisë, i cili punim po ashtu ka fituar çmimit prestigjioz “Olga Radzyner” që ndahet nga Banka Nazionale e Austrisë për ekonomistët e rinj.

#### 6.4.1. Marrëveshjet ndërkombëtare

Edhe në viti 2008, ashtu si në vitet paraprake, BQK-ja vazhdoi përpjekjet për nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me mbikëqyrësit amë të institucioneve të huaja financiare që veprojnë në Kosovë. *Acquis communautaire* si platformë tek e cila mbështet BQK-ja për përpilim të memorandumeve për marrëveshje ndërkombëtare i mundësojnë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe mbikëqyrësve të huaj të shkëmbejnë informacione të ndjeshme dhe konfidenciale në baza ligjore. Përpjekje të shumta janë ndërmarrë në këtë drejtim dhe BQK-ja në maj të vitit 2008 ka nënshkruar memorandume të mirëkuptimit me “Agjencinë Kroate të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare” (CFSSA), gjithashtu në maj të 2008-ës është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit edhe me “Agjencinë e Mbikëqyrjes dhe të Rregullimit Bankar” (BRSA) të Turqisë ndërsa me Autoritetit Mbikëqyrës Financiar të Shqipërisë është nënshkruar plotësimi i memorandumit ekzistues.

Në linjë me përmbushjen e standardeve të kërkuara ndërkombëtare mbi të gjitha është Mekanizmi Përcjellës për Stabilizim dhe Asocim, mekanizëm ndihmues dhe lehtësues për institucionet e

Kosovës për përmbushje më të shpejt të standardeve të kërkuara nga Komisionit Evropian për kyçjen në BE, në të cilën BQK-ja është akter i rëndësishëm dhe përmbajtjesor.

#### **6.4.2. Anëtarësimet në shoqatat dhe organizatat ndërkombëtare**

Përgjatë vitit 2008 BQK-ja pandalshëm dhe në vazhdimësi përpiqet që të siguroi anëtarësimin në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë por dy nga ato janë me ndikim në ngritje të efikasitetit dhe të proceseve të saj; SWIFT – Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication dhe Green Card.



## **7. Pasqyrat financiare të BQK-së**



**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008**

**(dhe raporti i auditorëve të pavarur)**

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

<b>Pasqyra përmbledhëse</b>	<b>Faqja</b>
Raporti i auditorëve të pavarur	i - ii
Pasqyrat financiare:	
Bilanci	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit dhe rezervave	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5-37



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch  
14, Sulejman Vokshi Street  
Pristina  
Kosovo

Telephone +381 38 246 771  
Telefax +381 38 246 772  
E-mail al-kosovo@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i audituesve të pavarur

Bordit Drejtues të  
Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 2 qershor 2009

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (“Banka”), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i datës 31 dhjetor 2008, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2008, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### *Theksimi i Çështjes*

Pa dhënë rezervë në opinion, ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4(f) të pasqyrave financiare ku cilësohet se sipas Ligjit Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Kapitali dhe Llogaritë e Rezervave të Përgjithshme duhet të jenë së paku të barasvlershme me pesë për qind të shumës totale të gjendjeve kreditore të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e Bankës në fund të çdo viti financiar. Më 31 dhjetor 2008 dhe 2007 kjo kërkesë nuk ishte përmbushur.

*KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch*

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch  
14, Sulejman Vokshi Street  
Pristina  
Kosovo



# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


## Bilanci

Më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	<b>Shënime</b>	<b>2008</b>	<b>2007</b>
<b>Aktivët</b>			
Paraja e gatshme	7	39,674	63,817
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	10,403	1,946
Bono thesari	9	541,019	229,277
Depozita me banka jo-vendore	10	519,276	762,579
Prona dhe pajisjet	11	2,087	2,108
Aktivët e paprekshme	12	86	122
Aktive të tjera	13	406	295
<b>Totali i aktiveve</b>		<b><u>1,112,951</u></b>	<b><u>1,060,144</u></b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	137,158	113,554
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	908,212	856,730
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	24,400	48,381
Detyrime të tjera të brendshme	17	1,978	7,743
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>1,071,748</u></b>	<b><u>1,026,408</u></b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali	18	30,000	20,000
Rezerva të përgjithshme	19	11,203	13,736
<b>Totali i kapitalit dhe rezervave</b>		<b><u>41,203</u></b>	<b><u>33,736</u></b>
<b>Totali i detyrimeve, kapitalit dhe rezervave</b>		<b><u>1,112,951</u></b>	<b><u>1,060,144</u></b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare në faqet 1 deri në 37 u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 4 maj 2009 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Hashim Rexhepi

Guvernator



Gani Gerguri

Zëvendësguvernator

## Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	<b>Shënime</b>	<b>2008</b>	<b>2007</b>
Të hyra nga interesi		42,841	34,275
Shpenzimet e interesit		(34,063)	(24,371)
Të hyrat nga interesi neto	20	<u>8,778</u>	<u>9,904</u>
Të hyra nga tarifat dhe komisionet		884	743
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet		(215)	(226)
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet neto	21	<u>669</u>	<u>517</u>
Të hyrat nga grantet	22	85	453
Të hyrat e tjera nga aktivitetet operuese	23	<u>1,087</u>	<u>954</u>
<b>Të hyrat nga aktivitetet operuese</b>		<b>10,619</b>	<b>11,828</b>
Shpenzimet e personelit	24	(1,771)	(1,412)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(458)	(447)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	25	<u>(923)</u>	<u>(823)</u>
<b>Shpenzimet operuese</b>		<b>(3,152)</b>	<b>(2,682)</b>
<b>Fitimi për periudhën</b>		<b><u>7,467</u></b>	<b><u>9,146</u></b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit dhe rezervave

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

*Në mijë EUR*

	Shënime	Kapitali	Rezerva të përgjithshme	Fitime të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 Janar 2007</b>		<b>10,000</b>	<b>14,590</b>	-	<b>24,590</b>
Fitimi për periudhën		-	-	9,146	9,146
Totali i të hyrave dhe shpenzimeve		-	-	9,146	9,146
Transferime në kapital	18	10,000	(10,000)	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2007</b>		<b>20,000</b>	<b>4,590</b>	<b>9,146</b>	<b>33,736</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2008</b>		<b>20,000</b>	<b>4,590</b>	<b>9,146</b>	<b>33,736</b>
Fitimi për periudhën		-	-	7,467	7,467
Totali i të hyrave dhe shpenzimeve		-	-	7,467	7,467
Transferime në kapital	18	10,000	(854)	(9,146)	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2008</b>		<b>30,000</b>	<b>3,736</b>	<b>7,467</b>	<b>41,203</b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	<b>Shënime</b>	<b>2008</b>	<b>2007</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga operacionet</b>			
<b>Fitimi për periudhën</b>		7,467	9,146
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	11	378	353
Amortizimi	12	80	94
Të hyrat nga grantet	17	(85)	(252)
Fitim nga shitja e pajisjeve		(5)	(4)
Të hyra nga interesi	20	(42,841)	(34,275)
Shpenzimet e interesit	20	34,063	24,371
		(943)	(567)
Ndryshime në bono thesari		(145,749)	(117,269)
Ndryshime në depozita me banka jo-vendore		197,908	(182,467)
Ndryshime në aktive të tjera		(111)	(118)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave të brendshme		23,604	19,077
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse		51,482	380,909
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike		(23,835)	3,305
Ndryshime në detyrime të tjera të brendshme		(5,717)	5,337
		<b>96,639</b>	<b>108,207</b>
Interes i arkëtuar		47,329	29,912
Interes i paguar		(34,209)	(24,371)
<b>Rrjedhja e parasë nga operacionet</b>		<b>109,759</b>	<b>113,748</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga investimet</b>			
Shitja e pajisjeve		5	4
Blerja e pajisjeve	11	(357)	(1,199)
Blerja e aktiveve të paprekshme	12	(44)	(72)
<b>Përdorimi i parasë nga investimet</b>		<b>(396)</b>	<b>(1,267)</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga financimet</b>			
Grante të marra	17	36	-
<b>Para nga financimet</b>		<b>36</b>	<b>-</b>
<b>Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>		<b>109,399</b>	<b>112,481</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		621,479	508,998
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>	26	<b>730,878</b>	<b>621,479</b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 1. Entiteti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje “BQK”), entitet pasardhës i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një entitet i pavarur juridik me një kapacitet të plotë si një person legal nën ligjin i cili është i aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një entitet publik i veçantë me autoritetin për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Entiteti fillestar paraardhës i BQK-së – Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullores nr: 1999/20 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (nga këtu e tutje “UNMIK”) të miratuar më 15 nëntor 1999, ndryshuar më 1 tetor 2001 (Rregullorja nr. 2001/24 e UNMIK-ut). Më 24 gusht 2006 një rregullore e re (Rregullorja nr. 2006/47 e UNMIK-ut) hyri në fuqi duke e transformuar Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Më 5 qershor 2008, Ligji nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të kujdeset për saktësinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të një sistemi financiar bazuar në një treg të qëndrueshëm, duke inkurajuar krijimin e instrumenteve të sigurta financiare; dhe
- pa ndonjë paragjykim, të përkrahë politikat e përgjithshme ekonomike në Kosovë për të kontribuar në një shpërndarje efektive të burimeve në pajtim me parimet e një tregu të hapur ekonomik.

BQK-ja mes tjerash, ka këto kompetenca të veçanta:

- të rekomandojë një politikë të gjerë udhëzuese për Kuvendin dhe Qeverinë në fushat që janë në përgjegjësinë e saj;
- të formulojë dhe të zbatojë masat, të mbikëqyrë dhe rregullojë sistemet e pagesave për transaksionet në valutë vendore dhe të huaj në Kosovë;
- të posedojë dhe të operojë një ose më shumë sisteme pagesash;
- të veprojë si agjent bankar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të japë këshilla financiare nëse kërkohet;
- të veprojë si agjent fiskal për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- të mbajë depozita në valutë të huaj të bankave, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe subjekteve tjera publike;
- të sigurojë furnizim të mjaftueshëm të bankënotave dhe monedhave për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme;
- të sigurojë një vend depozitimi të sigurt për ruajtjen e monedhave dhe letrave me vlerë;
- të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, të publikojë rezultatet dhe të paraqesë propozimet dhe masat Kuvendit dhe Qeverisë në bazë të këtyre analizave;
- të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e këmbimeve valutore, komisionerët-agjentë, dhe fondet e përbashkëta;
- të aprovojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare; dhe
- të vendosë standardet e kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 1. Entiteti raportues (vazhdim)

BQK-ja operon nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK-së është:

Rruga Garibaldi nr. 33  
Prishtinë, Kosovë.

#### **Bordi drejtues**

Bordi drejtues formulon politikat operationale të BQK-së dhe mbikëqyr realizimin e tyre. Drejtuesit (menaxhmenti) i BQK-së kërkohet të raportojnë tek Bordi drejtues, jo më pak se dhjetë herë brenda vitit, për zhvillimin e operationeve dhe politikave, për gjendjen e sistemit financiar, për gjendjen e tregut valutor, të parasë dhe kapitalit, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet që pritet të kenë ndikime të rëndësishme në administratë, në operatione të BQK-së, në drejtimin e politikave të sistemit financiar ose në tregjet e përmendura më parë dhe në çdo çështje tjetër që ndikon ose mundet të ndikojë politikat e BQK-së.

Bordi drejtues përcakton politikat për operationet e BQK dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Sipas Ligjit nr. 03/L-074, Bordi drejtues përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi drejtues ka këto kompetenca:

- të miratojë politikat për ekzekutimin e autoritetit të BQK-së dhe të mbikëqyrë realizimin e tyre nga drejtuesit dhe stafi;
- të miratojë të gjitha rregullat, direktivat dhe udhëzimet e lëshuara nga BQK-ja;
- të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BQK-ja bën për Kuvendin dhe Qeverinë;
- të emërojë me vendim, së paku dy drejtorë jo-ekzekutivë për të formuar Komitetin e auditimit;
- të miratojë organizimin e BQK;
- të miratojë propozimin e Guvernatorit për caktimin e dy Zëvendësguvernatorëve të BQK-së për një periudhë pesëvjeçare;
- të miratojë caktimin e Inspektorit të përgjithshëm të BQK-së për një periudhë pesëvjeçare;
- të miratojë buxhetin e BQK-së;
- të aprovojë politikat kontabël të BQK-së dhe të aprovojë raportimin periodik dhe pasqyrat financiare të BQK-së;
- të vendosë mbi gjendjen e borxhit në shuma materiale nga BQK-ja dhe kushtet dhe afatet e këtij borxhi;
- të aprovojë kategoritë e aktiveve që do të jenë të përshtatshme për investimet e burimeve financiare të BQK-së;
- të miratojë ose refuzojë aplikimet për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve financiare dhe të tërheqë licencat ose regjistrimet e institucioneve financiare;
- të adoptojë strukturat e brendshme, politikat dhe procedurat për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, duke përfshirë delegimin e autoritetit tek stafi i BQK për ndërmarrjen e hapave korrigjues; dhe
- të ratifikojë para zbatimit të tyre, të gjitha masat në fuqi të përgatitura nga stafi i BQK-së, me përjashtim të atyre që janë të përcaktuara me ligj nën kompetencën e Guvernatorit.

# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënime mbi pasqyrat financiare**

*(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)*

### **1. Entiteti raportues (vazhdim)**

#### ***Bordi Drejtues (vazhdim)***

Më 31 Dhjetor 2008, Bordi drejtues i BQK-së përbëhej nga këta anëtarë:

Gazmend Luboteni – Kryetar

Hashim Rexhepi – Guvernator

Lulzim Ismajli – Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Sejdi Rexhepi – Anëtar

### **2. Bazat e përgatitjes**

#### **a) Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

#### **b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet financiare derivative janë matur me vlerë të drejtë
- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë
- pronat e mbajtura për investim janë matur me vlerë të drejtë
- detyrimet për shlyerjen në mjete monetare të marrëveshjeve për pagesat bazuar në aksione janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet dhe detyrimet financiare të përcaktuara si zëra të mbrojtur në marrëdhëniet e kualifikuara për mbrojtje rregullohen për ndryshimin në vlerën e drejtë që i atribuohet riskut ndaj të cilit po kryhet mbrojtja.

#### **c) Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Pasqyrat financiare prezantohen në euro (“EUR”), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në euro është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

#### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi (menaxhmenti) që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat të prezantuara në këto pasqyra financiare.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël

#### a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

BQK-ja vepron kryesisht në euro, ndërsa në valutë të huaj BQK vepron kryesisht në dollarin amerikan (USD). Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për konvertim më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007 paraqiten si më poshtë:

	2008 EUR	2007 EUR
1 USD	0.718	0.679

#### b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitet ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitet ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivitet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e interesit efektiv.

#### c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënime mbi pasqyrat financiare**

*(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël**

#### **d) Përfitimet e punonjësve**

##### ***i. Plan pensioni me kontribute të përcaktuara***

BQK-ja paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Gjithashtu, BQK-ja njih kontribute të përcaktuara të pagueshme në fonde pensionesh të jashtëm. Norma e kontributeve shtesë është 10% e pagës bruto. Këto shuma njihen si shpenzime kur ato ndodhin. BQK-ja nuk ka ndonjë detyrim ligjor apo të tërthortë të paguajë kontribute të tjera.

##### ***ii. Përfitimet afatshkurtra***

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të pazbritshme dhe shpenzohen kur shërbimi kryhet.

#### **e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit**

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-074 miratuar më 5 qershor 2008, i cili kërkon që BQK të paguajë tepicën e të ardhurave neto direkt në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, pasi të ketë plotësuar nivelet e fondit rezervë (shiko shënimin 4 f)

#### **f) Aktivet dhe detyrimet financiare**

##### ***i. Njohja***

BQK-ja fillimisht njih depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

##### ***ii. Mosnjohja***

BQK-ja nuk njih një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë të aktivit financiar. Interesa nga aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga BQK-ja njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

BQK-ja nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

##### ***iii. Netimi***

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### f) Aktivitet dhe detyrimet financiare ( vazhdim)

##### iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### v. Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së një aktivi ose detyrimi financiar është vendosur duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të vlerës aktuale, analizat e fluksit monetar të skontuar, krahasime me instrumente të tjera të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu lehtësisht të vëzhgueshme, dhe modele vlerësimi. BQK-ja përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe të thjeshtë. Për këto instrumente financiare, të dhënat në modele janë të vëzhgueshme nga tregu.

##### vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë bilanci, BQK-ja vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

#### h) Letra me vlerë

Letrat me vlerë që mbahen për investim njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim mbahen si ato deri në maturim.

##### *i. Të mbajtura deri në maturim*

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në raste të shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një sasive të rëndësishme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe do të pengonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

#### i) Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtruara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

##### *ii. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### i) Prona dhe pajisjet (vazhdim)

##### iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të pasurisë dhe pajisjeve.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2008	2007
• Investimet në objektet me qira	20 vite	20 vite
• Pajisjet	5 vite	5 vite
• Kompjuterët	3 vite	3 vite
• Automjetet	5 vite	5 vite

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur janë rivlerësuar në datën e raportimit.

#### j) Aktivitet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 3 vjet (2007: 3 vjet).

#### k) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivitetin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënime mbi pasqyrat financiare**

*(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **l) Depozitat dhe detyrimet tjera financiare**

Depozitat janë burimet e financimit të BQK-së. Ato fillimisht janë të matura në vlerën e tregut duke shtuar kostot e transaksionit dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit përveç nëse BQK-ja zgjedh që t'i bartë detyrimet me vlerën e tregut në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **m) Të hyrat nga grantet**

Grantet e qeverisë fillimisht njihen si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzimet njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një pasurie njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të aktivit.

#### **n) Pagat e financuara nga donatorët**

Disa individë të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtarë të caktuar nga organizata ndërkombëtare të cilat ofrojnë mbështetje financiare për BQK-në. Gjithashtu, këto organizata ndërkombëtare emërojnë ekspertë dhe këshilltarë afatshkurtër siç paraqitet nevoja. Mbështetja financiare e këtyre organizatave ndërkombëtare përfshin por nuk është e kufizuar në pagesën e pagave për pozita të tilla drejtuese dhe këshilluese.

Pasi kjo ndihmë u paguhet nga organizatat ndërkombëtare drejtpërdrejt të emëruarve, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në pasqyrat financiare.

#### **o) Provizionet**

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhën e ardhshme të parasë me një normë para tatimit dhe që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme rrezikun e veçante ndaj detyrimeve.

Provizioni për kontrata me humbje njihet kur përfitimet e pritura nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me vlerën aktuale të koston së pritshme të përfundimit të kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimit të kontratës, cilado është më e vogël. Përpara se të njihet një provizion BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e aktivitet të lidhur me atë kontratë.

#### **p) Standarde dhe interpretime të reja ende të paadoptuara**

